

Date:12.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mall, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik
për cdo lot ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Artikuj Ushqimore për Konviktet e Shkollave të Mesme për vitin 2023” e ndarë në lote si më poshtë:

- *Loti i parë:* “Blerje bukë për Konviktet e Shkollave të Mesme” me afat të marrëveshjes kuadër me afat 1 vit (365 dite)
- *Loti i dytë* “Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme” me afat të marrëveshjes kuadër me afat 1 vit (365 dite)
- *Loti i tretë:* “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme” me afat të marrëveshjes kuadër me afat 1 vit (365 dite)
- *Loti i katërt:* “Blerje fruta perime për Konviktet e Shkollave të Mesme” me afat të marrëveshjes kuadër me afat 1 vit (365 dite)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):15894210-6
Ushqim per shkolla

Bukë-15811100-7; Çaj mali- 15863000-5; Fasule- 03221210-1; Sodë buke- 15890000-3; Sheqer-15831000-2; Kripë- 15872400-5; Limontoz- 15622310-0; Makarona- 15850000-1; Vaj luledielli-15411100-3; Vaj ulliri- 15411110-6; Miell- 15612100-2; Niseshte- 15623000-1; Oriz- 15614300-8; Piper i kuq/i zi- 15872100-2; Salce- 15331428-3; Reçel- 15332290-3; Rigon- 15870000-7; Uthull- 15871100-5; Vezë- 03142500-3; Qumësht- 15511000-4; Kos- 15551300-8; Salçiçe- 15131130-5; Mish pule-15112100-7; Mish viçi- 15111200-1; Djath- 15544000-3; Gjalp-15530000-2;; Perime-03221000-6; Patate-03212100-1; Qepë-03221113-1; Fruta-mollë 03222321-9 portokalle 03222220-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 247 510 (shtatë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e dhjetë): Lekë (pa TVSH), vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e Bashkisë Tiranë, *i ndarë në Lote si më poshtë vijon:*

- **Loti 1** “Blerje bukë për Konviktet e Shkollave të Mesme” me afat të marrëveshjes kuadër 12(dymbëdhjete) muaj, me fond të marrëveshjes kuadër **1 138 055,6 (një milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëdhjetë e pesë presje gjashtë) Lekë (pa TVSH);**
- **Loti 2** “Blerje ushqime koloniale për Konviktet e Shkollave të Mesme” me afat të marrëveshjes kuadër 12(dymbëdhjete) muaj, me fond të marrëveshjes kuadër **1 149 346,4**

(një milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e dyzet e gjashtë presje katër) Lekë (pa TVSH);

- **Loti 3 “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme”** me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjete) muaj, me fond të marrëveshjes kuadër **4 190 413,3 (katër milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e trembëdhjetë presje tre)** Lekë (pa TVSH);
- **Loti 4 “Blerje fruta perime për Konviktet e Shkollave të Mesme”** me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjete) muaj, me fond të marrëveshjes kuadër **769 694,7 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër presje shtatë)** Lekë (pa TVSH);

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme Bashkia Tirane** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1 “BLERJE BUKË PËR KONVIKTET E SHKOLLAVE TË MESME”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës të paraqesë licencën leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkategoria: II.1.A.1. ”Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, në emër të vetë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të jenë të rregjistruar në një nga regjistrat profesionalë për zbatimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu në nenin 19 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar përcaktohet se:

”Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrin revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiene-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiene-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është pëcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjinë jo shtazore) sipas objektit të prokurimit, janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet OKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

- b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;
- c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;
- ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;
- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi I

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. *Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:*

a) *Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*

2. *Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:*

a) *“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;*

b) *“Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;*

c) *“Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.*

3. *Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009*

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. *Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.*

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. *Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.*

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

- a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.
- b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.
- c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategorinë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë.”.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë prodhime ushqimore dhe meqënëse objekti i prokurimit për Lotin 1 është artikulli ”Buke”, i cili është një produkt me origjinë joshtazore dhe është ushqim për njerëzit, duhet që të jenë të pajisur me licensën e nënkategorisë II.1.A.1.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose”

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin konkret meqënëse edhe ligji nr.9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar nuk lejon që të ushtrohet aktiviteti i prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të artikullit ”bukë: pa licensë profesionale atëherë njësia e prokurimit vendosi hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

Gjithashtu njësia e prokurimit duke patur parasysh parashikimet e nenit 14 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” ku parashikohet që operatorët ekonomikë mund të ofertojnë në formën e bashkimit të shoqërive ju referua përcaktimeve të nenit 88, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

Neni 88

Bashkimi i operatorëve ekonomikë

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike,

financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, ku është parashikuar se në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike kërkesat profesionale për kualifikim plotësohen nga secili prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive në raport me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në furnizim, njësia e prokurimit gjykon se meqënëse kriteri i mësipërm është një kriter kualifikimi lidhur me aftësinë profesionale, përcaktoi se në rastin kur ofertuesit paraqesin ofertë në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë atëherë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të jetë i pajisur me Licensën e nënkategorisë II.1.A.1. "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz".

Ndërsa përcaktimi se: " *Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor*", është mbështetur në përcaktimet e pikës III "Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim" të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr. 10181 prot, datë 19.11.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", ku përcaktohet se: "Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licensën kategoria II.1.A – "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" në emër të tij, pasi licensa duhet ti përkasë operatorit ekonomik të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor. Theksojmë se gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor do të mbajë në konsideratë faktin se nuk lejohet përdorimi i licensës të një operatori tjetër ekonomik."

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratës së xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2021, 2022, 2023) të lëshuar nga organet tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo më pak se 443 841 (katerqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dyzet e nje) leke.

Sqarim:

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale prej jo më pak se 443 841 (katërqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dyzet e nje)leke, në të paktën një vit të periudhës financiare të cituar më sipër 2021, 2022, 2023.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Dhe pika 3

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedura e Hapur e thjeshtuar–Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 ”Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, nenit 42, pika 3 ”Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” dhe neni 11, pika 1 ”Kufijtë monetarë” (ndryshuar me VKM-në nr. 498, datë 1.8.2024)të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vjetët e fundit financiarë.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
 - b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
 - c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme .
3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar ne VKM-në nr. 498, datë 1.8.2024 KREU II KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK percaktohen

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit ju referua përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese dekalohet në organe ttatimire brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në shtator të vitit 2024 dhe tatimpaduesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të dekalrojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e nenit 42 të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se në rastin e procedurave të prokurimit të ndara në lote, si vlerë për hartimin e kriterit ekonomik të xhiros për seilin lot do të merret për bazë vlera e lotit dhe meqënëse vlera e lotit I referuar VKM nr. 291, datë 15.5.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik" Kreu II "Kufijtë monetarë në sektorin klasik" pika 2/b Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik (mall) është nën Kufirin e ulët monetar në sektorin klasik (mall) u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 39% e vlerës së fondit limit të lotit I dhe konkretisht 443 841 (katërqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dyzet e nje)leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, ku vlera pa TVSH e një ose disa kontratave të jetë **jo më pak se 216 230 (dyqind e gjashtëmbëdhjet mijë e dyqind tridhjet) leke**. Këto përvoja të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga entet publike për përmbushjen me sukses të një ose disa kontratave, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe në rastet kur në këto vërtetime nuk identifikohen sasitë dhe vlera e mallrave të furnizuara, atëherë operatori ekonomik duhet të dorëzojë edhe faturën ose faturat tatimore të shitjes për këto kontrata, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara sipas kontratës për të cilën paraqesin vërtetim.

b. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqenëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka përvojën e mëparshme për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar durnizime të ngjashme në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqenëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, nenit 42, pika 3 ”Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara

Neni

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Lidhur me vitet për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar furnizimi/et e ngjashme të mëparshme, nisur nga interpretimi i dispozitës së mësipërme njësia e prokurimit ka përcaktuar si periudhë kohore 3 (tre) vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit sikurse përcaktohet në nenin 40 pika 4, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Lidhur me përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik njësia e prokurimit mbështetur në përcaktimet e mësipërme ligjore ka përcaktuar që në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me sektorin publik, përveç vërtetimeve të lëshuara nga entet publike të dorëzohen edhe faturat tatimor të shitjes që u përkasin këtyre vërtetimeve, pasi në disa raste komisioni i vleresimit të ofertave vihet në vështirësi sepse ofertuesit paraqesin vetëm vërtetim realizimi kontrate dhe është e pamundur që të identifikohen sasishtë, lloji dhe vlera e artikujve të furnizuara, si dhe data e realizimit të furnizimit.

Lidhur me vlerën e furnizimeve të mëparshme të përcaktuara, meqenëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e pikës 3, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet: "*Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit*", pikës 9, të po këtij neni, ku parashikohet: "*Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës*", si dhe të pikës 4, të nenit 55, të këtij vendimi, ku përcaktohet: "*Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*". dhe konkretisht për lotin Buke jo më pak 216 230 (dyqind e gjashtëmbëdhjet mijë e dyqind tridhjet)leke, pra është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në pronësi ose të disponojë **Furrë buke ose linjë prodhimi buke**, të përshtatshme për prodhim dhe magazinim të artikullit bukë, shoqëruar me:

- Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është në **pronësi** duhet të paraqitet:
Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti; Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) (për

prodhim buke) për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga administratori i biznesit për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë stabiliment.

- Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është me **qera** duhet të paraqitet:
Kontrata e qerasë për stabilimentin ku ushtrohet aktiviteti, e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës së prokurimit; Certifikata e pronësisë në emër të qeradhënësit; Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) (për prodhim buke) për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga qeramarrësi për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë stabiliment.
- Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është **me kontratë huapërdorje duhet të paraqitet:**
Kontrata e huapërdorjes së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti, e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës së prokurimit; Certifikata e pronësisë në emër të huadhënësit; Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) (për prodhim buke) për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga huamarrësi për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë stabiliment
- Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është me **marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi** të paraqitet:
Marrëveshja e bashkëpunimit ose e furnizimit me prodhuesin e bukës, e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës së prokurimit; Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktivitetin prodhuesi i bukës; Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) (për prodhim buke) për këtë stabiliment ku ushtron veprimtarinë prodhuesi i bukës; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment ku ushtron aktivitetin prodhuesi i bukës lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga administratori i biznesit (prodhuesi i bukës) për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë stabiliment.

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi dhe me paraqitjen e Deklaratës nga administratori i biznesit për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë stabiliment.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë Shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit" të plotësuar.

Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është në **pronësi** të operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: "**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**", pika: "**B: DEKLARATË**" të Shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit" numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti, numrin e Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) (për prodhim buke) për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar për këtë stabiliment lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është marrë me **qera** nga ana e operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: "**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**", pika: "**B: DEKLARATË**" të Shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit" numrin e repertorit dhe datën e lidhjes së kontratës së qerasë, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti dhe të marrë me qera, numrin e Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) (për prodhim buke) për këtë stabiliment të marrë me qera ku ushtrohet veprimtaria, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar për këtë stabiliment të marrë me qera lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është marrë me **huapërdorje** nga ana e operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: "**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**", pika: "**B: DEKLARATË**" të Shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit" numrin e repertorit dhe datën e lidhjes së kontratës së huapërdorjes, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti dhe të marrë në huapërdorje, numrin e Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) (për prodhim buke) për këtë stabiliment të marrë në huapërdorje ku ushtrohet veprimtaria, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar për këtë stabiliment të marrë në huapërdorje lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Në rastin kur furra e bukës ose linja e prodhimit të bukës është me **marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi** nga ana e operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: "**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**", pika: "**B: DEKLARATË**" të Shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit" datën e lidhjes së kontratës së furnizimit ose të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe emrin e kompanisë me të cilën është lidhur marrëveshja, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti dhe të cilin është marrëveshja e bashkëpunimit ose e furnizimit, numrin e Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.A.1 "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB-ja

(Qendra Kombëtare e Biznesit) (për prodhim buke) për këtë stabiliment me të cilin është marrëveshja e bashkëpunimit ose e furnizimit ku ushtrohet veprimtaria, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar për këtë stabiliment të cilin është marrëveshja e bashkëpunimit ose e furnizimit, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë një ambient të përshtatshëm për realizimin e objektit të prokurimit lidhur prodhimin, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz dhe konkretisht të artikulli "bukë", prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar – Mallra" dhe objekti i prokurimit është blerja e produkteve ushimore për njerëz dhe konkretisht të artikullit "bukë" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 19 "Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi", të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar përcaktohet se:

"1. Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së

këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjine jo shtazore) sipas objektit të prokurimit dhe në rastin konkret të ofertimit për artikullin ushqimor ”bukë” janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës dhe ku deklarojnë se objekti në të cilin ushtrojnë veprimtarinë të jetë i rregjistruar dhe i licensuar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet QKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;

c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;

ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;

d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;

dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;

e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;

ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;

f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;

g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi 1

FUSHA II
USHQIMI DHE SHËNDETI
KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.

b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.

c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë.”.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë prodhime ushqimore dhe meqënëse objekti i prokurimit për Lotin 1 është artikulli ”Buke”, i cili është një produkt me origjinë joshtazore dhe është ushqim për njerëzit, duhet që të jenë të pajisur me licensën e kategorisë II.1.A.1.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedura e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/ç ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore*”, Pika.III/d “Hartimi i kriterëve të veçanta ëpe kualifikim” është rekomanduar që: “d. Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose në përdorim ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet e kërkuara duhet të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe tekniko-teknologjike.”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe pajisjet përfshihet dhe ambienti i përshtatshëm për prodhimin, shpërndarjen dhe tregtimin e artikujve ushqimorë për njëri dhe në rastin konkret meqënëse objekt prokurimi është furnizimi i artikullit “bukë” në rastin kur operatorët ekonomikë janë prodhues të artikullit “bukë” duhet të disponojnë ambientin e përshtatshëm për prodhimin dhe tregtimin e artikullit “bukë”, pra furrë buke ose linjë e prodhimit të bukës, kjo e lidhur edhe me përcaktimin e pikës III/d të Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore*”.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit “mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të furrës ose linjës së prodhimit të bukës, por pa përcaktuar se si disponohen këto ambiente, ju referuam nenit 801 e vijues, nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 142

Sendet janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Neni 801

Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Neni 901

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshtim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 902

Kontrata e huapërdorjes quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

Pra në rastin konkret meqenëse nga shqyrtimi i "KARTELËS INFORMATIVE" me kodin AL022016 të publikuar në faqen e ADISA konstatohet se pjesë përbërëse e dokumentacionit për pajisjen me licensën e kategorisë II.1.A.1 "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" duhet që të dorëzohet dhe planimetria e ambientit ku ushtron aktivitetin dhe në rastin konkret bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme dhe konkretisht ndërtesë, pasuri e paluajtshme.

Në Udhëzim e Ministrisë të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar" pika 3 përcaktohet se:

"3. Të gjithë objektet, në të cilët, Inspektorati Sanitar Shtetëror, pasi bën e ekspertimin paraprak, jep Aktmiratim higjieno-sanitare, merr masa në mbrojtje të shëndetit publik, apo ushtron kontroll për gjendjen shëndetësore të punëmarrësve, si:

c) vënie në shfrytëzim të objekteve:

- të prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve të ndryshme (që përcakton ligji nr. 7643, datë 02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjera që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror) dhe në të gjitha kategoritë e pubimeve, përfshirë dhe ato minerare;

4) Fushat e inspektimit

Për mbrojtjen e shëndetit publik dhe promovimin e shëndetit, Inspektorati Sanitar Shtetëror monitoron dhe kontrollon:

ç) Zbatimin e rregullave higjieno-sanitare në objektet ku prodhohen, ruhen, tregtohen, transportohen, përdoren, apo konsumohen produkte të ndryshme (që lejon ligji nr.7643, dt.02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjera që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror, ligji nr.9108, dt.17.07.2003 "Për sufistancat dhe preparatet kimike", i ndryshuar, ligji nr.10216, datë '21.01.2010 "Për detergjentet", etj), kontrollon respektimin e normave higjienike të standardeve shtetërore dhe kushteve teknike të këtyre produkteve dhe artikujve të tjerë;"

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme të Kodit Civil njësisia e prokurimit arsyeton se format e me të cilat mund ti vihet në dispozicion ambienti i përshtatshëm për prodhimin e produktit objekt prokurim dhe konkretisht të furrës së bukës ose linjës së prodhimit të bukës është pronësia, qiramarrja, huapërdorja, pra në këtë rast operatorët ekonomikë që disponojnë një nga format e mësipërme të duhet të paraqesin dhe dokumentacionin

vërtetues që në rastin e pronësisë është vërtetimi nga rregjistrimi përkatës, të cilin e ka detyrim ligjor dhe që është Certifikata e Pronësisë së ambientit, Licensën II.1.A.1 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” në emrin e tij, Akt Miratimit Higjieno-Sanitar, si dhe Deklaratën nga administratori i stabilimentit që stabilimenti i përmbush standartet tekniko-teknologjike, ndërsa në rastin e qeramarrjes ose huapërdorjes është kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës që prokurohet ose kontrata përkatëse e huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës që prokurohet, por me kushtin që licenca me kodin II.1.A.1 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të jetë në emër të pronarit në rastin kur është pronar i ambientit, në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, Certifikatën e pronësisë së ambientit që është marrë me qera ose huapërdorje, aktin e miratimit higjieno-sanitar në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, si dhe Deklaratën nga administratori i stabilimentit (qeradhënësi ose huamarrësi) që stabilimenti i përmbush standartet tekniko-teknologjike me qëllim që të sigurojë autoritetin kontraktor që disponon dhe ushtron aktivitetin në përputhje me parashikimet e nenit 19 “Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi”, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrisë të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 “Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar”

Nisur nga përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohen parimet themelore të legjislacionit në fushën e prokurimeve publik dhe që janë nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, për operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë mundësi që të disponojnë në një nga format e sipërpërmendura të furrës së bukës ose linjës së prodhimit të bukës, si dhe nuk janë prodhues të artikullit bukë, por janë tregtarë të licensuar për shpërndarjen dhe tregtimin e artikujve ushqimorë dhe që disponojnë thjesht një ambient për magazinimin dhe tregtimin artikujve ushqimore për njerëz, ka përcaktuar në kriterin e mësipërm që mund të paraqesin dhe një marrëveshje funksionale me prodhuesin e artikullit buke (pra me një shoqëri që mund të jetë person fizik ose juridik që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të bukës) të vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës që prokurohet, por me kushtin që përveç licensës së tij të paraqesi dhe dokumentacionin që vërteton disponimin e furrës së bukës ose linjës së prodhimit të bukës dhe konkretisht Certifikatën e pronësisë të stabilimentit ku ushtron aktivitetin, të paraqesi dhe licensën me kodin II.1.A.1 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” në emër të furnizuesit si dhe aktin e miratimit higjieno-sanitar në emër të furnizuesit, me qëllim që të vihet në kushte të barabarta me operatorët ekonomikë që janë disponojnë një furrë buke ose linjë prodhimi buke me një nga format e mësipërme të përcaktuara në Kodin Civil, si dhe për të siguruar autoritetin kontraktor që furnizuesi e ushtron aktivitetin në përputhje me parashikimet e nenit 19 “Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi”, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen

nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 ”Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar”.

Në rastin e operatorit ekonomik ofertues i cili paraqet një kontratë furnizimi duhet që detyrimisht të paraqesë dhe dokumentacionin që vërteton disponimin e ambientit në të cilin do të magazinohet produktin ushqimor objekt prokurimi përpara se ta transportojë në adresat e autoritetit kontraktor dhe që në rastin e disponimit në formën e pronësisë të paraqesë Certifikatën e pronësisë, ndërsa në rastin e disponimit me format e qeramarrjes ose huapërdorjes të paraqesë kontratën e qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës ose kontratën e huapërdorjes për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, pasi kjo ka lidhje me sigurinë e zinxhirit ushqimor sepse në këtë rast kemi të bëjmë me dy subjekte të ndryshme ku njëri prodhon produktin, ndërsa tjetri merr përsipër magazinimin dhe transportin e tij tek autoriteti kontraktor dhe i gjithë ky proces duhet të kryhet sipas përcaktimeve ligjore të sipërpërmendura.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Në raste kur operatori ekonomik ofertes paraqet marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi me prodhuesin e bukës, atëherë duhet të dorëzojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin në emër të prodhuesit të bukës. Kjo certifikatë e prodhuesit të bukës të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 79, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 8 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Për më tepër në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/c “Hartimi i kritereve të veçanta ëpe kualifikim” është rekomanduar që: “c. Operatori ekonomik të jete i pajisur me Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.”.

Nisur nga sa parashtruam më sipër kjo kërkesë është e parashikuar në nenin 77 dhe pika 1 të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik”, në të cilin parashikohet se parashikimet për kërkesat e cilësisë i referohen dhe kualifikimeve të ofertuesit. Në rastin konkret nisur nga fakti që procedura e prokurimit është e llojit mallra ju referuam dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, i ndryshuar nga ku konstatoam se në pikën 8 të kësaj dispozite është parashikuar që autoritetet kontraktore në rastin e kësaj procedure prokurimi mund të përcaktojnë dhe kritere të tjera për kualifikim dhe që në rastin konkret referuar Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik përcaktoi që ofertesit të disponojnë certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018 ose ekuivalente pasi kjo certifikate siguron autoritetin kontraktor se ofertesit i respekton sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, pra kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” është përcaktuar që kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organizëm i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, ku në rastin konkret organizëm kombëtar i akreditimit referuar përcaktimeve të ligjit nr.116, datë 11.09.2014 ”Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” është Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit.

Për më tepër nisur nga përcaktimet e mësipërme u përcaktua që në rastin kur ofertesit paraqesin oferte në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë u vlerësua si e nevojshme që në këtë rast secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018, pasi kjo është një kërkesë që e parashikon legjislacioni në rastin e kualifikimeve që i referohet kualifikimeve të ofertesit, si dhe është e lidhur ngushtë dhe në proporcion me objektin e prokurimit, pasi ka lidhje me sigurinë ushqimore/

Në të njëjtën kohë u përcaktua që në rastin kur ofertesit kanë kontratë osë marrveshje bashkëpunimi ose furnizimi me një prodhues atëherë ky ofertes duhet të paraqesë certifikatën ISO 22000:2018 të prodhuesit të bukës, duke u vlerësuar nga ana jonë si një kërkesë që e parashikon legjislacioni për prokurimin publik, si dhe si një kërkesë që është në proporcion me objektin e kontratës, pasi ka lidhje me sigurinë ushqimore dhe konkretisht me procesin e prodhimit të bukës, ndërsa ofertesit në këtë rast është përgjegjës për procesin e magazinimit, transportit dhe tregtimit të bukës.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti ATP të përshtatshëm për transportin e bukës.

- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës është pronar i mjetit duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik dhe leje higjieno-sanitare të mjetit.
- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës ka marrë me qera mjetin duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: kontratën noteriale të qerasë, leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik, leje higjieno-sanitare të mjetit.

(dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi)

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Në rastin kur mjeti i transportit është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjeti i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisë së siguracionit të mjetit të transportit, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisë së saj në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e certifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Në rastin kur mjete i transportit është marrë me qera nga operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit; numrin e repertorit të kontratës së qerasë dhe datën hartimit të kësaj kontrate, targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjete i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisë së siguracionit të mjetit të transportit në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisë së saj, numrin e ertifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohej se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë burimin e nevojshëm teknik dhe konkretisht një automjet të përshtatshëm për realizimin e kontratës, pasi nga ana jonë duke patur parasysh se natyrën e furnizimit e cila bëhet cdo mëngjes dhe ku furnizohen 4 konvikte nga të cilat 3 ndodhen brenda unazës së vogël të qytetit të Tiranës dhe 1 konvikt ndodhet në Kamëz vlerësoam që 1 automjet për shpërndarjen e bukës është mëse i mjaftueshëm.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/ç ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/e “Hartimi i kriterëve të vecanta ëpe kualifikim” është rekomanduar që: “e. Operatori të ketë në pronësi ose në përdorim automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportin e mallrave, automjet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportin e mallrave në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe që plotësojnë kushtet higjieno sanitare.”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t'u vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe paisjet përfshihet dhe automjeti i nevojshëm për kryerjen e furnizimit i cili referuar edhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit duhet të jetë i llojit ATP (jo frigoriferik).

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit "mallra" duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e bukës, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rregullor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 81

Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjete;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjete dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të tretëve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.

Neni 83

Dhënia me qira pa drejtues mjete

1. Për zbatimin e këtij neni, një mjet quhet i caktuar për dhënie me qira pa drejtues mjete kur qiradhënësi, kundrejt pagesës, detyrohet të verë në dispozicion të qiramarrësit, me kërkesën e këtij të fundit, vetë mjetin.

2. Mund të caktohen për dhënie me qira të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, përfshirë edhe mjetet e caktuara për transportin e mallrave, me ngarkesë të plotë, e cila është mbi 1,5 ton, si dhe mjetet, të ndryshme nga autoveturat, të caktuara për transportin e njerëzve.

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete me motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:

- a) lejeqarkullimin;
- b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
- c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
- ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
- d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Referuar dispozitave të mësipërme përcaktuam se mjetet mund të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues ose me kontratë qeraje, ku në rastin e pronësisë mbi mjetin të paraqitet, leja e qarkullimit të mjetit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, ndërsa në rastet kur automjeti është me qera të paraqitet kontrata e qerave dhe dokumentacioni i mjetit në emër të qeradhënësit si në vijim: leja e qarkullimit të mjetit në emër të qeradhënësit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit.

Nisur nga fakti që automjeti i përcaktuar në këtë kriter do të bëjë transport mallrash dhe në rastin konkret të artikullit “bukë” dhe meqënëse ka rregullim të vecantë ligjor lidhur me transportin e mallrave dhe për të shmangur ndonjë situatë të bllokimit të mjetit nga ana e policisë për shkak të mungesës së dokumentacionit, cka do të illte dhe vonesa në furnizimin me artikullin e sipërpërmendur objekt prokurimi ju referuam nenit 46 të ligjit nr, 8380, datë 18.3.1998 :Për transportet rrugore” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 1

- a) Ky ligj do të zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.
- b) Ky ligj do të zbatohet, gjithashtu, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të mallrave për të tretë, me qira ose për nevojat e veta brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.
- c) Transporti rrugor i mallrave për të tretë dhe me qira ose për nevojat e veta përshin ngarkimin, shkarkimin dhe lëvizjen bosh dhe plot të mjetit.

KREU III.1

TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PËR TË TRETË

Neni 41

Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

KREU III.2

TRANSPORTI I MALLRAVE PËR VETE

Neni 45

Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë.

Neni 46

(ndryshuar ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.

Neni 47

Llojet e mallrave për transport brenda vendit për nevojat e veta që nuk kanë nevojë për certifikatë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë dhe certifikaten ose lejen e transporti të vlefshme në momentin e ofertës, por për automjetet me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton nuk kërkohet që të paraqitet certifikata ose leja e transportit, pasi mjetet me këtë kapacitet mbajtës nuk pajisen me leje apo certifikatë transporti.

Nisur nga natyra e mallrave që do të transportohen të cilat janë produkte ushqimore lidhur ju referuam Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar" përcaktohet se:

"Mjetet e transportit

Në se subjekti disponon dhe përdor mjete për transportin e produkteve të ndryshme, përdorimi i të cilëve ka, apo mund të ketë ndikime në shëndetin publik, mjetet e transportit duhet të përmbushin kërkesat higjeno-sanitare dhe sipas destinacionit të tyre,

- të jenë të ndërhuara me materiale veshëse të tillë që të mos ndikojnë (dhe ndikohen) negativisht ndaj produkteve që transportohen dhe ndaj pastrimit/larjes;
- të jenë të mbyllur/mbuluar, përfshi edhe hemeticitetin e derës/dyerve, për të siguruar mbrojtjen e produkteve që transportohen nga plihurat, rrezet e diellit, shiu dhe nga agjentët atmosferikë dhe mjedisorë në përgjithësi;

- të kenë paisje ftohëse (autofrigorifer) për produktet që kërkojnë domosdoshmërisht transport në temperatura të caktuara;

- të kenë paisje te duhura (barëse, mbërthyes, arka, etj) për vendosjen dhe mbajtjen e produkteve që transportohen;

Mjetet e transportit duhet të përdoren për destinacione të caktuara, duke mos kryer shërbime dhe mostransportuar njëkohësisht produkte me veçori të ndryshme (njerëz dhe mallra në përgjithësi, produkte joushqimore dhe ushqimore, produkte të ambalazuara dhe të paambalazuara, etj).

Autobotët për transport lëngjesh, të jenë të ndërtuar/veshur me materiale të tillë që për karakteristikat e lëngjeve që mbarten, të mos ndikojnë në përbërjen e tyre.

Pas përfundimit të ransporteve dhe pas punës në përgjithësi, mjetet e transportit pastrohen, dhe sipas destinacionit të tyre, mekanikisht (me fshesë, furca, mjete fërkuese, etj) apo me tretësira pastruese (si psh tretësirë sode 0.5 – 1 -2 %, ujë i nxehtë 60-70 °C, me avull uji, etj) thjesht apo me presion, pasuar me shpëlarje përfundimtare me ujë të pastër.

Mjetet e transportit sa më sipër pajisen me Aktmiratim Higjeno-Sanitar.”.

Pra nisur nga parashikimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë Aktin e Miratimit-Higjeno-Sanitar të vlefshëm të automjetit.

2.3.5. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të disponojë në stafin e tij 1 (një) punonjës, si me poshtë:

- 1 (një) shofer
- 1 (një) punëtor
- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune e vlefshme, leja drejtimi të automjetit me kategorinë përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetin në emër të punonjësit.
- Për punonjësit e punësuar punëtore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune e vlefshme,

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Për të dëshmuar së disponon në stafin e tij 1 (një) shofer operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” datën e kontratës së punës, ermin e punëmarrësit dhe numrin e lejes së drejtimit të automjetit të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Sqarim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës që prokurohet me anë të së cilës dëshmon se ka në stafin e tij 1 (një) punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetit që do deklarojë se disponon me qëllim që të dëshmojë se mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore , brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret duhet të kenë dhe punonjës të punësuar për realizimin e kontratës.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/c "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Lidhur me numrin e punonjësve që duhet të disponojnë operatori ekonomik, meqenëse kjo dispozitë nuk përcakton numrin e punonjësve, por thjesht faktin që duhet kërkuar fuqi punonjëse në raport me objektin e kontratës që prokurohet, njësia e prokurimit nisur nga objekti i kontratës e cila ka si qëllim furnizimin me ushqimeve të 4 konvikteve në administrim të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, gjykohet se është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar 2 (dy) punonjës nga të cilët 1 (një) punonjës duhet të kryejë punën e shoferit me qëllim që të bëjë transportin me mjet të ushqimeve nga vendi ku magazinohen në adresat e pesë konvikteve, si dhe 1 (nje) punonjës për ngarkimin dhe shkarkimin e mallit objekt prokurimi, te domosdoshem për kryerjen e ngarkimit dhe shkarkimit të mallit.

Lidhur me dokumentacion vërtetues përsa i përket disponimit të dy personave të punësuar, njësia e prokurimit, ju referuar parashikimeve ligjore si më poshtë:

Së pari, në Kreut V, neni 11, pika 1/e, neni 12 dhe neni 21, pika 1, të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet si më poshtë:

KREU IV

Neni 11

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
- c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore
- d) Kontrata kolektive e punës
- e) Kontrata individuale e punës
- f) Rregullorja e brendshme
- g) Zakonet lokale dhe profesionale.

Neni 12

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të

pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.

Neni 21

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

Së dyti, në nenin 14, të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë:

Neni 14

Operatorët ekonomikë

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Së treti, në nenin 115 dhe nenin 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë:

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:
 - a) lejeqarkullimin;
 - b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
 - c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
 - ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
 - d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Neni 115

Kategoritë e lejedrejtitimit për drejtimin e motomjeteve dhe automjeteve

1. Ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod.2. Përgatitja e kandidatit për lejedrejtimi bëhet në autoshkolla dhe provimet e ftësisë për lejedrejtimi duhet të bëhen pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pasi

të plotësohen kushtet e caktuara fizike e mendore. Ministria përgjegjëse për transportin përcakton procedurën për lëshimin, përditësimin dhe dhënien e dublikatës, përmes një sistemi informatik, të lejedrejtimit, si dhe certifikatave të kualifikimeve profesionale, duke pasur si qëllim thjeshtimin e procedurave administrative. Kandidati për drejtues mjeti mund të regjistrohet dhe të kryejë kursin e teorisë e të praktikës në çdo drejtori rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pavarësisht nga regjistrimi në gjendjen civile.

3. Lejedrejtimi, sipas modelit të Bashkimit Europian, siç përcaktohet me vendim të Këshillit Ministrave, ndahet sipas kategorive dhe aftësive në drejtimin e mjeteve, të përcaktuara për secilën nga kategoritë e mëposhtme:

Kategoria AM:

a) ciklomotorë me dy rrota, kategoria L1, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo me shumë se 45 km/h, fuqia cilindrike e të cilit është më e vogël apo e barabartë me 50 cm³, nëse është me djegie të brendshme, apo fuqia maksimale e vazhdueshme është më e vogël apo e barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

b) mjete me ose pa kosh dhe mjete me tri rrota, kategoria L2, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h dhe me motor me fuqi cilindrike më të ulët apo të barabartë me 50 cm³, nëse ky është me ndezje të komanduar, apo kur fuqia e tij maksimale neto është më e ulët ose e barabartë me 4 kË, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose për ata që fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

c) mjete me katër rrota të lehta, kategoria L6, masa bosh e të cilave është më e ulët ose e barabartë me 350 kg, duke përjashtuar masën e baterive për automjetet elektrike me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h, me fuqi cilindrike të motorit më të ulët ose të barabartë me 50 cm³, për motorët me ndezje të komanduar, ose ata të cilët fuqinë maksimale neto e kanë më të ulët apo të barabartë me 4 kW, për motorët e tjerë me djegie të brendshme; ose ata të cilët fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kW, për motorët elektrikë;

Kategoria A1:

a) motomjet me cilindrata jo më shumë 125 centimetër kub dhe me fuqi jo më shumë se 11 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,1 kË/kg;

b) tricikël me një fuqi jo më të madhe se 15 kË;

Kategoria A2: motomjet me fuqi jo më shumë se 35 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,2 kË/kg, që nuk rrjedh nga një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij;

Kategoria A: motomjet me fuqi më shumë se 15 kË;

Kategoria B1: motomjet me katër rrota, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të kategorisë AM, masa pa ngarkesë e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 400 kg ose 550 kg për mjetet e destinuar për transport mallrash (kategoria L7), përjashtuar masën e baterive për automjetet elektrike, të cilat fuqinë maksimale neto të motorit e kanë më të ulët ose të barabartë me 15 kË. Këto mjete konsiderohen si mjete me tri rrota dhe janë në përputhje me rregullat e aplikueshme për mjetet e kategorisë L5;

Kategoria B: mjet motorik me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3 500 kg dhe jo më shumë se 8 ndenjëse, përjashtuar ndenjësen e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg, duke u siguruar që masa maksimale e autorizuar e këtij kombinimi të mos kalojë 4 250 kg. Në rast se kombinimi i kalon 3 500 kg, drejtuesi duhet t'i nënshtrohet një trajnimit dhe provimit të posaçëm;

Kategoria BE: kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios nuk i kalon 3 500 kg;

Kategoria C1: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg, por jo më shumë se 7 500 kg ose i projektuar dhe i konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria C1E: kombinimi i një mjeti motorik të kategorisë C1 dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg, por masa maksimale e autorizuar e kompleksit të formuar nuk i kalon 12 000 kg;

Kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje apo gjysmërimorkioje, masa e autorizuar e të cilave i kalon 3 500 kg, me kusht që, në masë, kombinimi i autorizuar të mos i kalojë 12 000 kg;

Kategoria C: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg ose i projektuar dhe konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria CE: kombinimi i një mjeti të kategorisë C me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg;

Kategoria D1: mjet motorik i projektuar dhe konstruktuar për jo më shumë se 16 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit, dhe me gjatësi maksimale që nuk i kalon 8 m. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D1E: kombinim i një mjeti të kategorisë D1 me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750kg;

Kategoria D: mjet motorik i projektuar dhe i konstruktuar për më shumë se 8 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D

E: kombinimi i një mjeti të kategorisë D me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme ligjore njësia e prokurimit vendosi që dokumentacioni vërtetues lidhur me punësimin e dy punonjësve në stafin e operatorëve ekonomik ofertues vendosi që të përcaktojë kontratën e punës sipas formës së parashikuar në pikën 1, të nenit 21 të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurim e cila është përcaktuar si një vit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit,

Ndërsa lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzojë operatori ekonomik ofertues për të vërtetuar se ka të punësuar një punonjës që kryen detyrën e shoferit, i cili duhet të jetë i pajisur me lejedrejtimi mjeti ju referuam nenit 115 dhe nenit 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. ku meqënëse nuk

kemi parashikuar kapacitetin mbajtës të mjetit të përshtatshëm për transportin e mallrave objekt prokurimi, por e kemi lënë në mundësinë që ka për disponimin e një mjeti të tillë me kapacitet mbajtës të caktuar vetë operatori ekonomik ofertues, atëherë kemi përcaktuar se shoferi duhet të paraqesë lejen e drejtimit të këtij mjeti, ku kjo lejedrejtimi duhet të jetë sipas kategorisë që i përket mjeti që disponon sipas kriterit të përcaktuar në Pikën 2.3.4 të “Kapacitetit teknik” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues në rast se është vetë prodhues i bukës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë kontratë pune, diplomë, librezë shëndetësore të vlefshme, si dhe listëpagesën e shoqërisë për muajin gusht 2024, ku të jetë i përfshirë teknologu ushqimor.

Në rast se kur operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i bukës, por ka një kontratë qeraja apo kontratë huapërdorje apo një marrëveshje bashkëpunimi apo një marrëveshje furnizimi me shoqërinë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të bukës duhet të vërtetojë se prodhuesi i bukës me të cilin ka këtë marrëveshje të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë kontratën e punës, diplomën, librezën shëndetësore të vlefshme që disponon teknologu ushqimor i prodhuesit të bukës, si dhe listëpagesën e shoqërisë së prodhuesit të bukës për muajin gusht 2024, ku të jetë i përfshirë teknologu i tij ushqimor me të cilin ka lidhur kontratën e punës të paraqitur.

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues është vetë prodhues i bukës, duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” emrin e teknologut ushqimor, datën e kontratës së punës, numrin dhe datën e diplomës dhe instiucionin arsimor që e ka lëshuar, numrin e librezës shëndetësore.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i bukës, por ka një kontratë qeraja apo kontratë huapërdorje apo një marrëveshje bashkëpunimi apo një marrëveshje furnizimi me shoqërinë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të bukës, duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” emrin e teknologut ushqimor të punësuar në stafin punonjës të shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të bukës, datën e kontratës së punës me punëmarrësin e shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të bukës, numrin dhe datën e diplomës dhe instiucionin arsimor që e ka lëshuar të teknologut ushqimor të punësuar në stafin e shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e

prodhimit të bukës, numrin e librezës shëndetësore të teknologut ushqimor të punësuar në stafin e shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të bukës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret duhet të kenë dhe punonjës të punësuar për realizimin e kontratës.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/b "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose".

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës që janë të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe në rastin konkret meqënëse objekti i prokurimit është blerje të artikullit "bukë" atëherë duhet që të ketë të punësuar punonjës që kanë formimin profesional për kryerjen e procesit të prodhimit të bukës dhe për më tepër që ky artikull do të shërbehet një kategori që janë delikat siç janë fëmijët.

Lidhur me numrin e punonjësve që duhet të disponojë operatori ekonomik, meqënëse kjo dispozitë nuk përcakton numrin e punonjësve, por thjesht faktin që duhet kërkuar fuqi punonjëse në raport me objektin e kontratës që prokurorët, njësia e prokurimit nisur nga objekti i kontratës e cila ka si qëllim furnizimin me ushqimeve të 5 konvikteve në administrim të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, gjykohet se është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar 1 (një) punonjës i cili ka formimin profesional për kryerjen e procesit të prodhimit të bukës.

Lidhur me dokumentacionin vërtetues përse i përket disponimit 1 (një) punonjës i cili ka formimin profesional për kryerjen e procesit të prodhimit të bukës, njësia e prokurimit, ju referuar parashikimeve ligjore si më poshtë:

Së pari, në nenin 40, pika 1 dhe 2 të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë:

Neni 40

Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

(Nryshuar me Ligj Nr. 10209, dt.23.12.2009. Botuar ne Fl.z. Nr. 194. dt. 20. 01.2010).

1. Personat fizikë dhe juridikë ushtrojnë veprimtari ekonomik-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
2. Personat e regjistruar sipas këtij ligji pajisen me numër identifikimi unik, të gjeneruar elektronikisht, i cili shërben si numër i identifikimit tatimor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore.

Së dyti, në Udhëzimin Nr.6 e Minsitrit të Financave dhe Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale, datë 18.1.2005 "Për dokumentacionin e deklarimit dhe pagesës së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" përcaktohet si më poshtë:

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar, janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore bazuar në dokumentacionin e përcaktuar më poshtë:

"Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore" E-SIG 011/a", (pa plotësuar pjeset e përfitimeve), i cili dorëzohet në degën e bankës ose zyrën e Postës

Shqiptare sh.a. ku paguhen kontributet, sipas përcaktimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

“Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shëndetësore” E-SIG 012/a”, i cili dorëzohet në degën e bankës ose zyrën e Postës Shqiptare sh.a. ku paguhen kontributet, sipas përcaktimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

“Formulari E-SIG 025/a “Listëpagesa e Sigurimeve Shoqërore, Sigurimeve Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga punësimi”, i cili dorëzohet në degën e tatimeve ku është i regjistruar tatimpaguesi;

Formulari E-SIG 27/a “Pasqyra e të punësuarve rishtazi dhe e të larguarve”, i cili dorëzohet në Degën e Tatimeve (në rastet kur ka të punësuar të rinj, të ripunësuar ose të larguar).

Dokumentat e mësipërme dorëzohen në afatet që vijojnë:

Nga personat juridike, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të takses vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë, apo çdo funksion tjetër, trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

Nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-se, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit;

Nga personat juridike të regjistruar si tatimpagues të takses vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Kur edhe pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë, apo çdo funksion tjetër, trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

Nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të takses vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit;

Së treti, në pikën 1 ”Regjistrimi në organin tatimor” dhe pika 4 ”Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve” të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.4, datë 30.01.2006 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar,

1. REGJISTRIMI NË ORGANIN TATIMOR

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisin personat për të cilët paguajnë kontribute me Numrin e Sigurimit Shoqëror (NSSh), të cilin e terheqin nga organet e sigurimeve shoqërore. Ky numer përfaqëson personin, është unik dhe i papërsëritshëm për çdo person tjetër. Pra i njëjti person, pavarësisht se gjatë jetës mund të ndryshojë subjektet ku punësohet, mban të njëjtin numer të sigurimit shoqëror. Numri i Sigurimit Shoqëror, për personat e punësuar gjatë atij muaji, vendoset në Formularin numer E-SIG 025/a “Listëpagesa e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, në kolonën e parë të tij, krahas emrit të personit të punësuar

4. AFATET E DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË KONTRIBUTEVE

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit. Deklaratat paraqiten dhe kontributet paguhen në afatet e mëposhtme:

Personi që detyrohet të paguajë kontributet	Kontributet që paguhen	Shpeshtesia e deklarimit dhe pageses	Afati për deklarimin dhe pagesen
Personi juridik i regjistruar si tatimpagues i TVSH	a) Kontributet që mbahen nga paga e punemarresve b) Kontributet e punëdhënësit për punemarresit	Mujore	Jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës
Personi fizik i regjistruar si tatimpagues i TVSH	a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes c) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit	Mujore	Jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës
Personi juridik i regjistruar si tatimpagues i takses vendore mbi biznesin e vogël.	a) Kontributet që mbahen nga pagat e punëmarrësve b) Kontributet e punëdhënësit për punemarresit	Per çdo tremujor brenda dates 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik	Jo më vonë se datat: 20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; 20 Janar.
Personi fizik i regjistruar si tatimpagues i takses vendore mbi biznesin e vogël.	a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes c) Kontributet që	Per çdo tremujor brenda dates 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik	Jo më vonë se datat: 20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; 20 Janar.

	mbahen nga paga e punëmarrësve d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit		
--	---------------------------------------------------------------------------------------	--	--

Së katërtri, në Kreut V, neni 11, pika 1/e, neni 12 dhe neni 21, pika 1, të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet si më poshtë:

KREU IV

Neni 11

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
- c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore
- d) Kontrata kolektive e punës
- e) Kontrata individuale e punës
- f) Rregullorja e brendshme
- g) Zakonet lokale dhe profesionale.

Neni 12

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.

Neni 21

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

Së pesti, në nenin 14, të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë:

Neni 14

Operatorët ekonomikë

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Së gjashti, në VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, përcaktohet si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Klasifikimi i Listës Kombëtare të Profesioneve, e njohur shkurtimisht si “LKP”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.
 3. Lista Kombëtare e Profesioneve (LKP) zbatohet nga agjencitë statistikore, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 4. Kodet statistikore të Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të përdorura deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zëvendësohen me kodet e parashikuara në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), bashkëlidhur këtij vendimi.
 5. Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore kryejnë përditësimin e informacionit statistikor zyrtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Ngarkohen institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3, për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Grupi-njësi (Profesioni)

“Bukëpjekës”

Kodi i profesionit: 7512

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Bukëpjekës”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Bukëpjekësi merret me sigurimin e lëndës së parë të nevojshme për prodhimin e produktit të kërkuar, përgatit makineritë apo pajisjet për përgatitjen e brumit për bukë të llojeve të ndryshme, bën pjekjen, ambalazhimin dhe ruajtjen e tyre. Ai mund të punësohet në kompani të ndryshme shërbimi ushqimor, në shoqëri tregtare që kanë reparte të shërbimit ushqimor, apo edhe të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore:

Bukëpjekësit kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Marrin porosinë nga klientët për llojin dhe formën e bukës që do të prodhojnë;
- b) Bëjnë preventivin e materialeve të duhura për prodhimin e brumit për sasinë e produktit të kërkuar;

- c) Sigurojnë lëndën e parë të nevojshme për prodhimin e produktit të kërkuar;
- d) Përgatitin makineritë apo pajisjet për punë;
- e) Kryejnë peshime apo matje të sasisë së lëndës së parë që do të përdorin për prodhimin e brumit të nevojshëm për produktin e kërkuar;
- f) Hedhin sasi të duhura të miellit, kripës, ujit, majasë apo përbërësve të tjerë, (sipas llojit të produktit që do të prodhohë) në brumatriçe apo enën e duhur për t'u përzier;
- g) Bëjnë përzierjen e masës me dorë apo brumatriçe deri sa të bëhet lidhja e brumit;
- h) Nxjerrin brumin nga brumatriçja apo ena ku është bërë përzierja dhe e lënë për çlodhje;
- i) Hedhin brumin në format e duhura(tava);
- j) Vendosin produktet në dhomën e ardhjes, duke respektuar kushtet teknike dhe kohën e duhur;
- k) Bëjnë nxehjen e furrës në temperaturën e duhur;
- l) Bëjnë pjekjen e produktit në temperaturën dhe kohën e duhur;
- m) Bëjnë lëshimin e avullit në furrë gjatë kohës së pjekjes;
- n) Nxjerrin produktin e bukës nga tava dhe e vendosin në raftet përkatës për të kulluar;
- o) Bëjnë prerjet dhe ambalazhimet e nevojshme;
- p) Ruajnë produktet dhe lëndën e parë në kushtet e duhura;
- q) Pastrojnë makineritë dhe pajisjet e përdorura;
- r) Realizojnë detyra të tjera të ngjashme;
- s) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;
- t) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

- a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional në këtë fushë;
- b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një bukëpjekës mund të ndër marrë disa funksione mbikëqyrëse. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin teknolog ushqimor.

Për të zhvilluar aktivitet privat në këtë fushë bukëpjekësit i duhet regjistrimi për ushtrim ktiviteti siperson fizik apo juridik, sipas rastit.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si brumëgatues, bukëpjekës, punëtor i furrave të bukës, bërës me dorë i bukës së tavolinës etj.

Së shtati, në nenin 19 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar përcaktohet se:

"Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrin revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqëruës, numrin e regjistrit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Së teti, lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet OKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

- a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;
- b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;
- c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;
- ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;
- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e OKL-së;
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet OKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që OKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi 1

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.

b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.

c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë.”.

Tabela 1

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit	a) Drejtuesi teknik (sipas specifikimeve)	a) Certifikatë për drejtuesin teknik b) akte që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a) standardet teknikoteknologjike b) higjieno-sanitare (sipas specifikimeve)	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve

Së nënti, meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;”.

Së dhjeti, në Kartelën Informuese me Kodin: AL022016, të publikuar në faqen zyrtare të ADISA (Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, në varësi të Kryeministrisë) krijuar me ligjin nr. Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar se që të pajisesh me Licensë Nënkategoria: II.1.A.1. “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” duhet të kësh të punësuar një drejtues teknik me kontratë pune dhe me certifikatë profesioni si më poshtë:

5. Çfarë	Dokumente provuese :			
dokumentesh duhen për aplikim?	1	Certifikatë për Drejtuesin Teknik: - Arsim i lartë në degën kimi ose teknologji ushqimore/ Arsim i lartë në degën Veterinari në rastin e produkteve me origjinë shtazore ose - Arsim i mesëm profesional ushqimor ose, - Dëshmi specializimi brenda ose jashtë vendit në fushën e teknologjisë ushqimore	Institucioni Arsimor përkatës	Po
	4	Kontratë pune me Drejtuesin Teknik	Aplikanti/ Noteri	Po

Së njëmbëdhjeti, nisur nga natyra e mallrave që do të transportohen të cilat janë produkte ushqimore lidhur ju referuam Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar" përcaktohet se:

"Punonjësit

Punonjësit të jenë me uniformë pune, të rrregullt, në raste të veçantë dhe për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, uniforma të jetë e posaçme përsa i përket llojit / përbërjes të veshjes, përdorimit të përparseve dhe këpucëve të veçanta, apo çizmeve, dorezave, kapuç, maska, syze mbrojtëse, etj).

Në shërbim të punonjësve, në objekt / objekte të disponohet vend i veçantë, me pajisjet përkatëse (rafte, garderobë, varëse etj).

Punonjësit të jenë të pajisur me Libreza Shëndetësore, të cilat duhet të jenë në çdo kohë në vendin e punës.

Çdo punonjës në objekt / objekte zbaton rregullat e higjienës personale.

Në ndërmarrjet me mbi 15 punonjës, duhet të ketë shërbim mjekësor (part time ose kohe të plote) dhe të disponohet dokumentacioni përkatës, kartelat mjekësore për çdo punonjës dhe realizimi i kontrolleve mjekësore periodike.”.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme ligjore njësia e prokurimit vendosi që meqënëse në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.1 ”Kapaciteti profesional të operatorëve ekonomikë” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit ku është parashikuar që ofertuesi duhet të ketë në pronësi osë me marrveshje bashkëpunimi një furrë buke ose linjë prodhimi buke, atëherë për të rritur garancinë që operatori ekonomik ofertues ka kapacitetin profesional lidhur me pasjen të punësuar në stafin e tij të një punonjësi me kapacitet profesionale lidhur me realizimin e objektit të prokurimit e gjykoj të nevojshme dhe të mbështetur në ligj kërkesën që të ketë të punësuar në stafin e tij një punonjës të arsimuar në degën ”Teknologji ushqimore”, i cili sikurse përcaktohet dhe në bazën ligjore të sipërpërmendur është në rolin e drejtuesit teknik dhe që ka arsimin profesional. Ndonëse në kartelen e ADISA-s të sipërpërmendur përmenden dhe profesione të tjera, sqarojmë së u zgjodh profesioni i ”Teknologut ushqimor” pasi arsimimi në degën e veterinarisë aplikohet në rastin e prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore, ndërsa arsimit në degën kimi nuk na jep siguri për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, pasi referuar përcaktimit në VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, përta i përket profesionit të “Bukëpjekës” është përcaktuar se niveli më i lartë i këtij profesioni arrihet kur diplomohesh në arsimin e lartë në nivelin teknolog ushqimor dhe për më tepër që operatorët ekonomikë ofertues që kanë të punësuar një drejtues teknik me këtë nivel arsimimi na jep sigurinë më të madhe lidhur me realizimin me cilësi të objektit të kontratës që po prokurohet dhe që është blerja e artikullit “bukë”, e cila do të konsumohet nga fëmijët në mensat e konvikteve që administrohen nga autoriteti ynë kontraktor.

Lidhur me dokumentacioni vërtetues lidhur me punësimin e 1 (një) teknologu ushqimor në stafin e operatorëve ekonomik ofertues njësia e prokurimit vendosi që të përcaktojë si dokumentacion provues kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurim e cila është përcaktuar si një vit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe diplomën e shkollës së lartë në degën “Teknologji ushqimore” parashikuar në pikën 1, të nenit 21 të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 2 dhe Aneksin 1 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, si dhe përcaktimeve të Kartelës Informuese me Kodin: AL022016, të publikuar në faqen zyrtare të ADISA (Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, në varësi të Kryeministrit), detyrimin që operatori ekonomik ofertues të paraqesin listëpagesat e formatit E-SIG 025/a për 1 (një) teknologu ushqimor të siguruar, ndërsa për periudhën kohore për të cilën duhet të paraqesi këto listëpagesa njësia e prokurimit nisur nga data e parashikuar për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi e cila është në muajin shtator 2023, si dhe nisur nga përcaktimet ligjore të mësipërme lidhur me afatin kohor të deklarimit të listëpagesat e formatit E-SIG 025/a në varësi të formës së operatorit ekonomik ofertues, i cili sipas parashikimeve të nenit nenit 14 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” këto ofertues mund të jenë përsona fizik ose juridik

dhe meqënëse në nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është parashikuar që në procedurat e prokurimit publik të llojit “E Hapur e Thjeshtuar” kriteret kualifikuese të hartohen në mënyrë të thjeshtuar me qëllim që të sigurohet pjesmarrja e biznesit të vogël dhe të mesëm, ndonëse kjo procedurë prokurimi është e llojit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” gjykuam që periudha kohore për paraqitjen e listëpagesave të jetë për muajin e gusht 2023.

Gjithashtu nisur nga përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 ”Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar” është kërkuar që për teknologun ushqimor të paraqitet edhe librezat dhëndetësore.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, i cili ka marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi me një prodhues buke, duhet të paraqes një deklaratë të lëshuar nga prodhuesi i bukës me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

ARGUMENTIMI: Nisur nga fakti që respektimi i kërkesave të sigurisë ushqimore për furnizimin me ushqime për konviktet ku jetojnë fëmijë është shumë i rëndësishëm, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 dhe Nr.8541, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/g; (V.O: PER DEKLARATËN)

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur një deklaratë.

2.3.9. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **Raport/Fletë Analizë për treguesit Fiziko-Kimik**, lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës jo më herët se 30 ditë nga data e zhvillimit të procedurës, për artikullin:

Bukë gruri me rreze 75%.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të realizojë kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie reputacionin për të prodhuar dhe tregtuar mallra me standarte cilësie gjykon si të nevojshme që produkti që do të ofrohet nga operatorët ekonomikë ofertues të jetë sipas kërkesave të cilësisë.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 6/d "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

d) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuarra, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore*”, Pika.III/e “*Hartimi i kriterëve të veçanta ëpe kualifikim*” është rekomanduar që:

“I.2. Për ushqimet dhe produktet ushqimore.

Në vendosjen e specifikimeve teknike për këtë kategori të produkteve duhet të mbahet në konsideratë që, për të gjithë produktet ushqimorë do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për Ushqimin.

Ndërmjet të tjerave, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në specifikimet teknike që:

b. Raport analiza përkatëse duhet të jetë sipas llojit të produktit, numrit të Lotit, dhe jetëgjatësisë së produktit dhe të ketë lidhje me produktin/mostrën e ofertuar. Në këtë raport analizë duhet të jetë shënuar: emërtimi i produktit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me produktin e ofertuar.

c. Produkti kur të lëvrohet, duhet të jetë i shoqëruar me çertifikatën e origjinës dhe fletë analizë për treguesit e sigurisë e cilësisë, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

d. Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të produktet të ofertuar/mostrës që përfaqësojnë artikullin duhet të përputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe të Standardit Shtetëror përkatës. Standardet shtetërore për karakteristikat e produkteve ushqimore janë të disponueshine dhe janë të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit (DPS) në faqen e internetit www.dps.gov.al.”.

Në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit janë përcaktuar specifikimet teknike të produktit objekt prokurimi për Lotin I, ku është përcaktuar se artikulli “bukë” duhet të jetë sipas standartit shtetëror SSH 1411:1987 ose ekuivalentin e tij dhe ku ky standart ka të përcaktuar parametrat organo-leptikë dhe fiziko-kimikë që duhet të plotësojë artikulli “Bukë” sipas këtij standarti.

Ndërkohë në nenin 5, të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet si më poshtë:

Neni 5

Procesi i akreditimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton:

- a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues;
- b) organe certifikuese të sistemeve të me- naxhimit;
- c) organe certifikuese të personelit;
- ç) organe certifikuese të produkteve;
- d) organe inspektuese;
- dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;
- e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.

2. Akreditimi për çdo fushë të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, bëhet kundrejt tarifave të akreditimit, të paguara nga organi i vlerësimit të konformitetit. Llojet, masa dhe mënyra e pagesës së tarifave për çdo fushë akreditimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kryen trajnime për palët e treta, kundrejt tarifave përkatëse. Llojet, masa dhe mënyra e pagesës së këtyre tarifave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit vlerëson nëse një organ i vlerësimit të konformitetit është kompetent për të kryer aktivitete specifike të vlerësimit të konformitetit dhe lëshon një certifikatë akreditimi për ta zyrtarizuar këtë.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit mbikëqyr çdo organ të vlerësimit të konformitetit, të cilit i ka lëshuar certifikatë akreditimi.
6. Për vlerësimin/mbikëqyrjen e kompetencës teknike të organeve të vlerësimit të konformitetit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon një grup me specialistë vlerësues të institucionit dhe/ose të jashtëm, vendas apo të huaj, të cilët veprojnë gjithmonë në emër të këtij institucioni.
7. Shpenzimet e akreditimit, kur vlerësuesi teknik është i huaj, përfshijnë:
 - a) pagesën e vlerësuesit, sipas tarifave të vendit të origjinës, por, gjithmonë, në marrëveshje me organin e vlerësimit të konformitetit që ka aplikuar për akreditim;
 - b) shpenzimet e akomodimit (fjetje, ushqim) dhe transport;
 - c) çdo tarifë tjetër të procesit të akreditimit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Kur vlerësimi teknik bëhet nga vlerësues vendas, tarifa e akreditimit përfshin tarifën e përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni. Masa e pagesës së vlerësuesve vendas që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
9. Pagesat e vlerësuesve teknikë, të huaj dhe atyre vendas, që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, nga të ardhurat, sipas pikës 2 të nenit 15, të këtij ligji.
10. Në rast se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit konstaton që një organ i vlerësimit të konformitetit nuk është më kompetent për të kryer një veprimtari të veçantë të vlerësimit të konformitetit ose kur ai ka kryer një shkelje serioze të detyrimeve të tij, ajo merr masat e duhura brenda një kohe të arsyeshme për të reduktuar, pezulluar ose tërhequr certifikatën e tij. Procedurat e reduktimit, pezullimit ose tërheqjes së akreditimit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe bëhen publike.
11. Procedurat për trajtimin e apeliemeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe bëhen publike.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe që në këtë rast janë raportet e provave ose raportet e testimit të lëshuara nga laboratorë të autorizuar sipas përcaktimeve të standartit shtetëror SSH 1411:1987 ose ekuivalentin e tij, si dhe përcaktimeve të nenit 5, të ligjit nr. 116/2014, "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë" dhe meqënëse kjo kërkesë lidhet me aktivitetin e prodhimit dhe

tregtimit të produkteve ushqimore atëherë njësia e prokurimit vendosi që ky raport prove ose raport testimi të jetë I lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të tenderit, duke gjykuar që të mos rriten kostot e pjesmarrjes së operatorëve ekonomik të mundshëm për këtë procedurë prokurimi.

SHËNIM:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 4 dhe 5 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit), sa shuma e këtyre kriterëve për secilin lot për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Argumentim:

Në nenin 42, të VKM NR. 845, DATË 19.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*
- 3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.*
- 4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.*
- 5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.*
- 6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.*
- 7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e*

kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme është parë e arsyeshme që në rast se operatorët ekonomik ofertues ofertojnë për më shumë se 1 (një) lot atëherë kapacitetet ekonomike dhe financiale lidhur me xhiron vjetore dhe kapacitetet teknike lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, numrin e punonjësve dhe numrin e mjeteve të transportit duhet ti përmbushin në mënyrë kumulative, dmth sa shuma e loteve në të cilat paraqet ofertë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI II " "BLERJE USHQIME KOLONIALE PËR KONVIKTET E SHKOLLAVE TË MESME"

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës te paraqesë licencen leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkatëgoria: II.1.A.1. "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", në emër të vetë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve objekt prokurimi për Lotin II "të sipërpërmendura duhet të jenë të rregjistruar në një nga regjistrat profesionalë për zbatimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu në nenin 19 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar përcaktohet se:

"Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjinë jo shtazore) sipas objektit të prokurimit, janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin I që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet OKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

- a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;
- b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;
- c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;
- ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;
- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e OKL-së;
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet OKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që OKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi I

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.

b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.

c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë.”.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë prodhime ushqimore dhe meqënëse objekti i prokurimit për këtë lot është ushqime koloniale, të cilat janë produkte me origjinë joshtazore dhe është ushqim për njerëzit, duhet që të jenë të pajisur me licensën e nënkategorisë II.1.A.1.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/a të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin konkret meqënëse edhe ligji nr.9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar nuk lejon që të ushtrohet aktiviteti i prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të artikujve objekt prokurimi për këtë lot pa licensë profesionale atëherë u konkludua me hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

Gjithashtu njësia e prokurimit duke patur parasysh parashikimet e nenit 14 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” ku parashikohet që operatorët ekonomikë mund të ofertojnë në formën e bashkimit të shoqërive ju referua përcaktimeve të nenit 88, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

Neni 88
Bashkimi i operatorëve ekonomikë

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, ku është parashikuar se në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike kërkesat profesionale për kualifikim plotësohen nga secili prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive në raport me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në furnizim, njësia e prokurimit gjykon se meqënëse kriteri i mësipërm është një kriter kualifikimi lidhur me aftësinë profesionale, përcaktoi se në rastin kur ofertuesit paraqesin ofertë në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë atëherë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të jetë i pajisur me Licensën e nënkategorisë II.1.A.1. "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz".

Përcaktimin se: " Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor", është mbështetur në përcaktimet e pikës III "Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim" të Rekomandimit të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr. 10181 prot, datë 19.11.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", ku përcaktohet se: "Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licensën kategoria II.1.A – "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" në emër të tij, pasi licensa duhet ti përkasë operatorit ekonomik të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor. Theksojmë se gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor do të mbajë në konsideratë faktin se nuk lejohet përdorimi i licensës të një operatori tjetër ekonomik."

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratës së xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2021, 2022, 2023) të lëshuar nga organet tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo më pak se 448,245 (katërqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e dyzetë e pesë) leke.

Sqarim:

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale prej jo më pak se 448,245 (katërqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e dyzetë e pesë) leke, në të paktën një vit të periudhës financiare të cituar më sipër 2021, 2022, 2023.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar–Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare", nenit 42, pika 3 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 291, datë 15.5.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik" Kreu II "Kufijtë monetarë në sektorin klasik" pika 2/b Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik (mall) është nën Kufirin e ulët monetar në sektorin klasik (mall)

u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 39% e vlerës së fondit limit të lotit II dhe konkretisht 443 841 (katërqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dyzet e nje)leke.
ku përcaktohet se:

” Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit ju referua përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese dekalohet në organe ttatimire brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në shtator të vitit 2024 dhe tatimpaduesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të dekalrojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e nenit 42 të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se në rastin e procedurave të prokurimit të ndara në lote, si vlerë për hartimin e kriterit ekonomik të xhiros për seilin lot do të merret për bazë vlera e lotit dhe meqënëse vlera e

lotit 2 referuar nenit 11 VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 39% e vlerës së fondit limit të lotit 2 dhe konkretisht 448 245 (katërqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e dyzet e pesë) leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, ku vlera pa TVSH e një ose disa kontratave të jetë **jo më pak se 218 375 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë)** leke. Këto përvoja të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga entet publike për përbushjen me sukses të një ose disa kontratave, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe në rastet kur në këto vërtetime nuk identifikohen sasi të dhe vlera e mallrave të furnizuara, atëherë operatori ekonomik duhet të dorëzojë edhe faturën ose faturat tatimore të shitjes për këto kontrata, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara sipas kontratës për të cilën paraqesin vërtetim.
- b. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka përvojën e mëparshme për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar durnizime të ngjashme në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, nenit 42, pika 3 ”Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.;

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”.

Lidhur me vitet për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar furnizimi/et e ngjashme të mëparshme, nisur nga interpretimi i dispozitës së mësipërme njësia e prokurimit ka

përcaktuar si periudhë kohore 3 (tre) vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit s kurse përcaktohet në nenin 40 pika 4, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Lidhur me përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik njësia e prokurimit mbështetur në përcaktimet e mësipërme ligjore ka përcaktuar që në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me sektorin publik, përvec vërtetimeve të lëshuara nga entet publike të dorëzohen edhe faturat tatimor të shitjes që u përkasin këtyre vërtetimeve, pasi në disa raste komisioni i vleresimit të ofertave vihet në vështirësi sepse ofertuesit paraqesin vetëm vërtetim realizimi kontrate dhe është e pamundur që të identifikohen sasishtë, lloji dhe vlera e artikujve të furnizuara, si dhe data e realizimit të furnizimit.

Lidhur me vlerën e furnizimeve të mëparshme të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e pikës 3, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet: “*Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit*”, pikes 9, të po këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërës lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës*”, si dhe të pikës 4, të nenit 55, të këtij vendimi, ku përcaktohet: “*Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*” dhe konkretisht për lotin 2 jo më pak se **218 375 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) leke**. Pra është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera një ambient të përshtatshëm magazinimin dhe tregëtimin e mallrave objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesi dokumentacionin si më poshtë:

- a) Në rastin kur ambjentin e përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave e ka në pronësi duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
 - *Certifikatën e pronësisë*
 - *Leje Higjeno-Sanitare*
- b) Në rastin kur ambjentin e përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave e ka me qera duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
 - Kontratën e qerasë ose huapërdorjes për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës
 - Certifikatën e pronësisë të qeradhënësit
 - *Leje Higjeno-Sanitare*

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

*Në rastin kur ambjenti i përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave është në **pronësi të operatorit ekonomik ofertues**, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” numrin e Certifikatës së pronësisë së ambientit ku ushtrohet aktiviteti, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar (Leje Higjeno-Sanitare) për këtë stabiliment, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.*

Në rastin kur ambjenti i përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave është me qera nga ana e operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” numrin e repertorit dhe datën e lidhjes së kontratës së qerasë, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktivitetin qeramarrësi dhe të marrë me qera, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar (Leje Higjeno-Sanitare) për këtë stabiliment të marrë me qera, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë një stabiliment të përshtatshëm për realizimin e objektit të prokurimit lidhur me prodhimin, tregëtimin dhe shpërndarjen e ushqimeve për njerëz dhe konkretisht të mallrave objekt prokurimi të këtij loti, prandaj u vendos që të hartohet dhe përcaktohet kjo kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” dhe objekti i prokurimit është blerja e produkteve ushqimore koloniale për njerëz ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 19 ” *Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi*”, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar përcaktohet se::

”1. Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është pëcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e ruajtjes përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjine jo shtazore) sipas objektit të prokurimit dhe në rastin konkret të ofertimit për artikuj ushqimorë kolonial janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës dhe ku deklarojnë se stabilimenti në të cilin ushtrojnë veprimtarinë të jetë i rregjistruar dhe i licensuar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet OKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;

c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;

- c) Afatet e vlefshmërisë së licencave;
- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi I

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.

b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.

c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë.”.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë prodhime ushqimore dhe meqënëse objekti i prokurimit për këtë lot janë ushqime koloniale, të cilat janë produkte me origjinë joshtazore dhe është ushqim për njerëzit, duhet që të jenë të pajisur me licensën e kategorisë II.1.A.1.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/ç ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/d “Hartimi i kriterëve të veçanta ëpe kualifikim” është rekomanduar që:

“d. Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose në përdorim ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara, për te gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet e kërkuara duhet të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe tekniko-teknologjike.”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe pajisjet përfshihet dhe ambienti i përshtatshëm për ruajtjen, shërndarjen dhe tregtimin e artikujve ushqimorë për njëri dhe në rastin konkret meqënëse objekt prokurimi është furnizimi me artikuj ushqimorë kolonial dhe në këtë rast operatorët ekonomikë janë tregtues të këtyre artikujve duhet të disponojnë ambientin e përshtatshëm për ruajtjen, shpërndarjen dhe tregtimin e këtyre artikujve kjo e lidhur edhe me përcaktimin e pikës III/d të Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Meqënësë parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit "mallra" duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të furrës ose linjës së prodhimit të bukës, por pa përcaktuar se si disponohen këto ambiente, ju referuam nenit 801 e vijues, nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 142

Sendet janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Neni 801

Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Neni 901

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 902

Kontrata e huapërdorjes quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

Pra në rastin konkret meqënëse nga shqyrtimi i "KARTELËS INFORMATIVE" me kodin AL022016 të publikuar në faqen e ADISA konstatohet se pjesë përbërëse e dokumentacionit për pajisjen me licensën e kategorisë II.1.A.1 "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" duhet që të dorëzojë dhe planimetrinë e ambientit ku ushtron aktivitetin dhe në rastin konkret bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme dhe konkretisht ndërtesë, pasuri e paluajtshme.

Në Udhëzim e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar" pika 3 përcaktohet se:

"3. Të gjithë objektet, në të cilët, Inspektorati Sanitar Shtetëror, pasi bën e ekspertimin paraprak, jep Aktmiratim higjieno-sanitare, merr masa në mbrojtje të shëndeti publik, apo ushtron kontroll për gjendjen shëndetësore të punëmarrësve, si:

c) vënie në shfrytëzim të objekteve:

- të prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve të ndryshme (që përcakton ligji nr. 7643, datë 02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjera që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror) dhe në të gjitha kategorite e pubimeve, përfshirë dhe ato minerare;

4) Fushat e inspektimit

Për mbrojtjen e shëndetit publik dhe promovimin e shëndetit, Inspektorati Sanitar Shtetëror monitoron dhe kontrollon:

ç) Zbatimin e rregullave higjeno-sanitare në objektet ku prodhohen, ruhen, tregtohen, transportohen, përdoren, apo konsumohen produkte të ndryshëm (që lejon ligji nr.7643, dt.02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjerë që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror, ligji nr.9108, dt.17.07.2003 “Për sufistancat dhe preparatet kimike”, i ndryshuar, ligji nr.10216, datë '21.01.2010 “Për detergjentet”, etj), kontrollon respektimin e normave higjenike të standardeve shtetërore dhe kushteve teknike të këtyre produkteve dhe artikujve të tjerë;”.

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme të Kodit Civil format e me të cilat mund ti vihet në dispozicion stabilimenti i përshtatshëm për ruajtjen, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve objekt prokurim është pronësia, qiramarrja, huapërdorja, pra në këtë rast operatorët ekonomikë që disponojnë një nga format e mësipërme të disponimit duhet të paraqesin dhe dokumentacionin vërtetues që në rastin e pronësisë është vërtetimi nga rregjistri përkatës, të cilin e ka detyrim ligjor dhe që është Certifikata e Pronësisë së stabilimentit, ndërsa në rastin e qeramarrjes ose huapërdorjes është kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës që prokurohet ose kontrata përkatëse e huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e zbtimit të kontratës që prokurohet, por me kushtin që licenca me kodin II.1.A.1 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të jetë në emër të pronarit në rastin kur është pronar i stabilimentit, ndërsa në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, si dhe aktin e miratimit higjeno-sanitar në emër pronarit në rastin kur është pronar i stabilimentit dhe në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon stabilimentin me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, me qëllim që të sigurojë autoritetin kontraktor që disponon dhe ushtron aktivitetin në përputhje me parashikimet e nenit 19 “Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi”, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 “Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar”.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Në nenin 79, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit."

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e Thjeshtuar–Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Për më tepër në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit *“Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”*, Pika.III/c *“Hartimi i kritereve të veçanta ëpe kualifikim”* është rekomanduar që: *“c. Operatori ekonomik të jete i pajisur me Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.”.*

Nisur nga sa parashtruar më sipër kjo kërkesë është e parashikuar në nenin 77 dhe pika 1 të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të cilin parashikohet se parashikimet për kërkesat e cilësisë i referohen dhe kualifikimeve të ofertuesit. Në rastin konkret nisur nga fakti që procedura e prokurimit është e llojit mallra ju referuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nga ku konstatoam se në pikën 8 të kësaj dispozite është parashikuar që autoritetet kontraktore në rastin e kësaj procedure prokurimi mund të përcaktojë dhe kritere të tjera për kualifikim dhe që në rastin konkret referuar Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik përcaktoi që ofruesit të disponojnë certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018 ose ekuivalente pasi kjo certifikate siguron autoritetin kontraktor se ofertuesit i respekton sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, pra kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është përcaktuar që kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organizëm i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, ku në rastin konkret organizëm kombëtar i akreditimit referuar përcaktimeve të ligjit nr.116, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” është Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Për më tepër nisur nga përcaktimet e mësipërme u përcaktua që në rastin kur ofertuesit paraqesin oferte në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë u vlerësua si e nevojshme që në këtë rast secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018, pasi kjo është një kërkesë që e parashikon legjislacioni në rastin e kualifikimeve që i referohet kualifikimeve të ofertuesit, si dhe është e lidhur ngushtë dhe në proporcion me objektin e prokurimit, pasi ka lidhje me sigurinë ushqimore, pasi edhe njëri nga anëtarët e bashkimit të shoqërive që merr përsimër të furnizojë me me disa nga ushqimet objekt ushqimor duhet të jetë dhe vetë i certifikuar me ISO 22000:2018.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti ATP të përshtatshëm për transportin e ushqimeve koloniale.

- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës është pronar i mjetit duhet të paraqesë dokumentacioni si në vijim: leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik dhe leje higjeno-sanitare të mjetit.
- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës ka marrë me qera mjetin duhet të paraqesë dokumentacioni si në vijim: kontratën noteriale të qerasë, leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik, leje higjeno-sanitare të mjetit.

(dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi)

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Në rastin kur mjete i transportit është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjete i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisë së siguracionit të mjetit të transportit, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisë së saj në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e certifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Në rastin kur mjete i transportit është marrë me qera nga operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit; numrin e repertorit të kontratës së qerasë dhe datën hartimit të kësaj kontrate, targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjete i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisë së siguracionit të mjetit të transportit në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisë së saj, numrin e certifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqenësë autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohej se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë burimin e nevojshëm teknik dhe konkretisht një automjet të përshtatshëm frigoriferik për realizimin e kontratës nisur nga lloji i ushqimeve të cilat janë delikate ndaj temperaturave të larta dhe kontaminuesve që ndodhen në ajër, si dhe duke patur parasysh natyrën e furnizimit e cila bëhet në mëngjes dhe ku furnizohen 5 konvikte nga të cilat 4 ndodhen brenda unazës së vogël të qytetit të Tiranës dhe 1 konvikt ndodhet në Kamëz vlerësuam që 1 automjet për shpërndarjen e bukës është mëse i mjaftueshëm.

Meqenësë procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/ç "Kontrata e mallrave" të

VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

" mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit".

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", Pika.III/e "Hartimi i kriterëve të veçanta ëpe kualifikim" është rekomanduar që: "e. Operatori të ketë në pronësi ose në përdorim automjetet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportin e mallrave, automjetet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportin e mallrave në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe që plotësojnë kushtet higjieno sanitare."

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t'u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe pajisjet përfshihet dhe automjeti i nevojshëm për kryerjen e furnizimit i cili referuar edhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit duhet të jetë i llojit ATP (jo frigoriferik).

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit "mallra" duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e bukës, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 81

Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:

- a) dhënien me qira pa drejtues mjete;
- b) dhënien me qira me drejtues mjete dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
- c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
- d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të tretëve;
- e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
- f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.

Neni 83

Dhënia me qira pa drejtues mjete

1. Për zbatimin e këtij neni, një mjet quhet i caktuar për dhënie me qira pa drejtues mjete kur qiradhënësi, kundrejt pagesës, detyrohet të verë në dispozicion të qiramarrësit, me kërkesën e këtij të fundit, vetë mjetin.
2. Mund të caktohen për dhënie me qira të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, përfshirë edhe mjetet e caktuara për transportin e mallrave, me ngarkesë të plotë, e cila është mbi 1,5 ton, si dhe mjetet, të ndryshme nga autoveturat, të caktuara për transportin e njerëzve.

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete me motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:
 - a) lejeqarkullimin;
 - b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
 - c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
 - ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
 - d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Referuar dispozitave të mësipërme përcaktuam se mjetet mund të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues ose me kontratë qeraje, ku në rastin e pronësisë mbi mjetin të paraqitet, leja e qarkullimit të mjetit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, ndërsa në rastet kur automjeti është me qera të paraqitet kontrata e qerave dhe dokumentacioni i mjetit në emër të qeradhënësit si ne vijim: leja e qarkullimit të mjetit në emër të qeradhënësit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit.

Nisur nga fakti që automjeti i përcaktuar në këtë kriter do të bëjë transport mallrash dhe në rastin konkret të artikullit “bukë” dhe meqënëse ka rregullim të vecantë ligjor lidhur me transportin e mallrave dhe për të shmangur ndonjë situatë të bllokimit të mjetit nga ana e policisë për shkak të mungesës së dokumentacionit, cka do të illte dhe vonesa në furnizimin me artikullin e sipërpërmendur objekt prokurimi ju referuam nenit 46 të ligjit nr, 8380, datë 18.3.1998 :Për transportet rrugore” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 1

a) Ky ligj do të zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

b) Ky ligj do të zbatohet, gjithashtu, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të mallrave për të tretë, me qira ose për nevojat e veta brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

c) Transporti rrugor i mallrave për të tretë dhe me qira ose për nevojat e veta përshin ngarkimin, shkarkimin dhe lëvizjen bosh dhe plot të mjetit.

KREU III.1

TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PËR TË TRETË

Neni 41

Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

KREU III.2

TRANSPORTI I MALLRAVE PËR VETE

Neni 45

Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë.

Neni 46

(ndryshuar ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.

Neni 47

Llojet e mallrave për transport brenda vendit për nevojat e veta që nuk kanë nevojë për certifikatë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë dhe certifikaten ose lejen e transporti të vlefshme në momentin e ofertës, por për automjetet me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton nuk kërkohet që të paraqitet certifikata ose leja e transportit, pasi mjetet me këtë kapacitet mbajtës nuk pajisen me leje apo certifikatë transporti.

Nisur nga natyra e mallrave që do të transportohen të cilat janë produkte ushqimore lidhur ju referuam Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar" përcaktohet se:

"Mjetet e transportit

Në se subjekti disponon dhe përdor mjete për transportin e produkteve të ndryshme, përdorimi i të cilëve ka, apo mund të ketë ndikime në shëndetin publik, mjetet e transportit duhet të përmbushin kërkesat higjeno-sanitare dhe sipas destinacionit të tyre,

- të jenë të ndërtuara me materiale veshëse të tillë që të mos ndikojnë (dhe ndikohen) negativisht ndaj produkteve që transportohen dhe ndaj pastrimit/larjes;

- të jenë të mbyllur/mbuluar, përfshi edhe hemicitetin e derës/dyerve, për të siguruar mbrojtjen e produkteve që transportohen nga plihurat, rrezet e diellit, shiu dhe nga agjentët atmosferikë dhe mjedisorë në përgjithësi;

- të kenë paisje ftohëse (autofrigorifer) për produktet që kërkojnë domosdoshmërisht transport në temperatura të caktuara;

- të kenë paisje të duhura (barëse, mbërthyes, arka, etj) për vendosjen dhe mbajtjen e produkteve që transportohen;

Mjetet e transportit duhet të përdoren për destinacione të caktuara, duke mos kryer shërbime dhe mostransportuar njëkohësisht produkte me veçori të ndryshme (njerëz dhe mallra në përgjithësi, produkte joushqimore dhe ushqimore, produkte të ambalazuara dhe të paambalazuara, etj).

Autobotët për transport lëngjesh, të jenë të ndërtuar/veshur me materiale të tillë që për karakteristikat e lëngjeve që mbarten, të mos ndikojnë në përbërjen e tyre.

Pas përfundimit të ransporteve dhe pas punës në përgjithësi, mjetet e transportit pastrohen, dhe sipas destinacionit të tyre, mekanikisht (me fshesë, furca, mjete fërkuese, etj) apo me tretësira pastruese (si psh tretësirë sode 0.5 – 1 -2 %, ujë i nxehtë 60-70 °C, me avull uji, etj) thjesht apo me presion, pasuar me shpëlarje përfundimtare me ujë të pastër.

Mjetet e transportit sa më sipër pajisen me Aktmiratim Higjeno-Sanitar."

Pra nisur nga parashikimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë Aktin e Miratimit-Higjeno-Sanitar të vlefshëm të automjetit.

2.3.5. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të disponojë në stafin e tij 1 (një) punonjës, si me poshtë:

- 1 (një) shofer
- 1 (një) punwtor

- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune e vlefshme, leja drejtimi të automjetit me kategorinë përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetin në emër të punonjësit.
- Për punonjësit e punësuar punëtore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune e vlefshme

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Për të dëshmuar se disponon në stafin e tij 1 (një) shofer operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” datën e kontratës së punës, ermin e punëmarrësit dhe numrin e lejes së drejtimit të automjetit të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Sqarim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës që prokurohet me anë të së cilës dëshmon se ka në stafin e tij 1 (një) punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetit që do deklarojë se disponon me qëllim që të dëshmojë se mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikuljve ushqimore , brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat

profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret duhet të kenë dhe punonjës të punësuar për realizimin e kontratës.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/c "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose".

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Lidhur me numrin e punonjësve që duhet të disponojnë operatori ekonomik, meqënëse kjo dispozitë nuk përcaktonte numrin e punonjësve, por thjesht faktin që duhet kërkuar fuqi punonjëse në raport me objektin e kontratës që prokurohet, njësia e prokurimit nisur nga objekti i kontratës e cila ka si qëllim furnizimin me ushqimeve të 5 konvikteve në administrim të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, gjykohej se është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar 2 (dy) punonjës nga të cilët 1 (një) punonjës duhet të kryejë punën e shoferit me qëllim që të bëjë transportin me mjet të ushqimeve nga vendi ku magazinohen në adresat e pesë konvikteve, si dhe 1 (nje) punonjës për ngarkimin dhe shkarkimin e mallit objekt prokurimi, te domosdoshem për kryerjen e ngarkimit dhe shkarkimit të mallit.

Lidhur me dokumentacion vërtetues përsa i përket disponimit të dy personave të punësuar, njësia e prokurimit, ju referuar parashikimeve ligjore si më poshtë:

Së pari, në Kreut V, neni 11, pika 1/e, neni 12 dhe neni 21, pika 1, të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar ku përcaktohet si më poshtë:

KREU IV

Neni 11

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
- c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore
- d) Kontrata kolektive e punës
- e) Kontrata individuale e punës
- f) Rregullorja e brendshme
- g) Zakonet lokale dhe profesionale.

Neni 12

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.

Neni 21

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

Së dyti, në nenin 14, të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë:

Neni 14

Operatorët ekonomikë

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Së treti, në nenin 115 dhe nenin 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë:

Neni 178
Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjeteme motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:
 - a) lejeqarkullimin;
 - b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
 - c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
 - ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
 - d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Neni 115
Kategoritë e lejedrejtimit për drejtimin e motomjeteve dhe automjeteve

1. Ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod.2. Përgatitja e kandidatit për lejedrejtimi bëhet në autoshkolla dhe provimet e ftësisë për ejedrejtimi duhet të bëhen pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pasi të plotësohen kushtet e caktuara fizike e mendore. Ministria përgjegjëse për transportin përcakton procedurën për lëshimin, përditësimin dhe dhënien e dublikatës, përmes një sistemi informatik, të lejedrejtimit, si dhe certifikatave të kualifikimeve profesionale, duke pasur si qëllim thjeshtimin e procedurave administrative. Kandidati për drejtues mjeti mund të regjistrohet dhe të kryejë kursin e teorisë e të praktikës në çdo drejtori rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pavarësisht nga regjistrimi në gjendjen civile.
3. Lejedrejtimi, sipas modelit të Bashkimit Europian, siç përcaktohet me vendim të Këshillit Ministrave, ndahet sipas kategorive dhe aftësive në drejtimin e mjeteve, të përcaktuara për secilën nga kategoritë e mëposhtme:

Kategoria AM:

- a) ciklomotorë me dy rrota, kategoria L1, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo me shumë se 45 km/h, fuqia cilindrike e të cilit është më e vogël apo e barabartë me 50 cm³, nëse është me djegie të brendshme, apo fuqia maksimale e vazhdueshme është më e vogël apo e barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;
- b) mjete me ose pa kosh dhe mjete me tri rrota, kategoria L2, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h dhe me motor me fuqi cilindrike më të ulët apo të barabartë me 50 cm³, nëse ky është me ndezje të komanduar, apo kur fuqia e tij maksimale neto është më e ulët ose e barabartë me 4 kË, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose për ata që fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;
- c) mjete me katër rrota të lehta, kategoria L6, masa bosh e të cilave është më e ulët ose e barabartë me 350 kg, duke përjashtuar masën e baterive për automjetet elektrike me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h, me fuqi cilindrike të motorit më të ulët ose të barabartë me 50 cm³, për motorët me ndezje të komanduar, ose ata të cilët fuqinë maksimale neto e kanë më të ulët apo të barabartë me 4 kË, për motorët e tjerë me djegie të brendshme; ose ata të cilët fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

Kategoria A1:

a) motomjet me cilindratë jo më shumë 125 centimetër kub dhe me fuqi jo më shumë se 11 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,1 kË/kg;

b) tricikël me një fuqi jo më të madhe se 15 kË;

Kategoria A2: motomjet me fuqi jo më shumë se 35 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,2 kË/kg, që nuk rrjedh nga një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij;

Kategoria A: motomjet me fuqi më shumë se 15 kË;

Kategoria B1: motomjet me katër rrota, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të kategorisë AM, masa pa ngarkesë e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 400 kg ose 550 kg për mjetet e destinuara për transport mallrash (kategoria L7), përjashtuar masën e baterive për automjetet elektrike, të cilat fuqinë maksimale neto të motorit e kanë më të ulët ose të barabartë me 15 kË. Këto mjete konsiderohen si mjete me tri rrota dhe janë në përputhje me rregullat e aplikueshme për mjetet e kategorisë L5;

Kategoria B: mjet motorik me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3 500 kg dhe jo më shumë se 8 ndenjëse, përjashtuar ndenjësen e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg, duke u siguruar që masa maksimale e autorizuar e këtij kombinimi të mos kalojë 4 250 kg. Në rast se kombinimi i kalon 3 500 kg, drejtuesi duhet t’i nënshtrohet një trajnimit dhe provimit të posaçëm;

Kategoria BE: kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios nuk i kalon 3 500 kg;

Kategoria C1: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg, por jo më shumë se 7 500 kg ose i projektuar dhe i konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t’u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria C1E: kombinimi i një mjeti motorik të kategorisë C1 dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg, por masa maksimale e autorizuar e kompleksit të formuar nuk i kalon 12 000 kg;

Kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje apo gjysmërimorkioje, masa e autorizuar e të cilave i kalon 3 500 kg, me kusht që, në masë, kombinimi i autorizuar të mos i kalojë 12 000 kg;

Kategoria C: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg ose i projektuar dhe konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t’u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria CE: kombinimi i një mjeti të kategorisë C me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg;

Kategoria D1: mjet motorik i projektuar dhe konstruktuar për jo më shumë se 16 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit, dhe me gjatësi maksimale që nuk i kalon 8 m. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D1E: kombinim i një mjeti të kategorisë D1 me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750kg;

Kategoria D: mjet motorik i projektuar dhe i konstruktuar për më shumë se 8 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D

E: kombinimi i një mjeti të kategorisë D me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme ligjore njësia e prokurimit vendosi që dokumentacioni vërtetues lidhur me punësimin e dy punonjësve në stafin e operatorëve ekonomik ofertues vendosi që të përcaktojë kontratën e punës sipas formës së parashikuar në pikën 1, të nenit 21 të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurim e cila është përcaktuar si një vit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit,

Ndërsa lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzojë operatori ekonomik ofertues për të vërtetuar se ka të punësuar një punonjës që kryen detyrën e shoferit, i cili duhet të jetë i pajisur me lejedrejtimi mjeti ju referuam nenit 115 dhe nenit 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. ku meqënëse nuk kemi parashikuar kapacitetin mbajtës të mjetit të përshtatshëm për transportin e mallrave objekt prokurimi, por e kemi lënë në mundësinë që ka për disponimin e një mjeti të tillë me kapacitet mbajtës të caktuar vetë operatori ekonomik ofertues, atëherë kemi përcaktuar se shoferi duhet të paraqesë lejen e drejtimit të këtij mjeti, ku kjo lejedrejtimi duhet të jetë sipas kategorisë që i përket mjeti që disponon sipas kriterit të përcaktuar në Pikën 2.3.4 të “Kapacitetit teknik” të Shtojcës 7 të dokuemntave të tenderit.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

ARGUMENTIMI: Nisur nga fakti që respektimi i kërkesave të sigurisë ushqimore për furnizimin me ushqime për konviktet ku jetojnë fëmijë është shumë i rëndësishëm, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 dhe Nr.8541, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/g është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë në fazën e ofertimit këtë deklaratë dhe në rast se shpallet fitues të paraqesë përpara lidhjes së kontratës vërtetimin e lëshuar nga AKU-ja.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur nje deklaratë.

SHËNIM:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 4 dhe 5 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit), sa shuma e këtyre kriterëve për secilin lot për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Argumentim:

Në nenin 42, të VKM NR. 845, DATË 19.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.
3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.
4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.
5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.
6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme është parë e arsyeshme që në rast se operatorët ekonomik ofertues ofertojnë për më shumë se 1 (një) lot atëherë kapacitetet ekonomike dhe financiale lidhur me xhiron vjetore dhe kapacitetet teknike lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, numrin e punonjësve dhe numrin e mjeteve të transportit duhet ti përmbushin në mënyrë kumulative, dmth sa shuma e loteve në të cilat paraqet ofertë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI III " "BLERJE USHQIME BLEGTORIALE PËR KONVIKTET E SHKOLLAVE TË MESME"

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, datw 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës te paraqesë licencen leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.B. “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz).

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkatëgoria: II.1.B. “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, në emër të vetë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve objekt prokurimi pwr Lotin III ”të sipërpërmendura duhet të jenë të rregjistruar në një nga regjistrat profesionalë për zbatimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu në nenin 19 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar përcaktohet se:

”Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit

ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është pëcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjinë jo shtazore) sipas objektit të prokurimit, janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në regjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet

Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet QKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

- a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;*
- b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;*
- c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;*
- ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;*
- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;*
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;*
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;*
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;*
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;*
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.*

Aneksi 1

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

- a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;*
- b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;*
- c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.*

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.B

11. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.B jepen për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes.

12. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategorinë II.1.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë.”.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë prodhime ushqimore dhe meqënëse objekti i prokurimit për këtë lot është artikulli Blegtorial, i cili është një produkt me origjinë shtazore dhe është ushqim për njerëzit, duhet që të jenë të pajisur me licensën e nënkategorisë II.1.B.1.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/a të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin konkret meqënëse edhe ligji nr.9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar nuk lejon që të ushtrohet aktiviteti i prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të artikujve objekt prokurimi i këtij loti pa licensë profesionale atëherë u konkludua me hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

Gjithashtu njësia e prokurimit duke patur parasysh parashikimet e nenit 14 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” ku parashikohet që operatorët ekonomikë mund të ofertojnë në formën e bashkimit të shoqërive ju referua përcaktimeve të nenit 88, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, ku është parashikuar se në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike kërkesat profesionale për kualifikim plotësohen nga secili prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive në raport me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në furnizim, njësia e prokurimit gjykon se meqënëse kriteri i mësipërm është një kriter kualifikimi lidhur me aftësinë profesionale, përcaktoi se në rastin kur ofertuesit paraqesin ofertë në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë atëherë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të jetë i pajisur me Licensën e nënkategorisë II.1.B.1. "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz".

Lidhur me përcaktimin se: "nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik", njësia e prokurimit është mbështetur në përcaktimet e pikës III "Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim" të Rekomandimit të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr. 10181 prot, datë 19.11.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", ku përcaktohet se: "Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licensën kategoria II.1.B – "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" në emër të tij, pasi licensa duhet ti përkasë operatorit ekonomik të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor. Theksojmë se gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor do të mbajë në konsideratë faktin se nuk lejohet përdorimi i licensës të një operatori tjetër ekonomik."

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratës së xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2021, 2022, 2023) të lëshuar nga organet tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo më pak se **1,634,260 (një milion e gjashtëqind e tridhjet e katërmijë e dyqind e gjashtedhjet) leke.**

Sqarim:

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale prej jo më pak se 1,634,260 (një milion e gjashtëqind e tridhjet e katërmijë e dyqind e gjashtedhjet) leke, në të paktën një vit të periudhës financiare të cituar më sipër 2021, 2022, 2023.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të ketë realizuar xhiro në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e thjeshtuar–Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 ”Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, nenit 42, pika 3 ”Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” dhe neni 11, pika 1 ”Kufijtë monetarë” (ndryshuar me VKM-në nr. 498, datë 1.8.2024) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”.

Bazuar ne VKM-në nr. 498, datë 1.8.2024 KREU II KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK përcaktohen

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit ju referua përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese dekalohet në organe ttatimire brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqenësë procedura e prokurimit do të zhvillohet në shtator të vitit 2024 dhe tatimpaduesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të dekalrojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e nenit 42 të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se në rastin e procedurave të prokurimit të ndara në lote, si vlerë për hartimin e kriterit ekonomik të xhiros për seilin lot do të merret për bazë vlera e lotit dhe meqënëse vlera e lotit 3 referuar nenit 11 VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 39% e vlerës së fondit limit të lotit 3 dhe në rastin konkret jo më pak se 1,634,260 (një milion e gjashtëqind e tridhjet e katërmijë e dyqind e gjashtedhjet) leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku vlera pa TVSH e një ose disa kontratave të jetë jo më pak se 796 178 (shtatëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke. Këto përvoja të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga entet publike për përmbushjen me sukses të një ose disa kontratave, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe në rastet kur në këto vërtetime nuk identifikohen sasi të dhe vlera e mallrave të furnizuara, atëherë operatori ekonomik duhet të dorëzojë edhe faturën ose faturat tatimore të shitjes për këto kontrata, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara sipas kontratës për të cilën paraqesin vërtetim.
- b. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka përvojën e mëparshme për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar durnizime të ngjashme në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, nenit 42, pika 3 ”Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.;

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”.

Lidhur me vitet për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar furnizimi/et e ngjashme të mëparshme, nisur nga interpretimi i dispozitës së mësipërme njësia e prokurimit ka përcaktuar si periudhë kohore 3 (tre) vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit s kurse përcaktohet në nenin 40 pika 4, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Lidhur me përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik njësia e prokurimit mbështetur në përcaktimet e mësipërme ligjore ka përcaktuar që në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me sektorin publik, përvec vërtetimeve të lëshuara nga entet publike të dorëzohen edhe faturat tatimor të shitjes që u përkasin këtyre vërtetimeve, pasi në disa raste komisioni i vleresimit të ofertave vihet në vështirësi sepse ofertuesit paraqesin vetëm vërtetim realizimi kontrate dhe është e pamundur që të identifikohen sasishtë, lloji dhe vlera e artikujve të furnizuara, si dhe data e realizimit të furnizimit.

Lidhur me vlerën e furnizimeve të mëparshme të përcaktuara, meqenëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e pikës 3, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet: “*Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit*”, pikes 9, të po këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës*”, si dhe të pikës 4, të nenit 55, të këtij vendimi, ku përcaktohet: “*Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*”. dhe konkretisht per lotin 3 jo më pak se 796 178 (shtatëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke Pra është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Në lidhje me stabilimentin që disponon operatori ekonomik pjesëmarrës:

-Në rast se disponon në pronësi fermë apo njësi prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij, gjithashtu dhe ata që disponojnë në pronësi njësi prodhimi qumështi dhe të nënprodukteve të tij, duhet të paraqitet:

-Çertifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti; Licencën e Nënkatëgorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë kompania prodhuese e mallrave mish dhe nënprodukteve, qumështit dhe nënprodukteve; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabilimentin ku ushtron aktivitetin prodhuesi i mallrave mish dhe nënprodukteve, qumështit dhe nënprodukteve, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga administratori i biznesit (ferma e prodhimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij, prodhuesit të qumështit dhe të

nënprodukteve të tij) për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë prodhuesi i mallrave të lotit.

-Në rastin kur njësia e prodhimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij, gjithashtu dhe njësia e prodhimit të qumështi dhe të nënprodukteve të tij, **është me qera** duhet të paraqitet:

-Kontrata e qerasë për stabilimentin ku ushtrohet aktiviteti, e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës së prokurimit; Certifikata e pronësisë në emër të qeradhënësit; Licencën e Nënkategorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) leshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë kompania prodhuese e mallrave mish dhe nënprodukteve, qumështit dhe nënprodukteve; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabilimentin ku ushtron aktivitetin prodhuesi i mallrave mish dhe nënprodukteve, qumështit dhe nënprodukteve, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga administratori i biznesit (ferma e prodhimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij, prodhuesit të qumështit dhe të nënprodukteve të tij) për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë prodhuesi i mallrave të lotit.

-Në rastin kur njësia e prodhimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij, gjithashtu dhe njësia e prodhimit të qumështi dhe të nënprodukteve të tij, **është me kontratë huapërdorje** duhet të paraqitet:

-Kontrata e huapërdorjes së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti, e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës së prokurimit; Certifikata e pronësisë në emër të huadhënësit; Licencën e Nënkategorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) leshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë kompania prodhuese e mallrave mish dhe nënprodukteve, qumështit dhe nënprodukteve; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabilimentin ku ushtron aktivitetin prodhuesi i mallrave mish dhe nënprodukteve, qumështit dhe nënprodukteve, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga administratori i biznesit (ferma e prodhimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij, prodhuesit të qumështit dhe të nënprodukteve të tij) për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë prodhuesi i mallrave të lotit.

-Në rastin kur Operatori ekonomik pjesëmarrës ka **marrëveshje bashkëpunimi** ose furnizimi të vlefshme për të gjithë kohën që kërkohet furnizimi me fermë prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij dhe prodhues qumështit dhe të nënprodukteve të tij apo marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi të vlefshme për të gjithë kohën që kërkohet furnizimi me kompani importuese dhe tregtuese mishi dhe të nënprodukteve të tij dhe kompani importuese dhe tregtuese të qumështit dhe të nënprodukteve të tij, shoqëruar me:

Në rastin kur **marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi është me kompani vendase** fermë prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij dhe prodhues qumështi dhe të nënprodukteve të tij, duhet të paraqitet:

Licencën e Nënkategorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) leshuar nga QKB për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë kompanitë vendase prodhues të mallrave mish dhe nënprodukteve, qumështi dhe nënprodukteve; Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabilimentin ku ushtron aktivitetin prodhuesi i mallrave mish dhe nënprodukteve, njësia e qumështit dhe nënprodukteve të tij, leshuar

nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga administratori i biznesit (ferma e prodhimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij, prodhuesit të qumështit dhe të nënprodukteve të tij) për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë prodhuesi i mallrave të lotit.

Në rastin kur **marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi është me kompani importuese dhe tregtuese** të mishit dhe të nënprodukteve të tij, të bulmetit dhe të nënprodukteve të tij, duhet të paraqitet:

Licencën e Nënkategorisë: II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)” lëshuar nga QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) për stabilimentin ushrohet veprimtaria e kompanive importuese dhe tregtuese, Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabilimentin ku ushtron aktivitetin e kompanite importuese dhe tregtuese lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj dhe Deklaratë nga administratori i biznesit (kompani importuese dhe tregtuese të mishit dhe të nënprodukteve të tij, të qumështit dhe të nënprodukteve të tij) për plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për stabilimentin ku ushtron veprimtarinë.

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi dhe me paraqitjen.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Në rastin kur ferma apo njësia prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij, si dhe njësia prodhimi qumështi dhe të nënprodukteve të tij është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushrohet aktiviteti, numrin e Licencën e Nënkategorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për këtë stabiliment ku ushrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, numrin dhe datën e Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment ku ushrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Në rastin kur ferma apo njësia prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij, si dhe njësia prodhimi qumështi dhe të nënprodukteve të tij është marrë me qera nga ana e operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” numrin e repertorit dhe datën e lidhjes së kontratës së qerasë, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushrohet aktiviteti dhe që është marrë me qera, numrin e Licencën e Nënkategorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) lëshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për këtë stabiliment ku

ushtrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, numrin dhe datën e Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Në rastin kur ferma apo njësia prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij, si dhe njësia prodhimi qumështi dhe të nënprodukteve të tij është marrë me kontratë huapërdorje nga ana e operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” numrin e repertorit dhe datën e lidhjes së kontratës së huapërdorjes, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti dhe që është marrë me qera, numrin e Licencën e Nënkategorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) leshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, numrin dhe datën e Akt Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues ka marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi është me kompani vendase që është fermë prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij, si dhe me një kompani vendase që është prodhues qumështi dhe të nënprodukteve të tij, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, datën e lidhjes së kontratës/ve së furnizimit ose të marrveshjes/ve të bashkëpunimit dhe emrin e kompanisë/ve me të cilën është lidhur marrveshja, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti dhe të cilin është marrëveshja e bashkëpunimit ose e furnizimit, numrin e Licencës/ve e Nënkategorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) leshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, numrin dhe datën e Akt/ve Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë prodhuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues ka marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi është me importuese dhe tregtuese të mishit dhe të nënprodukteve të tij, si dhe me një kompani importuese dhe tregtuese të qumështit dhe të nënprodukteve të tij, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, datën e lidhjes së kontratës/ve së furnizimit ose të marrveshjes/ve të bashkëpunimit dhe emrin e kompanisë/ve me të cilën është lidhur marrveshja, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktiviteti dhe të

cilin është marrëveshja e bashkëpunimit ose e furnizimit, numrin e Licencës/ve e Nënkatëgorisë: II.1.B Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) leshuar nga QKB-ja (Qendra Kombëtare e Biznesit) për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë importuese dhe tregtuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe kompanisë importuese dhe tregtuese të produktit qumështit dhe nënprodukteve të tij, numrin dhe datën e Akt/ve Miratimin Higjeno-sanitar për këtë stabiliment ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë importuese dhe tregtuese e produktit mish dhe nënprodukteve të tij, si dhe kompanisë importuese dhe tregtuese e produktit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë një stabiliment të përshatshëm për realizimin e objektit të prokurimit lidhur me prodhimin, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz dhe konkretisht të mallrave objekt

prokurimi të këtij loti, prandaj u vendos që të hartohet dhe përcaktohet kjo kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" dhe objekti i prokurimit është blerja e produkteve ushimore me origjinë shtazore për njerëz dhe konkretisht të artikujve mish, salcice, qumësht kos dhe vezë ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 19 " Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi", të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar përcaktohet se::

"1. Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinarë, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është pëcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjinë jo shtazore) sipas objektit të prokurimit janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës dhe ku deklarojnë se stabilimenti në të cilin ushtrojnë veprimtarinë të jetë i rregjistruar dhe i licensuar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomikë ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet QKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;

c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;

ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;

d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;

dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;

e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;

ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;

f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;

g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi I

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.B

11. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.B jepen për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes.

12. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategorinë II.1.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë.”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion ose t’u vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe paisjet përfshihet dhe ambienti i përshtatshëm për prodhimin, shpërndarjen dhe tregtimin e artikujve ushqimorë për njerëz dhe në rastin konkret furnizim me produkte mishi dhe nënproduktet e tij dhe produkte qumështi dhe nënproduktet e tij, prandaj duhet të disponojnë ambientin e përshtatshëm për prodhimin dhe tregtimin e këtyre artikujve, pra fermë apo njësi

prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësi prodhimi qumështi dhe nënproduktet e tij, kjo e lidhur edhe me përcaktimin e pikës III/d të Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specififikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit ”mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të furrës ose linjës së prodhimit të bukës, por pa përcaktuar se si disponohen këto ambiente, ju referuam nenit 801 e vijues, nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 ”Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 142

Sendet janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Neni 801

Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Neni 901

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshtëpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 902

Kontrata e huapërdorjes quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

Pra në rastin konkret meqënëse nga shqyrtimi i ”KARTELËS INFORMATIVE” me kodin AL022017 të publikuar në faqen e ADISA konstatohet se pjesë përbërëse e dokumentacionit për pajisjen me licensën e kategorisë II.1.A.1 ”Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” duhet që të dorëzohet dhe planimetrinë e ambientit ku ushtron aktivitetin dhe në rastin konkret bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme dhe konkretisht ndërtesë, pasuri e paluajtshme dhe dokumentin e pronësisë së ambientit.

Në Udhëzim e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar" pika 3 përcaktohet se:

"3. Të gjithë objektet, në të cilët, Inspektorati Sanitar Shtetëror, pasi bën e ekspertimin paraprak, jep Aktmiratim higjiëno-sanitare, merr masa në mbrojtje të shëndeti publik, apo ushtron kontroll për gjendjen shëndetësore të punëmarrësve, si:

c) vënie në shfrytëzim të objekteve:

- të prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve të ndryshme (që përcakton ligji nr. 7643, datë 02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjera që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror) dhe në të gjitha kategorite e pubimeve, përfshirë dhe ato minerare;

4) Fushat e inspektimit

Për mbrojtjen e shëndetit publik dhe promovimin e shëndetit, Inspektorati Sanitar Shtetëror monitoron dhe kontrollon:

ç) Zbatimin e rregullave higjiëno-sanitare në objektet ku prodhohen, ruhen, tregtohen, transportohen, përdoren, apo konsumohen produkte të ndryshëm (që lejon ligji nr.7643, dt.02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjera që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror, ligji nr.9108, dt.17.07.2003 "Për sufistancat dhe preparatet kimike", i ndryshuar, ligji nr.10216, datë '21.01.2010 "Për detergjentet", etj), kontrollon respektimin e normave higjenike të standardeve shtetërore dhe kushteve teknike të këtyre produkteve dhe artikujve të tjerë;"

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme të Kodit Civil njësi e prokurimit arsyeton se format e me të cilat mund ti vihet në dispozicion fermë apo njësi prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësi prodhimi qumështi dhe nënproduktet e tij është pronësia, qiramarrja, huapërdorja, pra në këtë rast operatorët ekonomikë që disponojnë një nga format e mësipërme të duhet të paraqesin dhe dokumentacionin vërtetues që në rastin e pronësisë është vërtetimi nga rregjistri përkatës, të cilin e ka detyrim ligjor dhe që është Certifikata e Pronësisë së ambientit, Licensën II.1.A.1 "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" në emrin e tij, Akt Miratimin Higjiëno-Sanitar, si dhe Deklaratën nga administratori i fermë apo njësi prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësi prodhimi qumështi dhe nënproduktet e tij që i përmbush standartet tekniko-teknologjike, ndërsa në rastin e qeramarrjes ose huapërdorjes është kontrata përkatëse e qërasë e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës që prokurohet ose kontrata përkatëse e huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës që prokurohet, por me kushtin që licensa me kodin II.1.A.1 "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" të jetë në emër të pronarit në rastin kur është pronar i ambientit, në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, Certifikatën e pronësisë së ambientit që është marrë me qera ose huapërdorje, aktin e miratimit higjiëno-sanitar në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, si dhe Deklaratën nga administratori i stabilimentit (qeradhënësi ose huamarrësi) që stabilimenti (fermë apo njësi prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësi prodhimi qumështi dhe nënproduktet e tij) i përmbush standartet tekniko-teknologjike me qëllim që të sihurojë autoritetin kontraktor që disponon dhe ushtron aktivitetin në përputhje me parashikimet e nenit 19 "Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi", të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për

ushqimin” i ndryshuar, VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 ”Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar”

Nisur nga përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik”, ku përcaktohen parimet themelore të legjislacionit në fushën e prokurimeve publik dhe që janë nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, për operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë mundësi që të disponojnë në një nga format e sipërpërmendura të fermë apo njësi prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësi prodhimi qumështi dhe nënproduktet e tij, si dhe nuk janë prodhues të mishit dhe nënprodukteve të tij, si dhe qumështit dhe nënprodukteve të tij, por janë tregtarë të licensuar për shpërndarjen dhe tregtimin e artikujve ushqimorë dhe që disponojnë thjesht një ambient për magazinimin dhe tregtimin artikujve ushqimore me origjinë shtazore për njerëz, ka përcaktuar në kriterin e mësipërm që mund të paraqesin dhe një marrëveshje furnizimi më fermë apo njësi prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësi prodhimi qumështi dhe nënproduktet e tij (pra me një shoqëri që mund të jetë person fizik ose juridik që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të mishit dhe nënprodukteve të tij, si dhe qumështit dhe nënprodukteve të tij) të vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës që prokurohet, por me kushtin që përveç licensës së tij të paraqesi dhe dokumentacionin që vërteton disponimin e fermës apo njësi prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësisë së prodhimit të qumështi dhe nënprodukteve të tij dhe konkretisht Çertifikatëne pronësisë të stabilimentit ku ushtron aktivitetin, të paraqesi dhe licensën me kodin II.1.A.1 “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” në emër të furnizuesit si dhe aktin e miratimit higjeno-sanitar në emër të furnizuesit, me qëllim që të vihet në kushte të barabarta më operatorët ekonomikë që janë disponojnë një fermë apo njësi prodhimi mishi dhe nënproduktet e tij, si dhe njësi prodhimi qumështi dhe nënproduktet e tij me një nga format e mësipërme të përcaktuara në Kodin Civil, si dhe për të siguruar autoritetin kontraktor që furnizuesi e ushtron aktiviteti në përputhje me parashikimet e nenit 19 ”Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi”, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar, VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 ”Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar”.

Në rastin e operatorit ekonomik ofertues i cili paraqet një kontratë furnizimi duhet që detyrimisht të paraqesë dhe dokumentacionin që vërteton disponimin e ambientit në të cilin do të magazinohet produktin ushqimor objekt prokurimi përpara se ta transportojë në adresat e autoritetit kontraktor dhe që në rastin e disponimit në formën e pronësisë të paraqesë Certifikatën e pronësisë, ndërsa në rastin e disponimit me format e qeramarrjes ose huapërdorjes të paraqesë kontratën e qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës ose kontratën e huapërdorjes për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, pasi kjo ka lidhje me sigurinë e zinxhirit ushqimor sepse në këtë rast kemi të

bëjmë me dy subjekte të ndryshme ku njëri prodhon produktin, ndërsa tjetri merr përsipër magazinimin dhe transportin e tij tek autoriteti kontraktor dhe i gjithë ky proces duhet të kryhet sipas përcaktimeve ligjore të sipërpërmendura.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Në rastet kur operatori ekonomik ofertes paraqet marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi me kompani vëndase si: "ferma prodhimi mishi dhe të nënprodukteve të tij dhe prodhues bulmeti dhe të nënprodukteve të tij", apo me kompani importuese dhe tregtuese si: "kompani importuese dhe tregtuese mishi dhe të nënprodukteve të tij dhe, kompani importuese dhe tregtuese bulmeti dhe të nënprodukteve të tij", atëherë duhet të dorëzojë edhe Certifikatën ISO 22000-2018 ose ekuivalentin në emër të të fermës së prodhimit të mishi dhe nënprodukteve të tij, të prodhuesit të bulmeti dhe nënprodukteve të tij dhe të kompanisë importuese dhe tregtuese të mishit dhe nënprodukteve të tij, të kompanisë importuese dhe tregtuese të bulmetit dhe të nënprodukteve të tij. Kjo certifikatë në emër të kompanive të cilësuara më sipër të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve

ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 79, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Për më tepër në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit ”Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/c ”Hartimi i kritereve të veçanta ëpe kualifikim” është rekomanduar që: ”c. Operatori ekonomik të jete i pajisur me Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.”.

Nisur nga sa parashtruam më sipër kjo kërkesë është e parashikuar në nenin 77 dhe pika 1 të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik”, në të cilin parashikohet se parashikimet për kërkesat e cilësisë i referohen dhe kualifikimeve të ofertuesit. Në rastin konkret nisur nga fakti që procedura e prokurimit është e llojit mallra ju referuam dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nga ku konstatoam se në pikën 8 të kësaj dispozite është parashikuar që autoritetet kontraktore në rastin e kësaj procedure prokurimi mund të përcaktojë dhe kritere të tjera për kualifikim dhe që në rastin konkret referuar Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik përcaktoi që ofruesit të disponojnë certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018 ose ekuivalente pasi kjo

certifikate siguron autoritetin kontraktor se ofertuesit i respekton sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, pra kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" është përcaktuar që kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organizëm i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, ku në rastin konkret organizëm kombëtar i akreditimit referuar përcaktimeve të ligjit nr.116, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë" është Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Për më tepër nisur nga përcaktimet e mësipërme u përcaktua që në rastin kur ofertuesit paraqesin oferte në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë u vlerësua si e nevojshme që në këtë rast secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018, pasi kjo është një kërkesë që e parashikon legjislacioni në rastin e kualifikimeve që i referohet kualifikimeve të ofertuesit, si dhe është e lidhur ngushtë dhe në proporcion me objektin e prokurimit, pasi ka lidhje me sigurinë ushqimore/

Në të njëjtën kohë u përcaktua që në rastin kur ofertuesit kanë kontratë osë marrveshje bashkëpunimi ose furnizimi me një prodhues apo importues atëherë ky ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 22000:2018 të prodhuesit apo importuesit të mishit dhe nënprodukteve të tij, si dhe qumështit dhe nënprodukteve të tij, duke u vlerësuar nga ana jonë si një kërkesë që e parashikon legjislacioni për prokurimin publik, si dhe si një kërkesë që është në proporcion me objektin e kontratës, pasi ka lidhje me sigurinë ushqimore dhe konkretisht me procesin e prodhimit apo importit të këtyre produkteve ushqimor.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti **ATV frigoriferik** të përshtatshëm për produktet objekt prokurimi të këtij loti.

- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës është pronar i mjetit duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjeti është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik dhe leje higjeno-sanitare të mjetit.
- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës ka marrë me qera mjetin duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim: kontratën noteriale të qerasë, leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjeti është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik, leje higjeno-sanitare të mjetit.

(dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi)

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 "FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT" pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" të plotësuar.

Në rastin kur mjeti i transportit është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: "Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit", pika: "B: DEKLARATË" të Shtojcës 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjeti i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisë së siguracionit të mjetit të transportit, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisë së saj në rast se mjeti është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e çertifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Në rastin kur mjeti i transportit është marrë me qera nga operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: "Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit", pika: "B: DEKLARATË" të Shtojcës 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit; numrin e repertorit të kontratës së qerasë dhe datën hartimit të kësaj kontrate, targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjeti i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisë së siguracionit të mjetit të transportit në rast se mjeti është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisë së saj, numrin e çertifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë burimin e nevojshëm teknik dhe konkretisht një automjet të përshtatshëm për realizimin e kontratës, pasi nga ana jonë duke patur parasysh se natyrën e furnizimit e cila bëhet cdo mëngjes dhe ku furnizohen 5 konvikte nga të cilat 4 ndodhen brenda unazës së vogël të qytetit të Tiranës dhe 1 konvikt ndodhet në Kamëz vlerësoam që 1 automjet për shpërndarjen e Ushqimeve blegtoriale është mëse i mjaftueshëm.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/ç ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/e “Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim” është rekomanduar që: “e. Operatori të ketë në pronësi ose në përdorim automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportin e mallrave, automjet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportin e mallrave në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe që plotësojnë kushtet higjieno sanitare.”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave

të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t'u vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallravë objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe paisjet përfshihet dhe automjeti i nevojshëm për kryerjen e furnizimit i cili referuar edhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit duhet të jetë i llojit ATV (frigorifer).

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit "mallra" duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetit për transportin e ushq blëtoriale, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rregor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 81

Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjete;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjete dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të tretëve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.

Neni 83

Dhënia me qira pa drejtues mjete

1. Për zbatimin e këtij neni, një mjet quhet i caktuar për dhënie me qira pa drejtues mjete kur qiradhënësi, kundrejt pagesës, detyrohet të verë në dispozicion të qiramarrësit, me kërkesën e këtij të fundit, vetë mjetin.
2. Mund të caktohen për dhënie me qira të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, përfshirë edhe mjetet e caktuara për transportin e mallrave, me ngarkesë të plotë, e cila është mbi 1,5 ton, si dhe mjetet, të ndryshme nga autoveturat, të caktuara për transportin e njerëzve.

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete me motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:

- a) lejeqarkullimin;
- b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
- c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
- ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
- d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Referuar dispozitave të mësipërme përcaktuam se mjetet mund të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues ose me kontratë qeraje, ku në rastin e pronësisë mbi mjetin të paraqitet, leja e qarkullimit të mjetit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, ndërsa në rastet kur automjeti është me qera të paraqitet kontrata e qerave dhe dokumentacioni i mjetit në emër të qeradhënësit si ne vijim: leja e qarkullimit të mjetit në emër të qeradhënësit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit.

Nisur nga fakti që automjeti i përcaktuar në këtë kriter do të bëjë transport mallrash dhe në rastin konkret të artikullit “bukë” dhe meqënëse ka rregullim të vecantë ligjor lidhur me transportin e mallrave dhe për të shmangur ndonjë situatë të bllokimit të mjetit nga ana e policisë për shkak të mungesës së dokumentacionit, cka do të illte dhe vonesa në furnizimin me artikullin e sipërpërmendur objekt prokurimi ju referuam nenit 46 të ligjit nr, 8380, datë 18.3.1998 :Për transportet rrugore” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 1

- a) Ky ligj do të zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.*
- b) Ky ligj do të zbatohet, gjithashtu, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të mallrave për të tretë, me qira ose për nevojat e veta brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.*
- c) Transporti rrugor i mallrave për të tretë dhe me qira ose për nevojat e veta përshin ngarkimin, shkarkimin dhe lëvizjen bosh dhe plot të mjetit.*

KREU III.1

TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PËR TË TRETË

Neni 41

Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

KREU III.2
TRANSPORTI I MALLRAVE PËR VETE

Neni 45

Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë.

Neni 46

(ndryshuar ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.

Neni 47

Llojet e mallrave për transport brenda vendit për nevojat e veta që nuk kanë nevojë për certifikatë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë dhe certifikaten ose lejen e transporti të vlefshme në momentin e ofertës, por për automjetet me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton nuk kërkohet që të paraqitet certifikata ose leja e transportit, pasi mjetet me këtë kapacitet mbajtës nuk pajisen me leje apo certifikatë transporti.

Nisur nga natyra e mallrave që do të transportohen të cilat janë produkte ushqimore lidhur ju referuam Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar" përcaktohet se:

"Mjetet e transportit

Në se subjekti disponon dhe përdor mjete për transportin e produkteve të ndryshme, përdorimi i të cilëve ka, apo mund të ketë ndikime në shëndetin publik, mjetet e transportit duhet të përmbushin kërkesat higjieno-sanitare dhe sipas destinacionit të tyre,

- të jenë të ndërtuara me materiale veshëse të tillë që të mos ndikojnë (dhe ndikohen) negativisht ndaj produkteve që transportohen dhe ndaj pastrimit/larjes;

- të jenë të mbyllur/mbuluar, përfshi edhe hemeticitetin e derës/dyerve, për të siguruar mbrojtjen e produkteve që transportohen nga plihurat, rrezet e diellit, shiu dhe nga agjentët atmosferikë dhe mjedisorë në përgjithësi;

- të kenë paisje ftohëse (autofrigorifer) për produktet që kërkojnë domosdoshmërisht transport në temperatura të caktuara;

- të kenë paisje të duhura (barëse, mbërthyes, arka, etj) për vendosjen dhe mbajtjen e produkteve që transportohen;

Mjetet e transportit duhet të përdoren për destinacione të caktuara, duke mos kryer shërbime dhe mostransportuar njëkohësisht produkte me veçori të ndryshme (njerëz dhe mallra në përgjithësi, produkte joushqimore dhe ushqimore, produkte të ambalazuara dhe të paambalazuara, etj).

Autobotët për transport lëngjesh, të jenë të ndërtuar/veshur me materiale të tillë që për karakteristikat e lëngjeve që mbarten, të mos ndikojnë në përbërjen e tyre.

Pas përfundimit të ransporteve dhe pas punës në përgjithësi, mjetet e transportit pastrohen, dhe sipas destinacionit të tyre, mekanikisht (me fshesë, furca, mjete fërkuese, etj) apo me tretësira pastruese (si psh tretësirë sode 0.5 – 1 -2 %, ujë i nxehtë 60-70 °C, me avull uji, etj) thjesht apo me presion, pasuar me shpëlarje përfundimtare me ujë të pastër.

Mjetet e transportit sa më sipër pajisen me Aktmiratim Higjeno-Sanitar.”.

Pra nisur nga parashikimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë Aktin e Miratimit-Higjeno-Sanitar të vlefshëm të automjetit.

2.3.5. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të disponojë në stafin e tij punonjës, si me poshtë:

- 1 (një) shofer
- 1 (një) punëtor

- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune e vlefshme, leja drejtimi të automjetit me kategorinë përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetin në emër të punonjësit.
- Për punonjësit e punësuar punëtorë të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune e vlefshme

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Për të dëshmuar së disponon në stafin e tij 1 (një) shofer operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” datën e kontratës së punës, emrin e punëmarrësit dhe numrin e lejes së drejtimit të automjetit të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Sqarim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës që prokurohet me anë të së cilës dëshmon se ka në stafin e tij 1 (një) punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetit që do deklarojë se disponon me qëllim që të dëshmojë se mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore , brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret duhet të kenë dhe punonjës të punësuar për realizimin e kontratës.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/c "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose".

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Lidhur me numrin e punonjësve që duhet të disponojnë operatori ekonomik, meqënëse kjo dispozitë nuk përcakton numrin e punonjësve, por thjesht faktin që duhet kërkuar fuqi punonjëse në raport me objektin e kontratës që prokurohet, njësia e prokurimit nisur nga objekti i kontratës e cila ka si qëllim furnizimin me ushqimeve të 5 konvikteve në administrim të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, gjykohet se është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar 2 (dy) punonjës nga të cilët 1 (një) punonjës duhet të kryejë punën e shoferit me qëllim që të bëjë transportin me mjet të ushqimeve nga vendi ku magazinohen në adresat e pesë konvikteve, si dhe 1 (nje) punonjës për ngarkimin dhe shkarkimin e mallit objekt prokurimi, te domosdoshem per kryerjen e ngarkimit dhe shkarkimit te mallit.

Lidhur me dokumentacion vërtetues përsa i përket disponimit të dy personave të punësuar, njësia e prokurimit, ju referuar parashikimeve ligjore si më poshtë:

Së pari, në Kreut V, neni 11, pika 1/e, neni 12 dhe neni 21, pika 1, të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet si më poshtë:

KREU IV

Neni 11

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
- c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore
- d) Kontrata kolektive e punës
- e) Kontrata individuale e punës
- f) Rregullorja e brendshme
- g) Zakonet lokale dhe profesionale.

Neni 12

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në

dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.

Neni 21

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

Së dyti, në nenin 14, të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë:

Neni 14

Operatorët ekonomikë

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Së treti, në nenin 115 dhe nenin 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë:

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:
 - a) lejeqarkullimin;
 - b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
 - c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
 - ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
 - d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Neni 115

Kategoritë e lejedrejtimit për drejtimin e motomjeteve dhe automjeteve

1. Ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod.2. Përgatitja e kandidatit për lejedrejtimi bëhet në autoshkolla dhe provimet e ftësisë për ejedrejtimi duhet të bëhen pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pasi të plotësohen kushtet e caktuara fizike e mendore. Ministria përgjegjëse për transportin përcakton procedurën për lëshimin, përditësimin dhe dhënien e dublikatës, përmes një sistemi informatik, të lejedrejtimit, si dhe certifikatave të kualifikimeve profesionale, duke pasur si qëllim thjeshtimin e procedurave administrative. Kandidati për drejtues mjeti

mund të regjistrohet dhe të kryejë kursin e teorisë e të praktikës në çdo drejtori rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pavarësisht nga regjistrimi në gjendjen civile.

3. Lejedrejtimi, sipas modelit të Bashkimit Europian, siç përcaktohet me vendim të Këshillit Ministrave, ndahet sipas kategorive dhe aftësive në drejtimin e mjeteve, të përcaktuara për secilën nga kategoritë e mëposhtme:

Kategoria AM:

a) ciklomotorë me dy rrota, kategoria L1, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo me shumë se 45 km/h, fuqia cilindrike e të cilit është më e vogël apo e barabartë me 50 cm³, nëse është me djegie të brendshme, apo fuqia maksimale e vazhdueshme është më e vogël apo e barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

b) mjete me ose pa kosh dhe mjete me tri rrota, kategoria L2, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h dhe me motor me fuqi cilindrike më të ulët apo të barabartë me 50 cm³, nëse ky është me ndezje të komanduar, apo kur fuqia e tij maksimale neto është më e ulët ose e barabartë me 4 kË, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose për ata që fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

c) mjete me katër rrota të lehta, kategoria L6, masa bosh e të cilave është më e ulët ose e barabartë me 350 kg, duke përfshirë masën e baterive për automjetet elektrike me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h, me fuqi cilindrike të motorit më të ulët ose të barabartë me 50 cm³, për motorët me ndezje të komanduar, ose ata të cilët fuqinë maksimale neto e kanë më të ulët apo të barabartë me 4 kË, për motorët e tjerë me djegie të brendshme; ose ata të cilët fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

Kategoria A1:

a) motomjet me cilindratë jo më shumë 125 centimetër kub dhe me fuqi jo më shumë se 11 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,1 kË/kg;

b) tricikël me një fuqi jo më të madhe se 15 kË;

Kategoria A2: motomjet me fuqi jo më shumë se 35 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,2 kË/kg, që nuk rrjedh nga një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij;

Kategoria A: motomjet me fuqi më shumë se 15 kË;

Kategoria B1: motomjet me katër rrota, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të kategorisë AM, masa pa ngarkesë e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 400 kg ose 550 kg për mjetet e destinuar për transport mallrash (kategoria L7), përfshirë masën e baterive për automjetet elektrike, të cilat fuqinë maksimale neto të motorit e kanë më të ulët ose të barabartë me 15 kË. Këto mjete konsiderohen si mjete me tri rrota dhe janë në përputhje me rregullat e aplikueshme për mjetet e kategorisë L5;

Kategoria B: mjet motorik me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3 500 kg dhe me jo më shumë se 8 ndenjësë, përfshirë ndenjësën e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg, duke u siguruar që masa maksimale e autorizuar e këtij kombinimi të mos kalojë 4 250 kg. Në rast se kombinimi i kalon 3 500 kg, drejtuesi duhet t'i nënshtrohet një trajnimit dhe provimit të posaçëm;

Kategoria BE: kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios nuk i kalon 3 500 kg;

Kategoria C1: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg, por jo më shumë se 7 500 kg ose i projektuar dhe i konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria C1E: kombinimi i një mjeti motorik të kategorisë C1 dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg, por masa maksimale e autorizuar e kompleksit të formuar nuk i kalon 12 000 kg;

Kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje apo gjysmërimorkioje, masa e autorizuar e të cilave i kalon 3 500 kg, me kusht që, në masë, kombinimi i autorizuar të mos i kalojë 12 000 kg;

Kategoria C: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg ose i projektuar dhe konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria CE: kombinimi i një mjeti të kategorisë C me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg;

Kategoria D1: mjet motorik i projektuar dhe konstruktuar për jo më shumë se 16 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit, dhe me gjatësi maksimale që nuk i kalon 8 m. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D1E: kombinim i një mjeti të kategorisë D1 me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750kg;

Kategoria D: mjet motorik i projektuar dhe i konstruktuar për më shumë se 8 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D

E: kombinimi i një mjeti të kategorisë D me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme ligjore njësia e prokurimit vendosi që dokumentacioni vërtetues lidhur me punësimin e dy punonjësve në stafin e operatorëve ekonomik ofertues vendosi që të përcaktojë kontratën e punës sipas formës së parashikuar në pikën 1, të nenit 21 të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurim e cila është përcaktuar si një vit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit,

Ndërsa lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzojë operatori ekonomik ofertues për të vërtetuar se ka të punësuar një punonjës që kryen detyrën e shoferit, i cili duhet të jetë i pajisur me lejedrejtimi mjeti ju referuam nenit 115 dhe nenit 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. ku meqënëse nuk kemi parashikuar kapacitetin mbajtës të mjetit të përshtatshëm për transportin e mallrave objekt prokurimi, por e kemi lënë në mundësinë që ka për disponimin e një mjeti të tillë me kapacitet mbajtës të caktuar vetë operatori ekonomik ofertues, atëherë kemi përcaktuar se

shoferi duhet të paraqesë lejen e drejtimit të këtij mjeti, ku kjo lejedrejtimi duhet të jetë sipas kategorisë që i përket mjeti që disponon sipas kriterit të përcaktuar në Pikën 2.3.4 të “Kapacitetit teknik” të Shtojcës 7 të dokuemntave të tenderit.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues në rast se është vetë prodhues i produkteve të qumështit dhe nënprodukteve të tij si dhe produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij duhet të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë kontratë pune, diplomë, librezë shëndetësore të vlefshme, si dhe listëpagesën e shoqërisë për muajin gusht 2024, ku të jetë i përfshirë teknologu ushqimor.

-Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij, si dhe të qumështit dhe nënprodukteve të tij, duhet të ketë marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi me prodhuesin produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij, si dhe me prodhuesin e qumështit dhe nënprodukteve të tij.

-Operatori ekonomik ofertues në rastin kur ka marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi me prodhuesin produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij duhet të provojë se prodhuesi i mishit dhe nënprodukteve të tij ka të punësuar në stafin e tij një **teknolog ushqimor** dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë kontratë pune, diplomë, librezë shëndetësore të vlefshme, si dhe listëpagesën e shoqërisë prodhuese të mishit dhe nënprodukteve të tij për muajin Gusht 2024, ku të jetë i përfshirë teknologu ushqimor .

-Operatori ekonomik ofertues në rastin kur ka marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi me prodhuesin produkteve të qumështit dhe nënprodukteve të tij duhet të provojë se prodhuesi i qumështit dhe nënprodukteve të tij ka të punësuar në stafin e tij një **teknolog ushqimor** dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë kontratë pune, diplomë, librezë shëndetësore të vlefshme, si dhe listëpagesën e shoqërisë prodhuese të qumështit dhe nënprodukteve të tij për muajin Gusht 2024, ku të jetë i përfshirë teknologu ushqimor.

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues është vetë prodhues i bukës, duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” emrin e teknologut ushqimor, datën e kontratës së punës, numrin dhe datën e diplomës dhe instiucionin arsimor që e ka lëshuar, numrin e librezës shëndetësore.

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues, por ka një kontratë qeraja apo kontratë huapërdorje apo një marrëveshje bashkëpunimi apo një marrëveshje furnizimi me shoqërinë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të mallit objekt prokurimi, duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” emrin e teknologut ushqimor të punësuar në stafin punonjës të shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të mallit objekt prokurimi, datën e kontratës së punës me punëmarrësin e shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të mallit objekt prokurimi për këtë lot, numrin dhe datën e

diplomës dhe instiucionin arsimor që e ka lëshuar të teknologut ushqimor të punësuar në stafin e shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të mallit objekt prokurimi për këtë lot, numrin e librezës shëndetësore të teknologut ushqimor të punësuar në stafin e shoqërisë që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit të mallit objekt prokurimi për këtë lot.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit të këtij loti është blerja e produkteve ushqimore me origjine shtazore e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij dhe produktit të qumështit dhe nënprodukteve të tij duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret duhet të kenë në staf punonjës të punësuar dhe të formuar profesionalisht për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/6 "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës që janë të nevojshëm dhe të formuar profesionalisht për të zbatuar objektin e prokurimit dhe në rastin konkret meqënëse objekti i prokurimit të këtij loti është blerja e produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij, si dhe produktit të qumështit dhe nënprodukteve të tij atëherë duhet që të ketë të punësuar punonjës që kanë formimin profesional për kryerjen e procesit të prodhimit (copëtimit) të mishit dhe të prodhimit të nënprodukteve të tij, si dhe të prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij dhe për më tepër që ky artikull do tu shërbehet një kategorie që janë delikat siç janë fëmijët.

Lidhur me numrin e punonjësve që duhet të disponojë operatori ekonomik, meqënëse kjo dispozitë nuk përcakton numrin e punonjësve, por thjesht faktin që duhet kërkuar fuqi punonjëse në raport me objektin e kontratës që prokurohet, njësia e prokurimit nisur nga objekti i kontratës e cila ka si qëllim furnizimin me ushqimeve të 5 konvikteve në administrim të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, gjykohet se është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar 1 (një) punonjës i cili ka formimin profesional për kryerjen e procesit të të prodhimit (copëtimit) të mishit dhe të prodhimit të nënprodukteve të tij, si dhe 1 (një) punonjës i cili ka formimin profesional për kryerjen e procesit të prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij .

Lidhur me dokumentacion vërtetues përsa i përket disponimit 1 (një) punonjës i cili ka formimin profesional për kryerjen e procesit të të prodhimit (copëtimit) të mishit dhe të prodhimit të nënprodukteve të tij, si dhe 1 (një) punonjës i cili ka formimin profesional për kryerjen e procesit të prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, ju referuar parashikimeve ligjore si më poshtë:

Së pari, në nenin 40, pika 1 dhe 2 të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë:

Neni 40

Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

(Nryshuar me Ligj Nr. 10209, dt.23.12.2009. Botuar ne Fl.z. Nr. 194. dt. 20. 01.2010).

- 1. Personat fizikë dhe juridikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.*
- 2. Personat e regjistruar sipas këtij ligji pajisen me numër identifikimi unik, të gjeneruar elektronikisht, i cili shërben si numër i identifikimit tatimor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore.*

Së dyti, në Udhëzimin Nr.6 e Minsitrit të Financave dhe Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, datë 18.1.2005 "Për dokumentacionin e deklarimit dhe pagesës së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" përcaktohet si më poshtë:

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar, janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore bazuar në dokumentacionin e përcaktuar më poshtë:

"Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore" E-SIG 011/a, (pa plotësuar pjeset e përfitimeve), i cili dorëzohet në degën e bankës ose zyrën e Postës Shqiptare sh.a. ku paguhen kontributet, sipas përcaktimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

"Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shëndetësore" E-SIG 012/a, i cili dorëzohet në degën e bankës ose zyrën e Postës Shqiptare sh.a. ku paguhen kontributet, sipas përcaktimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

"Formulari E-SIG 025/a "Listëpagesa e Sigurimeve Shoqërore, Sigurimeve Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga punësimi", i cili dorëzohet në degën e tatimeve ku është i regjistruar tatimpaguesi;

Formulari E-SIG 27/a "Pasqyra e të punësuarve rishtazi dhe e të larguarve", i cili dorëzohet në Degën e Tatimeve (në rastet kur ka të punësuar të rinj, të ripunësuar ose të larguar).

Dokumentat e mësipërme dorëzohen në afatet që vijojnë:

Nga personat juridike, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të takses vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë, apo çdo funksion tjetër, trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

Nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-se, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit;

Nga personat juridike të regjistruar si tatimpagues të takses vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Kur edhe pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë, apo çdo funksion tjetër, trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

Nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të takses vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit;

Së treti, në pikën 1 "Regjistrimi në organin tatimor" dhe pika 4 "Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve" të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.4, datë 30.01.2006 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", i ndryshuar,

1. REGJISTRIMI NË ORGANIN TATIMOR

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisin personat për të cilët paguajnë kontribute me Numrin e Sigurimit Shoqëror (NSSh), të cilin e terheqin nga organet e sigurimeve shoqërore. Ky numer përfaqëson personin, është unik dhe i paperseritshëm për çdo person tjetër. Pra i njëjti person, pavarësisht se gjatë jetës mund të ndryshojë subjektet ku punësohet, mban të njëjtin numer të sigurimit shoqëror. Numri i Sigurimit Shoqëror, për personat e punësuar gjatë atij muaji, vendoset në Formularin numer E-SIG 025/a “Listepagesa e Sigurimeve Shoqërore, Shendetesore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, në kolonen e parë të tij, krahas emrit të personit të punësuar

4. AFATET E DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË KONTRIBUTEVE

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit. Deklaratat paraqiten dhe kontributet paguhen në afatet e mëposhtme:

<i>Personi që detyrohet të paguajë kontributet</i>	<i>Kontributet që paguhen</i>	<i>Shpeshësia e deklarimit dhe pageses</i>	<i>Afati për deklarimin dhe pagesen</i>
<i>Personi juridik i regjistruar si tatimpagues i TVSH</i>	<i>a) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarresve b) Kontributet e punëdhënësit për punëmarresit</i>	<i>Mujore</i>	<i>Jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës</i>
<i>Personi fizik i regjistruar si tatimpagues i TVSH</i>	<i>a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes c) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit</i>	<i>Mujore</i>	<i>Jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës</i>
<i>Personi juridik i regjistruar si tatimpagues i takses vendore mbi</i>	<i>a) Kontributet që mbahen nga pagat e punëmarresve b) Kontributet e</i>	<i>Per çdo tremujor brenda dates 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo</i>	<i>Jo më vonë se datat: 20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor;</i>

<i>biznesin e vogel.</i>	<i>punëdhënësit per punemarresit</i>	<i>tremujori te vitit kalendarik</i>	<i>20 Janar.</i>
<i>Personi fizik i regjistruar si tatimpagues i takses vendore mbi biznesin e vogel.</i>	<i>a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete</i> <i>b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes</i> <i>c) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve</i> <i>d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit</i>	<i>Per çdo tremujor brenda dates 10 te muajit te pare pas perfundimit te çdo tremujori te vitit kalendarik</i>	<i>Jo me vone se datat: 20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; 20 Janar.</i>

Së katërtri, në Kreut V, neni 11, pika 1/e, neni 12 dhe neni 21, pika 1, të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet si më poshtë:

KREU IV

Neni 11

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*
- b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*
- c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore*
- d) Kontrata kolektive e punës*
- e) Kontrata individuale e punës*
- f) Rregullorja e brendshme*
- g) Zakonet lokale dhe profesionale.*

Neni 12

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në

dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.

Neni 21

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

Së pesti, në nenin 14, të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë:

Neni 14

Operatorët ekonomikë

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Së gjashti, në VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, përcaktohet si më poshtë:

VENDOSI:

- 1. Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.*
 - 2. Klasifikimi i Listës Kombëtare të Profesioneve, e njohur shkurtimisht si “LKP”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.*
 - 3. Lista Kombëtare e Profesioneve (LKP) zbatohet nga agjencitë statistikore, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.*
 - 4. Kodet statistikore të Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të përdorura deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zëvendësohen me kodet e parashikuara në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), bashkëlidhur këtij vendimi.*
 - 5. Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore kryejnë përditësimin e informacionit statistikor zyrtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.*
 - 6. Ngarkohen institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3, për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.*
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

Grupi i vogël

“Punonjës në teknologjinë ushqimore”

Kodi i profesionit: 751

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punonjës në teknologjinë ushqimore”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Punonjësit e teknologjisë ushqimore merren me përgatitjen, përpunimin dhe tregtinë e ushqimit për konsum. Ata merren me therjen e kafshëve për mish dhe përgatitjen e nënprodukteve të mishit,

përgatitjen e nënprodukteve të miellit, të perimeve, të frutave, përgatitjen e pijeve alkoolike dhe joalkoolike, përpunimin e duhanit etj. Ata merren me përpunimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin e tyre. Ata mund të punësohen në kompani të ndryshme shërbimesh, prodhimesh ushqimore, në shoqëri tregtare që kanë reparte të shërbimit ushqimor dhe të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore:

Punonjësit e teknologjinë ushqimore kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

a) Bëjnë preventivin e materialeve të duhura për prodhimin, përgatitjen e nënprodukteve në sasinë e kërkuar;

b) Sigurojnë lëndën e parë të nevojshme për prodhimin e produktit;

c) Përgatitin makineritë apo pajisjet për punë;

d) Kryejnë peshime apo matje të sasisë së lëndës së parë që do të përdorin për prodhimin, përgatitjen e nënprodukteve;

e) Përgatitin nënprodukte të miellit si: lloje të ndryshme të bukës, ëmbëlsira dhe produkte të tjera;

f) Bëjnë pjekjen e produktit në temperaturën dhe kohën e duhur;

g) Përpunojnë fruta, perime dhe përgatitin nënprodukte ushqimore prej tyre;

h) Përpunojnë fruta dhe përgatitin pije alkoolike dhe jo-alkoolike;

i) Përpunojnë qumështin dhe prodhojnë produkte dhe nënprodukte të tij;

j) Përpunojnë duhanin dhe përgatitin produkte të tij;

k) Kryejnë therjen e kafshëve dhe trajtimin e mishit dhe peshkut duke përgatitur nënprodukte të tyre dhe artikuj të ndryshëm ushqimor;

l) Bëjnë prerjet dhe ambalazhimet e nevojshme;

m) Kryejnë konservimin e frutave, perimeve, mishit, peshkut me metodat apo teknologjitë përkatëse etj.;

n) Kryejnë degustimin e ushqimeve dhe pijeve;

o) Ruajnë produktet dhe lëndën e parë në kushtet teknike dhe frigoriferike të duhura;

p) Kryejnë tregtimin e produkteve dhe nënprodukteve ushqimore;

q) Pastrojnë makineritë dhe pajisjet e përdorura;

r) Realizojnë detyra të tjera të ngjashme;

s) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;

t) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional në këtë fushë;

b. Të ketë kryer për këtë profesion.

c. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një punonjës i

teknologjisë ushqimore mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse. Ndjekja e shkollës së lartë,

çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier teknolog, inxhinier kimist,

etj..

Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si

person fizik apo juridik, sipas rastit.

Punonjësit në këtë grup profesionesh mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si brumëgatues, bukëpjekës, pastičier, prodhues të produkteve dhe nënprodukteve të qumështit, mishit, përpunues të frutave dhe perimeve, përpunues i duhanit etj.

Së shtati, në nenin 19 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar përcaktohet se:

"Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare, fitosanitare apo veterinarë, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me

shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Së teti, lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet QKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;

c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;

ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;

d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;

dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;

e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;

ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;

f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;

g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi 1

FUSHA II
USHQIMI DHE SHËNDETI
KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.B

11. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.B jepen për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes.

12. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategorinë II.1.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a) Mjediset b) Teknologjia c) Pajisjet lidhur me standardet teknikuteknologjike dhe ato higjienosanitare (sipas specifikimeve)	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e këtyre faktorëve

Së nënti, meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;".

Së dhjeti, në Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 dhe Nr.8541, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kritereve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", Pika.III m, a/3 përcaktohet se: "a.3. Për këto lloj procedura të prokurimi, personeli që do të realizojë procesin e prodhimit të ushqimit, të ketë kualifikimin e nevojshëm profesional, të vërtetuar me dokumentacion përkatës."

Së njëmbëdhjeti, nisur nga natyra e mallrave që do të transportohen të cilat janë produkte ushqimore lidhur ju referuam Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar" përcaktohet se:

" Punonjësit

Punonjësit të jenë me uniformë pune, të rregullt, në raste të veçantë dhe për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, uniforma të jetë e posaçme përsa i përket llojit / përbërjes të veshjes, përdorimit të përparseve dhe këpucëve të veçanta, apo çizmeve, dorezave, kapuç, maska, syze mbrojtëse, etj).

Në shërbim të punonjësve, në objekt / objekte të disponohet vend i veçantë, me pajisjet përkatëse (rafte, garderobë, varëse etj).

Punonjësit të jenë të pajisur me Libreza Shëndetësore, të cilat duhet të jenë në çdo kohë në vendin e punës.

Çdo punonjës në objekt / objekte zbaton rregullat e higjienës personale.

Në ndërmarrjet me mbi 15 punonjës, duhet të ketë shërbim mjekësor (part time ose kohe të plote) dhe të disponohet dokumentacioni përkatës, kartelat mjekësore për çdo punonjës dhe realizimi i kontrolleve mjekësore periodike."

Nisur nga përcaktimet e mësipërme ligjore njësia e prokurimit vendosi që meqënëse në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.1 "Kapaciteti profesional të operatorëve ekonomikë" të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit ku është parashikuar që ofertuesi duhet të jetë prodhues mishi dhe nënprodukteve të tij dhe prodhues i qumështit dhe nënprodukteve të tij ose kur nuk është prodhues të ketë marrvëshje bashkëpunimi ose kontratë furnizimi me një prodhues mishi dhe nënprodukteve të tij, si dhe më një prodhues qumështi dhe nënprodukteve të tij, atëherë për të rritur garancinë që operatori ekonomik ofertues ka kapacitetin profesional lidhur me punësimin në stafin e tij të personave me kapacitet profesionale lidhur me realizimin e objektit të prokurimit e gjykoj të nevojshme

dhe të mbështetur në ligj kërkesën që prodhues mishi dhe nënprodukteve të tij, si dhe prodhuesi i qumështit dhe nënprodukteve të tij të ketë të punësuar në stafin e tij një punonjës të arsimuar në degën "Teknologji ushqimore", i cili përcaktohet dhe në bazën ligjore të sipërpërmendur dhe është në rolin e drejtuesit teknik dhe që ka arsimin profesional përkatës për kryerjen e kësaj veprimtarie, çka na jep sigurinë më të madhe lidhur me realizimin me cilësi të objektit të kontratës që po prokurohet dhe që është blerja e produkteve të mishit dhe nënprodukteve të tij dhe produkteve të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cila do të konsumohet nga fëmijët në mensat e konvikteve që administrohen nga autoriteti ynë kontraktor.

Lidhur me dokumentacioni vërtetues lidhur me punësimin e 1 (një) teknologu ushqimor në stafin e operatorëve ekonomik ofertues u përcaktua si dokumentacion provues kontrata e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurim e cila është përcaktuar si një vit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe diplomën e shkollës së lartë në degën "Teknologji ushqimore" parashikuar në pikën 1, të nenit 21 të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 dhe Nr.8541, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", si dhe detyrimin që operatori ekonomik ofertues të paraqesin listëpagesat e formatit E-SIG 025/a për 1 (një) teknologu ushqimor të siguar, ndërsa për periudhën kohore për të cilën duhet të paraqesi këto listëpagesa njësisia e prokurimit nisur nga data e parashikuar për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi e cila është në muajin shtator 2023, si dhe nisur nga përcaktimet ligjore të mësipërme lidhur me afatin kohor të deklarimit të listëpagesat e formatit E-SIG 025/a në varësi të formës së operatorit ekonomik ofertues, i cili sipas parashikimeve të nenit 14 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" këto ofertues mund të jenë persona fizik ose juridik dhe meqënëse në nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar është parashikuar që në procedurat e prokurimit publik të llojit "E Hapur e Thjeshtuar" kriteret kualifikuese të hartohen në mënyrë të thjeshtuar meqëllim që të sigurohet pjesmarrja e biznesit të vogël dhe të mesëm, ndonëse kjo procedurë prokurimi është e llojit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar" gjykuam që periudha kohore për paraqitjen e listëpagesave të jetë konkretisht për muaji gusht 2024.

Gjithashtu nisur nga përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar" është kërkuar që për teknologun ushqimor të paraqitet edhe librezë shëndetësore.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, i cili ka kontratë furnizimi me kompani prodhimi mishi dhe nënprodukteve të tij, qumështi dhe nënprodukteve të tij, ose kontratë furnizimi me kompani importuese dhe tregtuese mishi dhe nënprodukteve të tij, qumështi dhe nënprodukteve të tij, atëherë duhet të paraqes një deklaratë të lëshuar nga administratori i kompanisë prodhuese të mishit dhe nënprodukteve të tij dhe qumështi dhe nënprodukteve të tij, ose i kompanisë importuese dhe tregtuese të mishit dhe nënprodukteve të tij dhe qumështi dhe nënprodukteve të tij, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore.

Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

ARGUMENTIMI: Nisur nga fakti që respektimi i kërkesave të sigurisë ushqimore për furnizimin me ushqime për konviktet ku jetojnë fëmije është shumë i rëndësishëm, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 dhe Nr.8541, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/g është kërkuar që ofertuesi i cili është prodhues i mishit dhe nënprodukteve të tij dhe qumështit dhe nënprodukteve të tij të paraqesë në fazën e ofertimit këtë deklaratë dhe në rast se shpallet fitues të paraqesë përpara lidhjes së kontratës vërtetimin e lëshuar nga AKU-ja, ndërsa në rastet kur nuk është vetë prodhues, por ka marrëveshje bashkëpunimi ose furnizimi përsëri duhet të dorëzojë deklaratë për aktivitetin e tij dhe deklaratë nga kompania prodhuese të mishit dhe nënprodukteve të tij dhe kompania e qumështi dhe nënprodukteve të tij, pasi të dy janë pjesë e zinxhirit ushqimor ku njëri është prodhues dhe tjetri tregëtar dhe në rast se shpallet fitues të paraqesë përpara lidhjes së kontratës vërtetimin e lëshuar nga AKU-ja si për ofertuesin ashtu dhe për prodhuesin.

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur një deklaratë.

2.3.9. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **Raport/Fletë Analizë për treguesit Fiziko-Kimike dhe Shqisorë, si dhe Treguesit Mikrobiologjikë**, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, jo më herët se 30 ditë nga data e zhvillimit të procedurës, për artikujt:

- vezë
- salçiçe
- mish viç
- mish pule
- djath
- qumësht
- gjalp.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të realizojë kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie reputacionin për të prodhuar dhe tregtuar mallra me standarte cilësie gjykon si të nevojshme që produkti që do të ofrohet nga operatorët ekonomikë ofertues të jetë sipas kërkesave të cilësisë.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 6/d "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*”6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
d) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit *“Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”*, Pika.III/e *“Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim”* është rekomanduar që:

“I.2. Për ushqimet dhe produktet ushqimorel .

Në vendosjen e specifikimeve teknike për këtë kategori të produkteve duhet të mbahet në konsideratë që, për të gjithë produktet ushqimore do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për Ushqimin.

Ndërmjet të tjerave, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në specifikimet teknike që:

b. Raport analiza përkatëse duhet të jetë sipas llojit të produktit, numrit të Lotit, dhe jetëgjatësisë së produktit dhe të ketë lidhje me produktin/mostrën e ofertuar. Në këtë raport analizë duhet të jetë shënuar: emërtimi i produktit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me produktin e ofertuar.

c. Produkti kur të lëvrohet, duhet të jetë i shoqëruar me çertifikatën e origjinës dhe fletë analizë për treguesit e sigurisë e cilësisë, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

d. Të gjithë treguesit organo-leptikë dhe fiziko-kimikë të produktet të ofertuar/mostrës që përfaqësojnë artikullin duhet të përputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe të Standardit Shtetëror përkatës. Standardet shtetërore për karakteristikat e produkteve ushqimore janë të disponueshme dhe janë të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit (DPS) në faqen e internetit www.dps.gov.al .”.

Në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit janë përcaktuar specifikimet teknike të produktit objekt prokurimi për Lotin 3, ku është përcaktuar se artikulli *“VEZË -Bazuar në SSH 325-1 :1993 ose ekuivalentin e tij”*; *QUMËSHT - Bazuar në SSH 1563:1987 ose ekuivalentin e tij”*; *“KOS - Bazuar në SSH 1443:1987 ose ekuivalentin e tij”*; *“DJATHI I BARDHË - Bazuar në SSH 1492:1987 ose ekuivalentin e tij”*; *“GJALP ME KRIPË - Bazuar në SSH 1445:1987 ose ekuivalentin e tij”*; *“SALÇIÇE dhe KREMVIÇE - Bazuar ne SSH 1458:1990 ose ekuivalentin e tij”*; *“MISH PULE - Bazuar ne SSH 1168:1987 ose ekuivalentin e tij”*; *“MISH VIÇI - Bazuar në SSH 1441:1987 ose ekuivalentin e tij”*, ku në këto standarte janë të përcaktuar parametrat organo-leptikë dhe fiziko-kimikë ndërsa në Udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 *“Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”* janë përcaktuar nivelet maksimale të treguesit të ngarkesës mikrobiale që duhet të përmbushin këro artikuj.

Ndërkohë në nenin 5, të ligjit nr. 116/2014, *“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”*, përcaktohet si më poshtë:

Neni 5

Procesi i akreditimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton:
 - a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues;
 - b) organe certifikuese të sistemeve të me- naxhimit;
 - c) organe certifikuese të personelit;
 - ç) organe certifikuese të produkteve;
 - d) organe inspektuese;
 - dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;
 - e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.
2. Akreditimi për çdo fushë të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, bëhet kundrejt tarifave të akreditimit, të paguara nga organi i vlerësimit të konformitetit. Llojet, masa dhe mënyra e pagesës së tarifave për çdo fushë akreditimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kryen trajnime për palët e treta, kundrejt tarifave përkatëse. Llojet, masa dhe mënyra e pagesës së këtyre tarifave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit vlerëson nëse një organ i vlerësimit të konformitetit është kompetent për të kryer aktivitete specifike të vlerësimit të konformitetit dhe lëshon një certifikatë akreditimi për ta zyrtarizuar këtë.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit mbikëqyr çdo organ të vlerësimit të konformitetit, të cilit i ka lëshuar certifikatë akreditimi.
6. Për vlerësimin/mbikëqyrjen e kompetencës teknike të organeve të vlerësimit të konformitetit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon një grup me specialistë vlerësues të institucionit dhe/ose të jashtëm, vendas apo të huaj, të cilët veprojnë gjithmonë në emër të këtij institucioni.
7. Shpenzimet e akreditimit, kur vlerësuesi teknik është i huaj, përfshijnë:
 - a) pagesën e vlerësuesit, sipas tarifave të vendit të origjinës, por, gjithmonë, në marrëveshje me organin e vlerësimit të konformitetit që ka aplikuar për akreditim;
 - b) shpenzimet e akomodimit (fjetje, ushqim) dhe transport;
 - c) çdo tarifë tjetër të procesit të akreditimit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Kur vlerësimi teknik bëhet nga vlerësues vendas, tarifa e akreditimit përfshin tarifën e përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni. Masa e pagesës së vlerësuesve vendas që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
9. Pagesat e vlerësuesve teknikë, të huaj dhe atyre vendas, që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, nga të ardhurat, sipas pikës 2 të nenit 15, të këtij ligji.
10. Në rast se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit konstaton që një organ i vlerësimit të konformitetit nuk është më kompetent për të kryer një veprimtari të veçantë të vlerësimit të konformitetit ose kur ai ka kryer një shkelje serioze të detyrimeve të tij, ajo merr masat e duhura brenda një kohe të arsyeshme për të reduktuar, pezulluar ose tërhequr certifikatën e tij. Procedurat e reduktimit, pezullimit ose tërheqjes së akreditimit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe bëhen publike.
11. Procedurat për trajtimin e apeliemeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe bëhen publike.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe që në këtë rast janë raportet e provave ose raportet e testimit të lëshuara nga laboratorë të autorizuar sipas përcaktimeve të standarteve shtetëror të sipërpërmendur, përcaktimeve të Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore", si dhe përcaktimeve të nenit 5, të ligjit nr. 116/2014, "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë" dhe meqënëse kjo kërkesë lidhet me aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore atëherë njësia e prokurimit vendosi që ky raport prove ose raport testimi të jetë I lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të tenderit, duke gjykuar që të mos rriten kostot e pjesmarrjes së operatorëve ekonomik të mundshëm për këtë procedurë prokurimi.

SHËNIM:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 4 dhe 5 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik", të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit), sa shuma e këtyre kriterëve për secilin lot për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Argumentim:

Në nenin 42, të VKM NR. 845, DATË 19.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar përcaktohet se:

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*
- 3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.*
- 4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.*

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme është parë e arsyeshme që në rast se operatorët ekonomik ofertues ofertojnë për më shumë se 1 (një) lot atëherë kapacitetet ekonomike dhe financiale lidhur me xhiron vjetore dhe kapacitetet teknike lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, numrin e punonjësve dhe numrin e mjeteve të transportit duhet ti përmbushin në mënyrë kumulative, dmth sa shuma e loteve në të cilat paraqet ofertë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI IV " "BLERJE FRUTA PERIME PËR KONVIKTET E SHKOLLAVE TË MESME"

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, datw 23.12.2020 "Pwr prokurimin publik", nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës të paraqesë licencën leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkategoria: II.1.A.1. "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", në emër të vetë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve objekt prokurimi për Lotin VI të sipërpërmendura duhet të jenë të rregjistruar në një nga regjistrat profesionalë për zbatimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu në nenin 19 të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar përcaktohet se:

"Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.
3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.
4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.
6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.
7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.
8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.
9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.
10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.
11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është pëcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjinë jo shtazore) sipas objektit të prokurimit, janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet QKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;

c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;

ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;

d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;

dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;

e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;

ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;

f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;

g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi 1

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.

b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.

c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë.”.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë prodhime ushqimore dhe meqënëse objekti i prokurimit për këtë lot është artikulli “Fruta-perime”, i cili është një produkt me origjinë joshtazore dhe është ushqim për njerëzit, duhet që të jenë të pajisur me licensën e nënkategorisë II.1.A.1.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a “Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/a të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit tw mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë

ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin konkret meqënëse edhe ligji nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar nuk lejon që të ushtrohet aktiviteti i prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të fruta -perimeve: pa licensë profesionale atëherë u konkludua me hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

Gjithashtu njësia e prokurimit duke patur parasysh parashikimet e nenit 14 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku parashikohet që operatorët ekonomikë mund të ofertojnë në formën e bashkimit të shoqërive ju referua përcaktimeve të nenit 88, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku parashikohet se:

Neni 88

Bashkimi i operatorëve ekonomikë

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, ku është parashikuar se në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike kërkesat profesionale për kualifikim plotësohen nga secili prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive në raport me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në furnizim, njësia e prokurimit gjykon se meqënëse kriteri i mësipërm është një kriter kualifikimi lidhur me aftësinë profesionale, përcaktoi se në rastin kur ofertuesit paraqesin ofertë në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë atëherë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të jetë i pajisur me Licensën e nënkategorisë II.1.A.1. "Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz".

Lidhur me përcaktimin se: "nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik", njësia e prokurimit është mbështetur në përcaktimet e pikës III "Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim" të Rekomandimit të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr. 10181 prot, datë 19.11.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", ku përcaktohet se: "Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licensën kategoria II.1.A – "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" në emër të tij, pasi licensa duhet ti përkasë operatorit ekonomik të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor. Theksojmë se gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor do të mbajë në konsideratë faktin se nuk lejohet përdorimi i licensës të një operatori tjetër ekonomik."

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratës së xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2021, 2022, 2023) të lëshuar nga organet tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën

në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo më pak se **300 180** (treqind mijë e njeqind e tetëdhjetë) leke.

Sqarim:

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale prej jo më pak se **300 180** (treqind mijë e njeqind e tetëdhjetë) leke, në të paktën një vit të periudhës financiare të cituar më sipër 2021, 2022, 2023.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar–Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", nenit 42, pika 3 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" dhe neni 11, pika 1 "Kufijtë monetarë" (ndryshuar me VKM-në nr. 498, datë 1.8.2024) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

" Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit."

Bazuar ne VKM-në nr. 498, datë 1.8.2024 KREU II KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK përcaktohen

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit ju referua përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021

”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438,datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese dekalohet në organe ttatimire brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në shtator të vitit 2024 dhe tatimpaduesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të dekalrojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e nenit 42 të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se në rastin e procedurave te prokurimit të ndara në lote, si vlerë për hartimin e kriterit ekonomik të xhiros për seilin lot do të merret për bazë vlera e lotit dhe meqënëse vlera e lotit 4 referuar VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” Kreu II “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” pika 2/b Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik (mall) është nën Kufirin e ulët monetar në sektorin klasik (mall) u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 39% e vlerës së fondit limit të lotit 4 dhe konkretisht 300 180 (treqind mijë e njeqind e tetëdhjetë) leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, ku vlera pa TVSH e një ose disa kontratave të jetë **jo më pak se 146 241 (njëqind e dyzetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzetë e një) leke**. Këto përvoja të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga entet publike për përmbushjen me sukses të një ose disa kontratave, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe në rastet kur në këto vërtetime nuk identifikohen sasi të dhe vlera e mallrave të furnizuara, atëherë operatori ekonomik duhet të dorëzojë edhe faturën ose faturat tatimore të shitjes për këto kontrata, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara sipas kontratës për të cilën paraqesin vërtetim.

b. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka përvojën e mëparshme për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar durnizime të ngjashme në fushën e prodhimit, tregëtimit dhe shpërndarjes së ushqimeve për njerëz, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", nenit 42, pika 3 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

" Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.;

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”.

Lidhur me vitet për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar furnizimi/et e ngjashme të mëparshme, nisur nga interpretimi i dispozitës së mësipërme njësisë e prokurimit ka përcaktuar si periudhë kohore 3 (tre) vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit s kurse përcaktohet në nenin 40 pika 4, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Lidhur me përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik njësisë e prokurimit mbështetur në përcaktimet e mësipërme ligjore ka përcaktuar që në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me sektorin publik, përveç vërtetimeve të lëshuara nga entet publike të dorëzohen edhe faturat tatimore të shitjes që u përkasin këtyre vërtetimeve, pasi në disa raste komisioni i vleresimit të ofertave vihet në vështirësi sepse ofertuesit paraqesin vetëm vërtetim realizimi kontrate dhe është e pamundur që të identifikohen sasi, lloji dhe vlera e artikujve të furnizuara, si dhe data e realizimit të furnizimit.

Lidhur me vlerën e furnizimeve të mëparshme të përcaktuar, meqenëse procedura e mësipërme e prokurimit është e ndarë në lote, nisur nga përcaktimet e pikës 3, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit”, pikes 9, të po këtij neni, ku parashikohet: "Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës", si dhe të pikës 4, të nenit 55, të këtij vendimi, ku përcaktohet: “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” dhe konkretisht për lotin 4 jo më pak se 146 241 (njëqind e dyzetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzetë e një) leke. Pra është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera një ambient të përshtatshëm magazinimin dhe tregëtimin e mallrave objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesi dokumentacionin si më poshtë:

- a) Në rastin kur ambjentin e përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave e ka në pronësi duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
 - *Certifikatën e pronësisë*
 - *Leje Higjeno-Sanitare*
- b) Në rastin kur ambjentin e përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave e ka me qera duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
 - Kontratën e qerasë ose huapërdorjes për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës
 - Certifikatën e pronësisë të qeradhënësit
 - *Leje Higjeno-Sanitare*

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

*Në rastin kur ambjenti i përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave është në **pronësi** të operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” numrin e Certifikatës së pronësisë së ambientit ku ushtrohet aktiviteti, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar (Leje Higjeno-Sanitare) për këtë stabiliment, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.*

*Në rastin kur ambjenti i përshtatshëm për magazinimin dhe tregëtimin e mallrave është me **qera** nga ana e operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” numrin e repertorit dhe datën e lidhjes së kontratës së qerasë, numrin e Certifikata e pronësisë së stabilimentit ku ushtrohet aktivitetin qeramarrësi dhe të marrë me qera, numrin dhe datën e Akt Miratimit Higjeno-sanitar (Leje Higjeno-Sanitare) për këtë stabiliment të marrë me qera, të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë një stabiliment të përshtatshëm për realizimin e objektit të prokurimit lidhur me prodhimin, tregëtimin dhe shpërndarjen e ushqimeve për njerëz dhe konkretisht të mallrave objekt prokurimi të këtij loti, prandaj u vendos që të hartohet dhe përcaktohet kjo kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” dhe objekti i prokurimit është blerja e produkteve ushqimore fruta dhe perime për njerëz ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 19 ” Aplikimi, miratimi dhe regjistrimi”, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin” i ndryshuar përcaktohet se::

”1. Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

3. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e ministrisë përgjegjës për ushqimin.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi.

6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.

8. Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që, për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i dërgon institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë listën e operatorëve të biznesit ushqimor të regjistruar në regjistrin e saj.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund t'i çregjistrojë stabilimentet, me kërkesën e operatorëve të biznesit ushqimor ose me propozimin e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, kur kjo konstaton se ato nuk plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij ligji. Për çregjistrimin e stabilimentit njoftohen me shkrim operatori i biznesit dhe drejtoritë rajonale të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

11. Përmbajtja, forma dhe mënyra e regjistrimit në regjistër dhe procedura e dhënies së një numri regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

12. Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Procedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e ruajtjes përpunimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore (me origjinë shtazore ose origjine jo shtazore) sipas objektit të prokurimit dhe në rastin konkret të ofertimit për artikuj ushqimorë fruta-perime janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës dhe ku deklarojnë se stabilimenti në të cilin ushtrojnë veprimtarinë të jetë i rregjistruar dhe i licensuar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomikë ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga

apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar ku, në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

” Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet QKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

- a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;
- b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;
- c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;
- ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;
- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi 1

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Propozuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me aktin nr.1771, prot. datë 8.5.2009 dërguar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Baza ligjore e posaçme sektoriale:

a) Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

- a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;*
- b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;*
- c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.*

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) *“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”*, me kodin II.1.A.1.

b) *“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”*, me kodin II.1.A.2.

c) *“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”*, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë.”.

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë prodhime ushqimore dhe meqënëse objekti i prokurimit për këtë lot janë ushqime fruta dhe perime, të cilat janë produkte me origjinë joshtazore dhe është ushqim për njerëzit, duhet që të jenë të pajisur me licensën e kategorisë II.1.A.1.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/ç ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit *“Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”*, Pika.III/d *“Hartimi i kriterëve të veçanta ëpe kualifikim”* është rekomanduar që:

“d. Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose në përdorim ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara, për te gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet e kërkuara duhet të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe tekniko-teknologjike.”.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t’u vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe paisjet përfshihet dhe ambienti i përshtatshëm për ruajtjen, shërndarjen dhe tregtimin e artikujve ushqimorë për njëzë dhe në rastin konkret meqënëse objekt prokurimi është furnizimi me artikuj ushqimorw fruta dhe perime dhe në këtë rast operatorët ekonomikë janë tregtues të këtyre artikujve duhet të disponojnë ambientin e përshtatshëm për ruajtjen, shpërndarjen dhe tregtimin e këtyre artikujve kjo e lidhur edhe me përcaktimin e pikës III/d të Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit ”mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të furrës ose linjës së prodhimit të bukës, por pa përcaktuar se si disponohen këto ambiente, ju referuam nenit 801 e vijues, nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 ”Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 142

Sendet janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Neni 801

Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Neni 901

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 902

Kontrata e huapërdorjes quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

Pra në rastin konkret meqënëse nga shqyrtimi i "KARTELËS INFORMATIVE" me kodin AL022016 të publikuar në faqen e ADISA konstatohet se pjesë përbërëse e dokumentacionit për pajisjen me licensën e kategorisë II.1.A.1 "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" duhet që të dorëzojë dhe planimetrinë e ambientit ku ushtron aktivitetin dhe në rastin konkret bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme dhe konkretisht ndërtesë, pasuri e paluajtshme.

Në Udhëzim e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar" pika 3 përcaktohet se:

"3. Të gjithë objektet, në të cilët, Inspektorati Sanitar Shtetëror, pasi bën e ekspertimin paraprak, jep Aktmiratim higjieno-sanitare, merr masa në mbrojtje të shëndeti publik, apo ushtron kontroll për gjendjen shëndetësore të punëmarrësve, si:

c) vënie në shfrytëzim të objekteve:

- të prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve të ndryshme (që përcakton ligji nr. 7643, datë 02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjera që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror) dhe në të gjitha kategorite e pubimeve, përfshirë dhe ato minerare;

4) Fushat e inspektimit

Për mbrojtjen e shëndetit publik dhe promovimin e shëndetit, Inspektorati Sanitar Shtetëror monitoron dhe kontrollon:

ç) Zbatimin e rregullave higjieno-sanitare në objektet ku prodhohen, ruhen, tregtohen, transportohen, përdoren, apo konsumohen produkte të ndryshëm (që lejon ligji nr.7643, dt.02.12.1992, i ndryshuar dhe ligje të tjera që ngarkojnë me përgjegjësi Inspektoriatin Sanitar Shtetëror, ligji nr.9108, dt.17.07.2003 "Për sufistancat dhe preparatet kimike", i ndryshuar, ligji nr.10216, datë '21.01.2010 "Për detergjentet", etj), kontrollon respektimin e normave higjienike të standardeve shtetërore dhe kushteve teknike të këtyre produkteve dhe artikujve të tjerë;"

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme të Kodit Civil format e me të cilat mund ti vihet në dispozicion stabilimenti i përshtatshëm për ruajtjen, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve objekt prokurim është pronësia, qiramarrja, huapërdorja, pra në këtë rast operatorët ekonomikë që disponojnë një nga format e mësipërme të disponimit duhet të paraqesin dhe dokumentacionin vërtetues që në rastin e pronësisë është vërtetimi nga rregjistri përkatës, të cilin e ka detyrim ligjor dhe që është Certifikata e Pronësisë së stabilimentit, ndërsa në rastin e qeramarrjes ose huapërdorjes është kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës që prokurohet ose kontrata përkatëse e huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e zbtimit të kontratës që prokurohet, por me kushtin që licensa me kodin II.1.A.1 "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" të jetë në emër të pronarit në rastin kur është pronar i stabilimentit, ndërsa në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, si dhe aktin e miratimit higjieno-sanitar në emër pronarit në rastin kur është pronar i stabilimentit dhe në emër të qeramarrësit ose të huamarrësit në rastet kur e disponon stabilimentin me kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje, me qëllim që të sigurojë autoritetin kontraktor që disponon dhe ushtron aktivitetin në përputhje me parashikimet e nenit 19 "Aplikimi, miratimi dhe

regjistrimi”, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 ”Për ushqimin”, i ndryshuar, VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 ”Për inspektimin higjeno sanitar në funksion të akt miratimit higjeno sanitar”.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë Certifikatë ISO 22000-2018 ose ekuivalentin sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 79, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të

lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Për më tepër në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/c “Hartimi i kritereve të veçanta ëpe kualifikim” është rekomanduar që: “c. Operatori ekonomik të jete i pajisur me Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.”.

Nisur nga sa parashtruam më sipër kjo kërkesë është e parashikuar në nenin 77 dhe pika 1 të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik”, në të cilin parashikohet se parashikimet për kërkesat e cilësisë i referohen dhe kualifikimeve të ofertuesit. Në rastin konkret nisur nga fakti që procedura e prokurimit është e llojit mallra ju referuam dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nga ku konstatoam se në pikën 8 të kësaj dispozite është parashikuar që autoritetet kontraktore në rastin e kësaj procedure prokurimi mund të përcaktojë dhe kritere të tjera për kualifikim dhe që në rastin konkret referuar Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik përcaktoi që ofertuesit të disponojnë certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018 ose ekuivalente pasi kjo certifikate siguron autoritetin kontraktor se ofertuesit i respekton sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore, pra kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” është përcaktuar që kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organizëm i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, ku në rastin konkret organizëm kombëtar i akreditimit referuar përcaktimeve të ligjit nr.116, datë 11.09.2014 ”Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” është Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit.

Për më tepër nisur nga përcaktimet e mësipërme u përcaktua që në rastin kur ofertuesit paraqesin oferte në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë u vlerësua si e nevojshme që në këtë rast secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë ISO 22000:2018, pasi kjo është një kërkesë që e parashikon legjislacioni në rastin e kualifikimeve që i referohet kualifikimeve të ofertuesit, si dhe është e lidhur ngushtë dhe në proporcion me objektin e prokurimit, pasi ka lidhje me sigurinë ushqimore, pasi edhe njëri nga anëtarët e bashkimit të shoqërive që merr përsimër të furnizojë me me disa nga ushqimet objekt ushqimor duhet të jetë dhe vetë i certifikuar me ISO 22000:2018.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti ATP të përshtatshëm për transportin e fruta- perimeve.

- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës është pronar i mjetit duhet të paraqesë dokumentacioni si në vijim: leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjeti është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik dhe leje higjeno-sanitare të mjetit.
- Në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës ka marrë me qera mjetin duhet të paraqesë dokumentacioni si në vijim: kontratën noteriale të qerasë, leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia në rast se mjeti është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, certifikatë e kontrollit teknik, leje higjeno-sanitare të mjetit.

(dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi)

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 “FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të plotësuar.

Në rastin kur mjeti i transportit është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjeti i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisë së siguracionit të mjetit të transportit, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisë së saj në rast se mjeti është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e certifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Në rastin kur mjeti i transportit është marrë me qera nga operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”,

pika: “B: DEKLARATË” të Shtojcës 8 ”Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit; numrin e repertorit të kontratës së qerasë dhe datën hartimit të kësaj kontrate, targën dhe kapacitetin mbajtës të mjetit të transportit sipas lejes së qarkullimit, numrin e lejes së qarkullimit, vitin për të cilin ka paguar taksën e vjetore të mjetit të transportit (në rastin kur mjete i transportit është i përdorur), periudhën e vlefshmërisës së siguracionit të mjetit të transportit në rast se mjete është me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, numrin e lejes së transportit dhe periudhën e vlefshmërisës së saj, numrin e ertifikatës së kontrollit teknik të mjetit dhe datën e lëshimit të saj, numrin dhe datën e lëshimit të lejes higjeno-sanitare të mjetit, numrin dhe datën e lëshimit të policës së sigurimit për mjetin.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqenëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohej se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë burimin e nevojshëm teknik dhe konkretisht një automjet të përshtatshëm për realizimin e

kontratës, pasi nga ana jonë duke patur parasysh se natyrën e furnizimit e cila bëhet cdo mëngjes dhe ku furnizohen 5 konvikte nga të cilat 4 ndodhen brenda unazës së vogël të qytetit të Tiranës dhe 1 konvikt ndodhet në Kamëz vlerësuar që 1 automjet për shpërndarjen e fruta perimeve është mëse i mjaftueshëm.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/ç "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

" mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit".

Gjithashtu në Rekomandimin Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore", Pika.III/e "Hartimi i kriterëve të veçanta ëpe kualifikim" është rekomanduar që: "e. Operatori të ketë në pronësi ose në përdorim automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportin e mallrave, automjet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportin e mallrave në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe që plotësojnë kushtet higjienore sanitare."

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t'u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe pajisjet përfshihet dhe automjeti i nevojshëm për kryerjen e furnizimit i cili referuar edhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit duhet të jetë i llojit ATP (jo frigoriferik).

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit "mallra" duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetit për transportin e bukës, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 81

Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të tretëve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.

Neni 83

Dhënia me qira pa drejtues mjeti

1. Për zbatimin e këtij neni, një mjet quhet i caktuar për dhënie me qira pa drejtues mjeti kur qiradhënësi, kundrejt pagesës, detyrohet të verë në dispozicion të qiramarrësit, me kërkesën e këtij të fundit, vetë mjetin.
2. Mund të caktohen për dhënie me qira të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, përfshirë edhe mjetet e caktuara për transportin e mallrave, me ngarkesë të plotë, e cila është mbi 1,5 ton, si dhe mjetet, të ndryshme nga autoveturat, të caktuara për transportin e njerëzve.

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete me motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:
 - a) lejeqarkullimin;
 - b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
 - c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
 - ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
 - d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Referuar dispozitave të mësipërme përcaktuam se mjetet mund të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues ose me kontratë qeraje, ku në rastin e pronësisë mbi mjetin të paraqitet, leja e qarkullimit të mjetit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, ndërsa në rastet kur automjeti është me qera të paraqitet kontrata e qerave dhe dokumentacioni i mjetit në emër të qeradhënësit si ne vijim: leja e qarkullimit të mjetit në emër të qeradhënësit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në

momentin e ofertës në emër të qeradhënësit, cetifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit.

Nisur nga fakti që automjeti i përcaktuar në këtë kriter do të bëjë transport mallrash dhe në rastin konkret të artikullit “bukë” dhe meqënëse ka rregullim të vecantë ligjor lidhur me transportin e mallrave dhe për të shmangur ndonjë situatë të bllokimit të mjetit nga ana e policisë për shkak të mungesës së dokumentacionit, cka do të illte dhe vonesa në furnizimin me artikullin e sipërpërmendur objekt prokurimi ju referuam nenit 46 të ligjit nr, 8380, datë 18.3.1998 :Për transportet rrugore” i ndryshuar, ku percaktohet se:

Neni 1

a) Ky ligj do të zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

b) Ky ligj do të zbatohet, gjithashtu, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të mallrave për të tretë, me qira ose për nevojat e veta brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

c) Transporti rrugor i mallrave për të tretë dhe me qira ose për nevojat e veta përshin ngarkimin, shkarkimin dhe lëvizjen bosh dhe plot të mjetit.

KREU III.1

TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PËR TË TRETË

Neni 41

Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

KREU III.2

TRANSPORTI I MALLRAVE PËR VETE

Neni 45

Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë.

Neni 46

(ndryshuar ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.

Neni 47

Llojet e mallrave për transport brenda vendit për nevojat e veta që nuk kanë nevojë për certifikatë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.

Pra nisur nga përcaktimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë dhe certifikaten ose lejen e transporti të vlefshme në momentin e ofertës, por për automjetet me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton nuk kërkohet që të paraqitet certifikata ose leja e transportit, pasi mjetet me këtë kapacitet mbajtës nuk pajisen me leje apo certifikatë transporti.

Nisur nga natyra e mallrave që do të transportohen të cilat janë produkte ushqimore lidhur ju referuam Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 510, datë 23.12.2011 "Për inspektimin higjieno sanitar në funksion të akt miratimit higjieno sanitar" përcaktohet se:

"Mjetet e transportit

Në se subjekti disponon dhe përdor mjete për transportin e produkteve të ndryshme, përdorimi i të cilëve ka, apo mund të ketë ndikime në shëndetin publik, mjetet e transportit duhet të përmbushin kërkesat higjieno-sanitare dhe sipas destinacionit të tyre,

- të jenë të ndërtuara me materiale veshëse të tillë që të mos ndikojnë (dhe ndikohen) negativisht ndaj produkteve që transportohen dhe ndaj pastrimit/larjes;

- të jenë të mbyllur/mbuluar, përfshi edhe hemeticitetin e derës/dyerve, për të siguruar mbrojtjen e produkteve që transportohen nga plihurat, rrezet e diellit, shiu dhe nga agjentët atmosferikë dhe mjedisorë në përgjithësi;

- të kenë paisje ftohëse (autofrigorifer) për produktet që kërkojnë domosdoshmërisht transport në temperatura të caktuara;

- të kenë paisje të duhura (barëse, mbërthyes, arka, etj) për vendosjen dhe mbajtjen e produkteve që transportohen;

Mjetet e transportit duhet të përdoren për destinacione të caktuara, duke mos kryer shërbime dhe mostransportuar njëkohësisht produkte me veçori të ndryshme (njerëz dhe mallra në përgjithësi, produkte joushqimore dhe ushqimore, produkte të ambalazuara dhe të paambalazuara, etj).

Autobotët për transport lëngjesh, të jenë të ndërtuar/veshur me materiale të tillë që për karakteristikat e lëngjeve që mbarten, të mos ndikojnë në përbërjen e tyre.

Pas përfundimit të ransporteve dhe pas punës në përgjithësi, mjetet e transportit pastrohen, dhe sipas destinacionit të tyre, mekanikisht (me fshesë, furca, mjete fërkuese, etj) apo me tretësira pastruese (si psh tretësirë sode 0.5 – 1 -2 %, ujë i nxehtë 60-70 °C, me avull uji, etj) thjesht apo me presion, pasuar me shpëlarje përfundimtare me ujë të pastër.

Mjetet e transportit sa më sipër pajisen me Aktmiratim Higjieno-Sanitar."

Pra nisur nga parashikimet e mësipërme është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues për automjetin në pronësi apo me qira duhet të paraqesë Aktin e Miratimit-Higjieno-Sanitar të vlefshëm të automjetit.

2.3.5. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të disponojë në stafin e tij, si me poshtë:

- 1 (një) shofer
- 1 (një) punëtor
- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune e vlefshme, leja drejtimi të automjetit me kategorinë përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetin në emër të punonjësit.
- Për punonjësit e punësuar punëtores të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune e vlefshme

Shënim:

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Shtojcës 8 "FORMULAR PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT" pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Sqarim:

Në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë vetëm Shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës i Vetëdeklarimit" të plotësuar.

Për të dëshmuar se disponon në stafin e tij 1 (një) shofer operatori ekonomik ofertues, atëherë ky i fundit duhet të deklarojë në Seksionin: "Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit", pika: "B: DEKLARATË" të Shtojcës 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" datën e kontratës së punës, emrin e punëmarrësit dhe numrin e lejes së drejtimit të automjetit të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar në vend të parë dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura në këtë kriter kualifikues.

Sqarim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës që prokurohet me anë të së cilës dëshmon se ka në stafin e tij 1 (një) punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatëse sipas peshës mbajtëse të automjetit që do deklarojë se disponon me qëllim që të dëshmojë se mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve fruta-perime , brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e mallrave (produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret duhet të kenë dhe punonjës të punësuar për realizimin e kontratës.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/c "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose".

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Lidhur me numrin e punonjësve që duhet të disponojnë operatori ekonomik, meqënëse kjo dispozitë nuk përcakton numrin e punonjësve, por thjesht faktin që duhet kërkuar fuqi punonjëse në raport me objektin e kontratës që prokurohet, njësia e prokurimit nisur nga objekti i kontratës e cila ka si qëllim furnizimin me ushqimeve të 5 konvikteve në administrim të Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, gjykohet se është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar 2 (dy) punonjës nga të cilët 1 (një) punonjës duhet të kryejë punën e shoferit me qëllim që të bëjë transportin me mjet të ushqimeve nga vendi ku magazinohen në adresat e pesë konvikteve, si dhe 1 (nje) punonjës për ngarkimin dhe shkarkimin e mallit objekt prokurimi, te domosdoshem per kryerjen e ngarkimit dhe shkarkimit te mallit.

Lidhur me dokumentacion vërtetues përsa i përket disponimit të dy personave të punësuar, njësia e prokurimit, ju referuar parashikimeve ligjore si më poshtë:

Së pari, në Kreut V, neni 11, pika 1/e, neni 12 dhe neni 21, pika 1, të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet si më poshtë:

KREU IV

Neni 11

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
- c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore
- d) Kontrata kolektive e punës
- e) Kontrata individuale e punës
- f) Rregullorja e brendshme
- g) Zakonet lokale dhe profesionale.

Neni 12

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.

Neni 21

- 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.

Së dyti, në nenin 14, të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë:

Neni 14

Operatorët ekonomikë

- 1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Së treti, në nenin 115 dhe nenin 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë:

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:

a) lejeqarkullimin;

b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;

c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;

ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;

d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Neni 115

Kategoritë e lejedrejtitimit për drejtimin e motomjeteve dhe automjeteve

1. Ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod.2. Përgatitja e kandidatit për lejedrejtimi bëhet në autoshkolla dhe provimet e ftësisë për ejedrejtimi duhet të bëhen pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pasi të plotësohen kushtet e caktuara fizike e mendore. Ministria përgjegjëse për transportin përcakton procedurën për lëshimin, përditësimin dhe dhënien e dublikatës, përmes një sistemi informatik, të lejedrejtitimit, si dhe certifikatave të kualifikimeve profesionale, duke pasur si qëllim thjeshtimin e procedurave administrative. Kandidati për drejtues mjeti mund të regjistrohet dhe të kryejë kursin e teorisë e të praktikës në çdo drejtori rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pavarësisht nga regjistrimi në gjendjen civile.

3. Lejedrejtimi, sipas modelit të Bashkimit Europian, siç përcaktohet me vendim të Këshillit Ministrave, ndahet sipas kategorive dhe aftësive në drejtimin e mjeteve, të përcaktuara për secilën nga kategoritë e mëposhtme:

Kategoria AM:

a) ciklomotorë me dy rrota, kategoria L1, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h, fuqia cilindrike e të cilit është më e vogël apo e barabartë me 50 cm³, nëse është me djegie të brendshme, apo fuqia maksimale e vazhdueshme është më e vogël apo e barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

b) mjete me ose pa kosh dhe mjete me tri rrota, kategoria L2, me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h dhe me motor me fuqi cilindrike më të ulët apo të barabartë me 50 cm³, nëse ky është me ndezje të komanduar, apo kur fuqia e tij maksimale neto është më e ulët ose e barabartë me 4 kË, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose për ata që fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

c) mjete me katër rrota të lehta, kategoria L6, masa bosh e të cilave është më e ulët ose e barabartë me 350 kg, duke përjashtuar masën e baterive për automjetet elektrike me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/h dhe jo më shumë se 45 km/h, me fuqi cilindrike të motorit më të ulët ose të barabartë me 50 cm³, për motorët me ndezje të komanduar, ose ata të cilët fuqinë maksimale neto e kanë më të ulët apo të barabartë me 4 kË, për motorët e tjerë me djegie të brendshme; ose ata të cilët fuqinë maksimale të vazhdueshme e kanë më të vogël apo të barabartë me 4 kË, për motorët elektrikë;

Kategoria A1:

a) motomjet me cilindrata jo më shumë 125 centimetër kub dhe me fuqi jo më shumë se 11 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,1 kË/kg;

b) tricikël me një fuqi jo më të madhe se 15 kË;

Kategoria A2: motomjet me fuqi jo më shumë se 35 kË dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,2 kË/kg, që nuk rrjedh nga një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij;

Kategoria A: motomjet me fuqi më shumë se 15 kË;

Kategoria B1: motomjet me katër rrota, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të kategorisë AM, masa pa ngarkesë e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 400 kg ose 550 kg për mjetet e destinuar për transport mallrash (kategoria L7), përjashtuar masën e baterive për automjetet elektrike, të cilat fuqinë maksimale neto të motorit e kanë më të ulët ose të barabartë me 15 kË. Këto mjete konsiderohen si mjete me tri rrota dhe janë në përputhje me rregullat e aplikueshme për mjetet e kategorisë L5;

Kategoria B: mjet motorik me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3 500 kg dhe jo më shumë se 8 ndenjëse, përjashtuar ndenjësen e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg, duke u siguruar që masa maksimale e autorizuar e këtij kombinimi të mos kalojë 4 250 kg. Në rast se kombinimi i kalon 3 500 kg, drejtuesi duhet t'i nënshtrohet një trajnimit dhe provimit të posaçëm;

Kategoria BE: kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios nuk i kalon 3 500 kg;

Kategoria C1: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg, por jo më shumë se 7 500 kg ose i projektuar dhe i konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria C1E: kombinimi i një mjeti motorik të kategorisë C1 dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg, por masa maksimale e autorizuar e kompleksit të formuar nuk i kalon 12 000 kg;

Kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje apo gjysmërimorkioje, masa e autorizuar e të cilave i kalon 3 500 kg, me kusht që, në masë, kombinimi i autorizuar të mos i kalojë 12 000 kg;

Kategoria C: mjet motorik i ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilit i kalon 3 500 kg ose i projektuar dhe konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;

Kategoria CE: kombinimi i një mjeti të kategorisë C me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg;

Kategoria D1: mjet motorik i projektuar dhe konstruktuar për jo më shumë se 16 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit, dhe me gjatësi maksimale që nuk i kalon 8 m. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D1E: kombinim i një mjeti të kategorisë D1 me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750kg;

Kategoria D: mjet motorik i projektuar dhe i konstruktuar për më shumë se 8 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;

Kategoria D

E: kombinimi i një mjeti të kategorisë D me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme ligjore njësia e prokurimit vendosi që dokumentacioni vërtetues lidhur me punësimin e dy punonjësve në stafin e operatorëve ekonomik ofertues vendosi që të përcaktojë kontratën e punës sipas formës së parashikuar në pikën 1, të nenit 21 të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurim e cila është përcaktuar si një vit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit,

Ndërsa lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzojë operatori ekonomik ofertues për të vërtetuar se ka të punësuar një punonjës që kryen detyrën e shoferit, i cili duhet të jetë i pajisur me lejedrejtimi mjeti ju referuam nenit 115 dhe nenit 178, pika 1/b, të Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. ku meqënëse nuk kemi parashikuar kapacitetin mbajtës të mjetit të përshtatshëm për transportin e mallrave objekt prokurimi, por e kemi lënë në mundësinë që ka për disponimin e një mjeti të tillë me kapacitet mbajtës të caktuar vetë operatori ekonomik ofertues, atëherë kemi përcaktuar se shoferi duhet të paraqesë lejen e drejtimit të këtij mjeti, ku kjo lejedrejtimi duhet të jetë sipas kategorisë që i përket mjeti që disponon sipas kriterit të përcaktuar në Pikën 2.3.4 të “Kapacitetit teknik” të Shtojcës 7 të dokuemntave të tenderit.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

ARGUMENTIMI: Nisur nga fakti që respektimi i kërkesave të sigurisë ushqimore për furnizimin me ushqime për konviktet ku jetojnë fëmijë është shumë i rëndësishëm, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik””Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për

ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe Rekomandimit Nr.10181, datë 19.11.2018 dhe Nr.8541, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit kombëtar të Ushqimit “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, Pika.III/g është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë në fazën e ofertimit këtë deklaratë dhe në rast se shpallet fitues të paraqesë përpara lidhjes së kontratës vërtetimin e lëshuar nga AKU-ja.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohej që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur një deklaratë.

SHËNIM:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 4 dhe 5 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit), sa shuma e këtyre kriterëve për secilin lot për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Argumentim:

Në nenin 42, të VKM NR. 845, DATË 19.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.
3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.
4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.
6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.
7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.
8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.
9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme është parë e arsyeshme që në rast se operatorët ekonomik ofertues ofertojnë për më shumë se 1 (një) lot atëherë kapacitetet ekonomike dhe financiale lidhur me xhiron vjetore dhe kapacitetet teknike lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, numrin e punonjësve dhe numrin e mjeteve të transportit duhet ti përmbushin në mënyrë kumulative, dmth sa shuma e loteve në të cilat paraqet ofertë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me përcaktuar në nenin 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, standartet e miratuara nga Drejtoria e përgjithshme e Standartizimit, Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së nr. 10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, si dhe Udhëzimit i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, si me poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. BUKË

BUKË GRURI ME RREZE 75 %

Bazuar në SSH 1411:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- Bukë me miell gruri me rreze 75 %

Karakteristikat cilësore:

Treguesit organo-leptikë:

- *Korja:* E lëmuar, pa flluska, pa çarje e pjesë të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tuli. Me ngjyrë të njëllotë mjalti në të kuqerremtë.
- *Tuli:* Masa e njëllotë e pjekur mirë, jo e ngjitshme, me pore të shpërndara në mënyrë të njëllotë, dhe pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistenca elastike, me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa.
- *Era dhe shija:* E këndshme e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë myku ose të huaj. Nuk lejohet kërcitje.
- *Forma:* E rregullt, pa shtypje e deformime.

- *Lëndët e huaja*: Nuk lejohen.

Treguesit fiziko-kimik:

- *Lagështira në tul*, % jo më shumë se 45.
- *Poroziteti në %* jo më pak se 70.
- *Aciditetinë gradë* jo më shumë se 4.5
- *Kripa në %* jo më shumë se 2.
- Peshë e bukës për një cope 1000 gr

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes. Lejohen mënjanimet nga masa e caktuar $\pm 3\%$, për çdo bukë.

Ambalazhimi dhe marketimi: Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Çdo bukë të futet në qese letre me masën e përcaktuar sipas AK, këto të futura në kuti kartoni, druri ose plastike që të jenë të pastra dhe të mos lejojnë shtypjen e bukës, si dhe të jetë i shoqëruar me etiketë.

Ruajtja dhe transportimi: Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Buka e pjekur ruhet në mjedise të pastra, të ajrosura, e pa lagështirë, dhe të dizinfektuara nga dëmtuesit e ndryshëm. Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 48 orë.

Prerja e bukës bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

1.ÇAJ MALI**Bazuar në SSH 966:1988 ose ekuivalentin e tij****Kërkesat cilësore****Treguesit shqisorë:**

- *Pamja*: Të jetë bar i thatë kërcelli me gjethe e lule të vegjetacionit të vitit në vazhdim me gjatësi 20-30 cm. Të jetë pa farë, pa rrënjë dhe jo i drunjëzuar. Aroma specifike e vet bimës e këndshme.
- *Ngjyra*: Fletët dhe kërcelli të gjelbër në bojë hiri, lulja e verdhë në krem.. Nuk lejohen të nxira të mykura, të kalbura dhe papastërti të ndryshme. Nuk pranohet çaj me bustina. I ambalazhuar në pako ose me tufa.

Treguesit fiziko –kimik:

- *Lagështia* jo më shumë se 12 %.
- *Bar me ngjyrë jo normale* jo më shumë se 5 %.
- *Lëndë organike të vetë bimës dhe bimëve të tjera jo helmuese*, jo më shumë se 2 %.
- *Lëndë minerale* jo më shumë se 1 %.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi.

Sipas SSH 2500:1988: “Bimë mjekësorë, eterovajorë dhe tanifere. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi.” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Çaji ambalazhohet në ambalazhimplastik ose letreme vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjenike.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Operatori ekonomik nga çdo prodhim ose grumbullim të caktuar nga i cili bën furnizimin në AK, të ketë certifikatë fitosanitare.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë certifikatën fitosanitare të produktit.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

2. FASULE TË THATA

Bazuar në SSH 1723:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- **E bardhë**

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale , e rrumbullakët, e gjatë etj).
- *Ngjyra:* e bardhë.
- *Era dhe shija:* Pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë:

- *Lagështia, %, 15.*
- *Lëndë të huaja, %, jo më shumë se 0.8.*
- *Kokrra fasulesh të thyera, %, jo më shumë se 13.*
- *Përzierje kokrrash, %, jo më shumë se 2.2.*
- *Dëmtime mekanike, kokrra të verdha të pazhvilluara e të rrudhura, dëmtime nga insektet nuk lejohen.*

Në fasulet e bardha të thata lejohen deri në 2% fasule të thata larushka.

Ambalazhimi dhe marketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Ambalazhimi realizohet në qese polietileni ose me thasë me masë sipas kërkesës së AK. Thasët të jenë të pastër e të thatë, të dezinfektuar dhe pa erë të huaj. Në thasë të pastër, 1 - 50 kg neto me elementë marketimi.

Mbi çdo ambalazh shënohet:

- Emri i ndërmarrjes tregtare/prodhuesit
- Emërtimi i mallit,
- Data e prodhimit,
- Masa neto,
- Data skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Fasulet e thata ruhen në depo pa lagështirë të dezinfektuara dhe jo me produktet që kanë erë të huaj. Në depot thasët vendosen stivë njëri me tjetrin mbi zgara druri të ngritura nga sipërfaqja e tokës 10-15 cm. Stivat ndahen nga njëra tjetra me largësi 50-60 cm dhe larg mureve 50-60 cm.

Transportimi bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktoret atmosferike, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë çertifikatën fitosanitare të produktit.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

3. SODË BUKE

Bazuar ne SSH 1308:1993 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Ngjyra:* E bardhë.
- *Era dhe shija:* Me shije të kripur pa erë.
- *Konsistenca:* Pluhur kristalin.
- *Tretshmëria në ujë:* Tretet plotësisht në 12 pjesë ujë, ka reaksion alkaline.

Treguesit fiziko- kimik:

- *Bikarbonat natriumi, %*, jo më pak se 99,5.
- *pH (5 %, 20°C):* 8.0

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Soda e bukës të ambalazhohet në qese polietileni me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- **Emërtimi i prodhuesit,**
- **Emri i produktit,**
- **Pesha neto,**
- **Data e prodhimit,**
- **Data e skadimit,**
- **Kushtet e vecanta të ruajtjes.**

Ruajtja dhe transportimi

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjenike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Personi që merr në dorëzim produktin duhet të jetë me arsimin “Mercolog” dhe përpara se të marrë në dorëzim produktin duhet të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

4.SHEQER

Bazuar në SSH 1413:1987 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore:

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja dhe copa sheqeri të ngjeshura, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
- *Ngjyra :* e bardhë dhe me shkëlqim.
- *Shija dhe era:* Shije e ëmbël , pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.
- *Tretshmëria :* Të tretet plotësisht në ujë , tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit fiziko – kimikë:

- *Sheqer i pastër i llogaritur me lëndë absolutisht të thatë* jo më pak se 99,6%.
- *Lëndë reduktuese (sheqer invert) ,%*, jo më shumë se 0,1.
- *Lagështia ,%*, jo më shumë se 0,16.
- *Hiri ,%*, jo më shumë se 0,07.
- *Përzierje hekuri me madhësi deri 0.3 mm, mg/l kg*, jo më shumë se 3.
- *Ngjyra sipas njësive shtimore (llogaritur në lëndë absolutisht të thatë) ,%*, jo më shumë se 1.

Ambalazhimi, paketimi dhe markimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Sheqeri ambalazhohet në qese letre ose në thasë me masë sipas kërkesave të AK-së. Ambalazhimi: Prej letre me peshë 1 kg të mbyllur hermetikisht.

Mbi çdo pako shënohet:

- Emri i ndërmarrjes tregtare/prodhuesit,
- Emërtimi i mallit,
- Data e prodhimit,
- Masa neto,
- Data skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Sheqeri ruhet në depo të pastra dhe pa lagështirë. Në depo, reshti i parë i thasëve të sheqerit vendoset detyrimisht mbi dërrasa, në lartësi 10 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë.

Transportimi bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktoret atmosferike, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Mjetet duhet të jenë të pastra dhe pa erë të huaj që mund të merret lehtë nga sheqeri. Nuk lejohet që në të njëjtin automjet të transportohen edhe artikuj të tjerë që mund të dëmtojnë sheqerin.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Personi që merr në dorëzim produktin duhet të jetë me arsimin “Mercolog” dhe përpara se të marrë në dorëzim produktin duhet të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

5. KRIPE E JODIZUAR

Bazuar në SSH 1437: 2005 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore

Treguesit cilësorë:

- Ngjyra: E bardhë.
- Era dhe shija: E kripur pa shije dhe erë të huaj.
- Pamja e jashtme: Masë kokrrizore.

Treguesit fiziko kimik:

- Imtësia në mm, në kufijtë: 0.2 – 2.
- Klorur Na në lëndën e thatë në %, në kufijtë: 99 ± 0.02 .
- Klorur Mg në lëndën e thatë në %, max: 0.23.
- Sulfat Mg në lëndën e thatë në %, max: 0.25.
- Sulfat Ca në lëndën e thatë në %, max 0.30.
- Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, në kufijtë 0.17 ± 0.02 .
- Lagështirë në %, max: 1.
- Jodi në mg/kg kripë: 40 ± 0.3 .

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjeno- shëndetësore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Kripa e jodizuar

ambalazhohet në qese polietilene ushqimore me masë sipas kërkesave të AK-së. Kjo kripë mund të ambalazhohet edhe në shishe plastike prej PTT. Të bëhet në qese të paster ose polietilene ushqimore, pesha 0.5 deri 1 kg.

Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shenohen të dhënat e mëposhtme.

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Lloji,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Kripa e jodizuar ruhet në depo të pastra, të ajrosura mirë dhe të errëta, në kushte normale të temperaturës dhe lagështisë.

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike. Nuk lejohet transporti i kripës ushqimore me mjete që kanë sado pak mbetje të lëndëve kimike, papastërti dhe çdo mbetje tjetër të dëmshme për organizmin e njeriut dhe që i japin kripës aromë, shije e erë të huaj.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Personi që merr në dorëzim produktin duhet të jetë me arsimin “Mercolog” dhe përpara se të marrë në dorëzim produktin duhet të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analizë nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

6. LIMONTOZI

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja*: Pluhur me kristale pa copa limontozi të ngjeshura, mase të derdhur dhe të thate.
- *Ngjyra*: E bardhë me shkëlqim.
- *Aroma*: Pa aromë.

Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Limontozi ambalazhohet në ambalazhim plastik me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transportimi

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Personi që merr në dorëzim produktin duhet të jetë me arsimin “Mercolog” dhe përpara se të marrë në dorëzim produktin duhet të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

7.MAKARONAT

Bazuar në SSH 1170:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- *Sipas përbërjes:* Të thjeshta, të prodhuara nga brumi i përgatitur vetëm me miell gruri.
- *Sipas formës:*
 - o Fidhe e spageti, me ose pa vrima në mes, me gjatësi 30 deri 60 cm dhe trashësi deri 2,4 mm, në varësi të llojit të makaronave.
 - o Spirale (Fusili)
 - o Në formë figurash, etj, me trashësi deri 3 mm, gjatësi jo më shumë 6 mm.
 - o Peta, sharrë.

Kërkesat cilësore:

Treguesit Shqisorë:

- *Pamja:* Të jenë me formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpra, lejohen përkuljet, shtrembërim e plasaritje të vogla. Mbas zierjes të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen e të mos krijojnë shkume.
- *Ngjyra:* E bardhë me nuancë të verdhë. Në thyerje paraqiten gëlqerore në jo më shumë se gjysmën e sipërfaqes së seksionit.

- *Era dhe shija:* E mire karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit Fiziko – Kimik:

- *Lagështia* jo më shumë se 13%.
- *Aciditeti si acid sulfurik*, në %, jo më shumë se 0.16%.
- *Rritja e vëllimit pas zierjes* jo më pak se 2 herë.
- *Insekte e dëmtues të tjerë* nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Makaronat të jenë të ambalazuara me ambalazhi të pastër ose polietileni me masë sipas kërkesave të AK-së. Në çdo pako lejohen shmangie ± 2 %.

Në çdo pako dhe kuti të shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Lloji,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes,
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ruajtja dhe transportimi

Makaronat ruhen në lokale të pastra, të thata, të ajrosura dhe të pa infektuar, në temperaturë 20°C, me lagështi relative të ajrit deri në 70%. Kutitë vendosen të ndara në parti, në stiva deri në 10 copë njëra mbi tjetrën. Afati i ruajtjes së makaronave në kushtet e përcaktuara në këtë standard për makaronat e thjeshta është deri në 12 muaj, nga data e prodhimit.

Transportimi bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktoret atmosferike, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Marrja në dorëzim bëhet me parti malli. Parti konsiderohet sasia e makaronave të një lloji, me karakteristika të njëjta të prodhuara nga i njëjti prodhues e që dorëzohen njëherësh.

Personi që merr në dorëzim produktin duhet të jetë me arsimin “Mercolog” dhe përpara se të marrë në dorëzim produktin duhet të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

8.VAJ USHQIMOR LULEDIELLI I RAFINUAR

Bazuar në SSH 203:2003 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore:

Treguesit Shqisorë:

- *Pamja*: Lëng vajor i qartë pa depozitime.
- *Ngjyra*: E verdhe e lehtë.
- *Era dhe shija*: Karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.
- *Numri i peroksideve*: jo me shume se 10 mek O₂ aktiv / kg Vaj.
- *Numri i aciditetit*: jo më shumë se 0.4 mg KOH/g vaj.

Treguesit Fiziko - Kimik:

- *Aciditeti si acid oleik*: 0.2 gr ne 100 gr/ Vaj.
- *Dendësia relative (20°C/ ujë në 20°C)*: 0.918 - 0.923.
- *Numri sapunifikimit (mg KOH/g vaj)*: 188 - 194.
- *Treguesi i jodit(Ëijs)*: 118 - 141.
- *Lëndë të pasapunifikueshme*: ≤ 15 g/ kg.
- *Treguesi i refraksionit (n_D^{40})*: 1.461-1.468.

Kontaminuesit, jo më shumë se:

- *Lëndë fluturuese, në 105°C*: 0.2%
- *Lëndë të patretëshme* : 0.05%
- *Përmbajtja e sapunëve*: 0.005%
- *Hekur (Fe)* : 1.5 mg/kg
- *Bakër (Cu)*: 0.1 mg/kg
- *Plumb (Pb)*: 0.1 mg/kg
- *Arsenik (As)*: 0.1 mg/kg

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Vaji të jetë i ambalazhuar në ambalazhim plastik me vëllim sipas kërkesave të AK-së, me tapë plastike, me vidhëzim të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse, të sistemuara në kuti kartoni ose me material tjetër të përshtatshëm. Shmangia në vëllim lejohet deri ±1 %. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa. Etiketimi bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Markimi:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produkti,
- Peshë neto,
- Lloji,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes,

- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Ruajtja dhe transportimi

Vaji i lulediellit ruhet në mjedise të pastra, pa lagështirë dhe të ajrosura.

Transportimi i vajit bëhet me mjete transporti të caktuara për produktet ushqimore. Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe që sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Verifikimi i kërkesave cilësore bëhet sipas metodave të analizave dhe të marrjes së mostrës në fuqi.

Produkti duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Personi që merr në dorëzim produktin duhet të jetë me arsimin “Mercolog” dhe përpara se të marrë në dorëzim produktin duhet të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

9.VAJ ULLIRI

Bazuar në SSH 1402-2004 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Ligjin nr. Nr. 87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit” dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 21.3.2017 Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”.

Klasifikimi

- Vaj ulliri i virgjër

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja dhe ngjyra:* E qartë, e verdhë në jeshile.
- *Era:* Karakteristike e frutit të freskët të ullirit.
- *Shija:* Karakteristike e frutit të freskët të ullirit.

Treguesit fiziko-kimik:

- *Aciditeti i lirë në acid oleik, g/100 g:* ≤ 2.0 .
- *Peroksidet, mek O₂/kg:* ≤ 20 .

- Koeficienti i përthithjes ultraviolet(UV):
 - $K_{232} \leq 2.60$.
 - $K_{270} \leq 0.25$.
 - $\Delta K \leq 0.01$.

Treguesit fiziko kimik:

- Dendësia relative (20°C/ ujë në 20°C): 0.910-0.916
- Indeksi i refraksionit (n^{20}_D): 1.4677-1.4705
- Numri i sapunifikimit (mg/KOH/g vaj): 184-196
- Numri i jodit(Ëijs): 75-94
- Lëndë të pa sapunifikueshme (me eterpetrol, gr/kg vaj): ≤ 15

Ndotësit:

- Lagështia dhe Lëndët fluore në 105 °C (% m/m): ≤ 0.2
- Papastërtitë e patretshme (% m/m): ≤ 0.1
- Testi i sapunimit: i papërfillshëm.

Aditivët ushqimorë:

- Nuk lejohet asnjë shtesë.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Vaji të jetë i ambalazhuar në ambalazhim qelqi ose plastik me ngjyrë të errët me vëllim sipas kërkesave të AK-së. Të jetë në shishe polietileni ose qelqi 1 lit I Etiketimi i vajit të ullirit sipas etiketimit të produkteve ushqimore.

Markimi:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produkti,
- Pesha neto,
- Lloji,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes,
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ruajtja dhe transportimi:

Vaji i ullirit ruhet në mjedise të pastra, pa lagështirë dhe të ajrosura.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Personi që merr në dorëzim produktin duhet të jetë me arsimin “Mercolog” dhe përpara se të marrë në dorëzim produktin duhet të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

10. MIELLI

Bazuar në udhëzimin nr. 207, datë 31.03.2015 i Ministrisë të Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave “Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të para pakëtuar, për t’u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”.

Klasifikimi

Lloji: Miell gruri me rreze 80 %, cilësi e parë

Treguesit shqisor:

- Mielli dhe çdo përbërës që shtohet duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për konsum njerëzor;
- Mielli duhet të jetë pa erë dhe shije jonormale dhe pa insekte të gjalla;
- Mielli duhet të jetë pa papastërti me origjinë shtazore (duke përfshirë dhe insektet e ngordhura) në sasi të dëmshme për shëndetin e njeriut.

Treguesit Fiziko-kimikë:

- *Niveli maksimal i përmbajtjes së lagështisë për miellin, pavarësisht specisë së grurit nga i cili është përgatitur, është 15% masë/masë;*
- *Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata, % jo më shumë se 0.115.*
- *Hiri i tretshëm, në lëndën absolutisht të thatë, %, jo më shumë se 0.9.*
- *Hiri i patretshëm në acid klorhidrik 10%; në lëndën absolutisht të thatë, %, jo më shumë se 0.1.*
- *Mbisitja (imtesia e bluarjes): Për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra:*
- *Në sitën metalike nr.54, jo më shumë se 2%.*
- *Në sitën e mëndafshhtë 5 xxx, jo më shumë se 5%.*
- *Gluteni i njomë, jo më pak se 25%.*
- *Lëndë minerale: Nuk lejohen.*
- *Përzierje metalike: Plumbi, zinku e bakri nuk lejohen. Lejohet përmbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, jo më shumë se 3mg/g.*
- *Mikroorganizma patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë, nuk lejohen.*
- *Aciditeti i yndyrës: maksimumi 70 mg/100 g miell mbi bazën e lëndës së thatë, e shprehur si acid sulfurik.*

- *Proteina (Nx5,7)*: minimumi 9 % mbi bazën e lëndës së thatë.
 - Mielli duhet të jetë pa metale të rënda në sasi të dëmshme për shëndetin e njeriut. . Ato duhet të jenë në përputhje me nivelet e vendosura në udhëzimin nr. 13, datë 29.9.2010, “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.
 - Mielli nuk duhet të ketë mbetje pesticidesh më shumë se vlera maksimale e lejuar për këtë produkt e vendosur në udhëzimin nr. 5, datë 14.5.2014, “Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në banane, domate, grurë, kastravecë, mollë, patate, rrush tavoline, rrush për verë, speca, ullinj tavoline”.
 - Mielli nuk duhet të ketë mykotoksina më shumë se vlera maksimale e lejuar për këtë produkt në përcaktimet e Udhëzimi i Ministrisë të Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të Ujrave Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.
 - Mielli nuk duhet të përmbajë aditivë të tjerë nga ato të përcaktuara në udhëzimin nr. 16, datë 29.8.2011 “Për aditivët ushqimorë të tjerë nga ngjyruarit dhe ëmbëlsuesit”.
 - Mielli duhet të plotësojë kushtet higjienike të vendosura si më poshtë:
 - o Të jetë pa lëndë të huaja në shkallën që zbatohet procesi optimal teknologjik;
 - Sipas metodave të caktuara të marrjes së mostrës dhe analizimit:
- i) Duhet të jetë pa mikroorganizma në sasi, të cilat janë të dëmshme për shëndetin e njeriut;
- ii) Duhet të jetë pa parazitë, të cilët janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut;
- iii) Nuk duhet të përmbajë asnjë substancë me origjinë nga mikroorganizma në sasi të dëmshme për shëndetin e njeriut.

Ambalazhimi, ruajtja dhe transportimi

Mielli pakëtohet në ambalazhe, të cilat sigurojnë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit.

Ambalazhet duhet të jenë të sigurta dhe të përshtatshme për qëllimin e përdorimit. Ato nuk duhet të mbartin asnjë substancë toksike dhe nuk duhet të kenë shije dhe erë të padëshirueshme për produktin. Kur produkti është pakëtuar në thasë, ato duhet të jenë të pastër, të fortë, të qepur shumë mirë ose të ngjitur mirë.

Mielli etikëtohet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1344, datë 10.10.2008, “Për miratimin e rregullores “Për etikëtimin e produkteve ushqimore”. Gjithashtu, për etikëtimin e tij zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:

- a) Emri i produktit në etiketë duhet të jetë “miell gruri”.
- b) Informacioni për miellin që shitet me shumicë do të jepet ose në ambalazh ose në dokumentet shoqëruese.

Ambalazhimi në pako letre ose plastike me masë sipas kërkesave të AK-së. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhënat e mëposhtme. Me material letre të masës 1 kg me elementet e marketimit të stampuara.

Etiketimi:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Lloji,
- Data e prodhimit,

- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të behet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti malli. Parti është sasia e miellit e të njëjtës rreze dhe që dorëzohet njëherësh.

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

11.NISESHTE

Bazuar ne SSH 1557:1987 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Pluhur që kërcet me prekje në dorë. Me ngjyrë të bardhë me nuance të lehtë të verdhë.
- *Era dhe shija:* Karakteristikë e niseshtesë së misrit. Pa erë e shije të thartë. Lejohen pika të zeza pak të dukshme deri ne 8 për 1 cm².

Treguesit fiziko- kimik:

- *Lagështira,%*, jo më shumë se 13.
- *Hiri në lëndët e thata*, jo më shumë se 0.48.
- *Aciditeti në lëndët e thata, i shprehur në ml hidrokسيد natriumi (NaOH) 0.1 N për 100 gr niseshte*, jo më shumë se 25.
- *Gaz sulfuror në lëndët e thata, mg/kg niseshte*, jo më shumë se 50.

Ambalazhimi, markëtimi, etiketimi.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Niseshteja ambalazhohet në qese letre ose polietileni me masë sipas kërkesave të Ak-së. Shmangiet në masë lejohen $\pm 2\%$. Me material letre të masës 1 kg

Mbi çdo ambalazh shënohet:

- Emri i ndërmarrjes tregtare/prodhuesit,
- Emërtimi i mallit,
- Lloji,
- Data e prodhimit,

- Masa neto,
- Data skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Niseshteja ruhet në depo të pastra, të ajrosura dhe pa lagështirë. Koha e ruajtjes është deri në 1 vit. Transportimi bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferike, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Produkti duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

12.ORIZI

Bazuar në SSH ISO 7301:2011 ose ekuivalentin e tij.

Treguesit shqisore

- *Pamja e jashtme:* Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.
- *Ngjyra:* E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.
- *Era dhe shija:* Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë të mykur dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit fiziko - kimik sipas SSH ISO 7301:2011 ose ekuivalentit të tij.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH ISO 7301:2011: “Specifikimet” ose ekuivalentit të tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Orizi të jetë i ambalazhuar me ambalazh të pastër polietileni me masë sipas kërkesave të AK-së. Me qese polietileni me peshë 1 kg ku të shënohet afati i skadencës deri në një vit

Në çdo pako dhe kuti të shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Peshë neto,
- Data e prodhimit,

- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes,
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Transportimi bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktoret atmosferike, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

13/1. PIPER I KUQ

Bazuar në SSH EN ISO 7540:2010 ose ekuivalenti i tij.

Klasifikimi

- Lloji: kokërr ose pluhur, cilësia e parë.

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Të jenë të cilësisë të mirë, të thata, pa lagështi, ngjyra karakteristike e llojit.
- *Ngjyra:* Ngjyrë karakteristike e llojit (e kuqe).

Treguesit fiziko – kimik sipas SSH EN ISO 7540:2010 ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi.

Sipas SSH EN ISO 7540:2010: “Piper i kuq- Specifikimet” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Erëza ambalazhohet në ambalazhim plastik ose letre me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Peshë neto,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjenike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

13/2. PIPER I ZI

Bazuar në SSH ISO 959-1:1998 ose ekuivalenti i tij.

Klasifikimi

- Lloji: Kokërr ose pluhur, cilësi e parë

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Të jenë të cilësisë të mirë, të thata, pa lagështi, ngjyra karakteristike e llojit.
- *Ngjyra:* Ngjyrë karakteristike e llojit (gjyra e zezë).

Treguesit fiziko- kimik sipas SSH ISO 959-1:1998 ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi.

Sipas SSH ISO 959-1:1998: “Piper, kokërr ose pluhur- Specifikimet- Pjesa 1: Piper i zi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Erëza ambalazhohet në ambalazhim plastik ose letre me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Peshë neto,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjenike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

14. SALCA (lëng domate)

Bazuar në SSH 1429: 1987 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore

Treguesit cilësorë:

- *Pamja e jashtme:* Masë e rrjedhshme me pjesë të dukshme të përbërësve të saj pa pjesë të djegura e njolla të zeza.
- *Ngjyra:* E kuqe deri e kuqe e thellë. Karakteristikë e salcës në cilësinë e parën të përdorur.
- *Shija dhe era:* Karakteristikë e salcës dhe përbërësve të saj. duhet të jetë e këndëshme të mos jetë e hidhur, djegëse, e të mos ketë shije ose erë të huaj.

Treguesit Fiziko –Kimik :

- *Lëndë të thata të matura me refraktometërnë % të jetë* 14 ± 1 .
- *Aciditeti i shprehur në acid citrik në %:* jo më shumë se 2.5 %
- *Përmbajtja e vajit vegjetal të rafinuar në %* 7-8.
- *Përmbajtja e metaleve të rëndë, mg/kg produkt, jo më shumë se:*
 - *Bakër* 30
 - *Kallaj* 50
 - *Plumbi* 0.3

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Salca e gatshme për makarona ambalazhohet në ambalazh qelqi të mbyllura hermetikisht me pesha sipas kërkesave se AK.

Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produkti,
- Pesha neto,
- Lloji,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes,
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ruajtja dhe transportimi

Salca e gatshme për makarona ruhet sipas kushteve të këtij standardi deri në 12 muaj nga data e prodhimit.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjenike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specififikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë, të cilët duhet të jenë në përputhje me specififikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

15. REÇELI

Bazuar në SSH 1477:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- Sipas frutit: Mollë, kumbull, qershi, fik, cilësi e parë
- I pasterilizuar

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë

- *Pamja e ngjyra:* E mirë, me fruta me ngjyrë të njëllotë, karakteristike e llojit, pa bërthamë dhe farë. Pa lëkura të shkëputura të frutit, pa flluska ajri.
- *Shija dhe era:* e mirë, e këndshme. Karakteristikë e frutit të freskët, pa shije të sheqerit të djegur si dhe pa çfarëdo erë e shije tjetër të huaj.
- *Konsistenca:* Masë e njëllotë, viskoze deri xhelatinoze me frut me zierje normale.

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Lëndët e thata sipas refraktometrit në 20 °C, %*, jo më pak se: 70 .
- *Sheqer gjithsej (sheqer saharoz dhe i vetë frutit), %*, jo më pak se: 65.
- *Aciditeti i shprehur në acit tartik, %*, jo më shumë se: 1.3.
- *Përmbajtja e kriprave të metaleve të rënda në mg/kg produkt* jo më shumë se:
 - *Kallaji* 100
 - *Bakri* 10
 - *Zinku* 10
 - *Plumbi* 0.1
 - *Arseniku* 0.2
- *Shenja myku dhe fermentimi* nuk lejohen
- *Lëndë të huaja* nuk lejohen.

Ngarkesa mikrobiale:

- Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Shënim: Nuk lejohet përdorimi i ngjyresve artificialë. Për përmirësimin e ngjyrës lejohet vetëm përdorimi i lëngut të frutave me ngjyrë.

Raport analiza Fiziko – kimike duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në paketim në vazo qelqi ose plastik, me masa të ndryshme sipas kërkesave të AK me shmangie $\pm 3\%$. **Të jetë në vazo qelqinore kuti plastike me masën 1-5 kg.**

Cilësia e reçelit duhet të jetë në përputhje me lëndën e parë që është përdorur për prodhim. Ambalazhimi të bëhet sipas SSH 1553:1987 “Prodhime të konservuara. Marrja e mostrës, ambalazhimi, etiketimi dhe transportimi.” ose ekuivalentin e tij.

Markimi:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Reçeli depozitohet në vende të freskëta dhe të thata të mbrojtura nga rrezet e diellit, në temperaturë deri në 20 °C dhe lagështi relative të ajrit deri 75%.

Reçeli i pasterilizuar, i prodhuar dhe i ruajtur sipas kërkesave të këtij standarti, garantohej nga prodhuesi deri në 6 muaj nga data e prodhimit.

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analizë nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

16. RIGON

RIGON I BARDHË I SHKOQUR

Bazuar ne SSH 2422:1994 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Fletë e lule të thara, të shkoqura nga kërcelli i bimës. Aroma dhe shija karakteristike të vetë bimës.
- *Ngjyra:* Fleta e gjelbërt, e gjelbërt në të hirtë dhe e gjelbërt në të verdhë. Lulja e bardhë, e verdhë deri në bezhë.

Treguesit fiziko- kimik:

- *Lagështira,*%, max 13.
- *Pjesë të bimës (kërcej) me gjatësi deri në 10 mm,* %, max 5.
- *Fletë e lules me ngjyrë jo normale,* %, max 3.
- *Pluhur organik nga copëtimi I bimëve me madhësi deri 0.5 mm,* %, max 5.
- *Hiri I patretshëm në HCl,* %, max 0.5.
- *Të mykura e të kalbura,* % nuk lejohen.

Ngarkesa mikrobiale:

- Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi.

Sipas SSH 2500:1988 “ Bimë mjekësore, eterovajore dhe tanifere. Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Erëza ambalazhohet në ambalazhim plastik ose letre me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

17. UTHULL

Bazuar në SSH 1427: 1987 ose ekuivalentin e tij.

- Me bazë frutash,

-

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- Pamja e jashtme: E kthjellët dhe pa turbullira.
- Ngjyra: Karakteristike e uthullës sipas frutit të përdorur.
- Era dhe shija: E mirë me erë dhe shije të këndshme dhe karakteristike pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko - kimik:

- Masa specifike në 15°C: 1.020
- Përmbajtja e aciditetit të përgjithshëm % në vëllim shprehur në acid acetik: jo më pak se 4-6% acid acetik në varesi të së cilës përcaktohet shija dhe aroma.
- Përmbajtja e ekstraktit të përgjithshëm, gr për litër: jo më pak se 12.

Ndalohet shtimi në uthull i acideve organike dhe minerale. Ndalohet përdorimi i ngjyruësve natyror dhe artificial me përjashtim të enocianines.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Sipas SSH 1479:1987 “Raki” ose ekuivalentin e tij.

*Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Uthulla do të ambalazhohet në ambalazh plastike ose qelqi me vëllim sipas kërkesës së AK-së, të mbyllur me tapë plastike ose me tapë alucap. **Duhet të jetë në shishe qelqi ose plastike që të peshoj 0.5-1 litër.***

Mbi çdo ambalazh do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto ose vëllimi i produktit,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Uthulla ruhet në ambiente të freskëta. Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjenike.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specififikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specififikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

LOTI III

1. VEZË

Bazuar në SSH 325-1 :1993 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Rregulloren nr. 1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët, në udhëzimin Nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe bazuar në Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Klasifikimi

- Masa në gram: me diametri (4x6 cm).
 - o më pak se 53 gr. (S)
 - o 53 gr e më tepër dhe jo mbi 63 gr. (M)
 - o 63 gr dhe jo më tepër se 73 gr. (L)

Kërkesat cilësore:

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* e pastër dhe pa plasje. Lejohen ndotje të lehta.
- *Dhoma e ajrit (lartesia) mm:* jo më shumë se 9 mm.
- *E bardha e vezës.* E dendur e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar në ovoskop).
- *E verdha e vezës.* Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e levizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror.
- *Era:* pa erë prishje dhe erë tjetër të huaj.
- Ç’do kokërr duhet te jete e vulosur ku te përmbaje markën dhe datën e saktencës.

Ngarkesa mikrobiale:

- *Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

Gjithashtu duhet që çdo parti malli të shoqërohet me raport analizë ku kjo e fundit të përputhet me datën dhe markën e vulës.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet sipas kërkesave të AK.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emri i ndërmarrjes prodhuese,
- Sasia,
- Data e skadencës.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

2. QUMËSHT

Qumësht me gjysëm yndyrë i pasterizuar.

Bazuar në SSH 1563:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar ne SSH 1563/87, Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi” dhe Udhëzimit i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Kërkesat cilësore

Detyrimisht i pasterizuar.

Gjate përpunimit dhe tregtimit të zbatohen rregullat higjieno-sanitare e veterinarë në fuqi.

Nuk duhet të lejohet përdorimi i lendeve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.

Te plotësoje treguesit organoleptike dhe ato fiziko-kimike.

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Të jetë lëng i njëjlojtë (homogjen), pa lëndë të huaja që duken e notojnë ose bien në fund.
- *Ngjyra:* e bardhë, e njëjlojtë me nuance të verdhë të lehtë.
- *Shija:* e këndshme, lehtësisht e ëmbël, me shije të lehtë zierje pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Dendësia në 20 °C* jo më pak se 1.029 gr/litër.

- *Pika e ngrirjes jo më e lartë se $-0,520^{\circ}\text{C}$.*
- *Përmbajtja e yndyrës në %, 2 ± 0.1 .*
- *Aciditeti ne gradë Tjorner:*
 - o *Në periudhën 01 Tetor – 31 Mars: jo më i lartë se 20.*
 - o *Në periudhën 01 Prill – 30 Shtator: jo më i lartë se 21.*
- *Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8.5 %*
- *Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes) duhet negative.*
- *Mikroelementet, mg/l jo me shume se:*
 - o *Arseniku: 0.1*
 - o *Bakri: 0.5*
 - o *Plumbi: 0.2*
 - o *Zinku: 5*
- *Pastërtia pa mbetje me sitë mëndafshi apo merlë pambuku dyfishe.*

Ngarkesa mikrobiale:

- *Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi brenda kushteve higjeno-sanitare, me vëllim sipas kërkesave të AK-së, në ambalazhim plastik , Në enë të përshtatshme plastike ose kartoni të veshura brenda, me etiketa në të cilën pesha duhet të jetë 1-1.5 litërsh.ku të jenë vendosur:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto ose vëllimi i produktit,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Përqindja e yndyrës,
- Temperatura e ruajtjes së produktit.

Materialet qe përdoren për ambalazhet e qumështit duhet të jenë sipas normave teknike dhe higjeno-sanitare të përcaktuara në standardet përkatëse.

Ruajtja dhe transportimi

Kushtet e veçanta të ruajtjes: në temperaturë 2 deri në 8 gradë.

Transportimi i qumështit bëhet me mjete të specializuara, të caktuara për transportimin e qumështit. Transportimi bëhet sa më shpejtë, në kohë të freskët, natën ose në orët e para dhe të vona të ditës.

Qumështi meret në dorëzim me parti që është sasia e qumështit të një lloji dhe që dorëzohet njëherësh.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

3. KOS

Bazuar në SSH 1443:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Klasifikimi

- Me yndyrë ≥ 2 %,
- Lloji: Lope

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Ngjyra:* e bardhë, në sipërfaqe e bardhë lehtësisht në krem.
- *Struktura:* e ngjeshur, pa pore, në prerje pa shtresa dhe ndarje hirre.
- *Era dhe shija:* e këndshme, karakteristike e kosit të ëmbël, lehtësisht e thartë.

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Aciditi në gradë Tjorner,* jo më shumë se 120.
- *Yndyra në %,* 2 ± 0.1 .
- *Ngarkesa mikrobiale* sipas normave të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ngarkesa mikrobiale:

- *Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Kosi ambalazhohet në paketime plastike me grykë të gjerë ose me ambalazhime plastike të mbyllura me kapak sipas kërkesave të AK-së. Në enë të përshtatshme plastike ose kartoni të veshur nga brenda, me etiketë 1-5 kg.

Ambalazhet që përdoren të jenë në gjendje të mirë, të pastër, të thata dhe pa erë të huaj. Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjeno-sanitare nga standardet përkatëse.

Në çdo paketim vendoset etiketa ku shënohet:

- Emri i ndërmarrjes prodhuese,
- Përqindja e yndyrës,
- Peshë neto ose vëllimi i produktit,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Kosi ruhet e tregtohet në frigorifer në temperatura nën 10 °C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Koha e ruajtjes në frigorifer është 24 orë nga koha e prodhimit. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

4.SALÇIÇE KREMVIÇE

Bazuar ne SSH 1458:1990 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Udhëzimit i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Klasifikimi:

- Lloji: viçi

Kërkesat cilësore

Mishi për përgatitjen e kremviçeve përdoret në gjendje të freskët (i ngrohtë dhe i ftohur).

Treguesit shqisorë:

- *Forma:* Në formë harku sipas zorrëve, e përdredhur në çifte, në distancë të baraslarguar.
- *Përmasat:*
 - o Gjatësia, cm: 10-15
 - o Diametri, mm:16-24
- *Pamja e jashtme:* E plotë, e fortë, pa dëmtime sipërfaqësore, pa boshllëqe ajri, cipa mbështjellëse të jetë e ngjitur mirë me mishin. Pa shenja myku ose jargë në sipërfaqe.

Ngjyra rozë e çelur. Fundet të jenë të lidhura mirë. Për sallamet me përdredhje në çift të jenë distanca standarde.

- *Pamja e brendshme në prerje tërthore*: Masë e përzier, e njëtrajtshme, pa boshllëqe ajri, me ngjyrë natyrore të mishit, e kuqe në rozë, pa njolla të errëta. Prerja segmentale mozaike me kokrriza mishi dhe dhjami të shpërndara njëllor gjatë sipërfaqes së prerjes.
- *Qëndrueshmëria*: Elastike, nga shtypja e ushtruar të mos ngelet shenjë.
- *Era*: E këndshme, karakteristike për erërat e përdorura, pa erë të huaj.
- *Shija*: E këndshme, karakteristike për llojin e produktit me kripë normale, pa shije të huaj.

Treguesit fiziko- kimik:

- *Lagështia*, %, jo më shumë se 60.
- *Nitrit mg/100g*, jo më shumë se 20.
- *Kripë*, %, jo më shumë se 3.
- *Yndyrna*, %, jo më shumë se 23.

Ngarkesa mikrobiale:

- *Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore"*.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Ambalazhimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Kremviçet ambalazhohet në qese plastike me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Peshë neto ose vëllimi i produktit,
- Data e prodhimit,
- Data e skadencës,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes,
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ruajtja dhe transportimi

Transportimi bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga faktorët atmosferike, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Reklamimi i produktit nga marrësit në dorëzim për defekte të dukshme shqisore bëhet në kohën e marrjes në dorëzim.

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

5.MISH PULE

Bazuar ne SSH 1168:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në SSH 1168/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre” dhe Udhëzimin e Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Klasifikimi

- I freskët,

Kërkesat cilësore

Mishi i shpendëve fitohet nga therja e përpunimi i shpendëve të gjallë sipas procesit teknologjik të përcaktuar duke zbatuar dispozitat veterinare e sanitare në fuqi.

Shpendët që kalojnë për therje të plotësojnë kërkesat cilësore të standardit në fuqi të shpendëve për therje dhe 15 ditë para therjes u ndërpritet dhënia e antibiotikëve dhe e stimulantëve të tjerë.

Mishi i shpendëve të jetë i pastër, pa mbetje të zorrëve të trakesë, të kllোকës ose të pendëve. Në muskujt të mos ketë mbetje të gjakut që shkaktohen nga ç’gjakësimi jo i rregullt.

Treguesit shqisorë:

- *Për cilësinë e parë: Të ketë pamje të mirë me ngjyrën natyrore të llojit. Muskulatura e gjoksit dhe e kofshëve të jetë e zhvilluar mirë. Kocka e gjoksit (sternumi) të mos duket, tek gjelat e zogjtë mund të dallohet pak. Në hapësirën e barkut të ketë shtresa dhjami, tek gjelat e zogjtë dhjami të jetë më i pakët.*

Ngarkesa mikrobiale:

- *Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Ambalazhimi, paketimi dhe etiketimi

- Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.
- Materiali ambalazhues duhet të plotësojë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, dhe të shoqëruara me çertifikatë konformiteti.
- Mishi i shpendëve, mbasi ka kaluar procesin e paraftohjes, pakëtohet në qeska polietilene. Paraprakisht në hapësirën e barkut të çdo shpendi, në qeskë polietilene vendosen të brendshmet (mëlçia, stomaku e zemra) dhe qafa.
- Në masën e çdo pule të pakëtuara lejohen shmangie në masë ± 15 gram për cilësinë e parë.

Verifikimi i kërkesave cilësore

- Marrja në dorëzim e mishit të shpendëve bëhet me parti, e cila përfaqëson sasinë që jepet njëherësh për furnizim, e të njëjtit lloj dhe me të njëjtën cilësi.
- Çdo parti mishi shoqërohet me çertifikatën veterinare.
- Të jetë me arka kartoni, me peshe deri në 16 kg. Mbi çdo arkë të jetë e vendosur etiketë e cila veç të dhënave të mësipërme të përmbajë: sasinë, datën e prodhimit e të skadencës dhe vulën e kontrollit të cilësisë.

Ruajtja dhe transportimi

Transportimi i mishit të shpendëve, bëhet me mjete autofrigoriferë. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta.

Transportimi i mishit të freskët (jo i ngrirë) bëhet në arka plastike ose prej materiali që nuk ndryshket.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Mishi i pulës të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqëruar me Çertifikatë Veterinare. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë çertifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë.

Çertifikata veterinare duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

6. MISH VIÇI

Bazuar në SSH 1441:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në SSH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre” dhe Udhëzimin e

Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Klasifikimi:

- I freskët, cilësia e parë (Vici duhet të jetë deri në 1 vjec i prerë dhe me peshë deri në 100 kg)

Kërkesat cilësore

Mishi përgatitet në gjysmë trupi dhe në çerek. Trupi ndahet në gjysma në mes të vertebrave të shtyllës kurrizore, duke lënë në njëren anë palcën e kurrizit. Ndarja e gjysmë trupave në çerekë bëhet nëpërmjet brinjës 12 dh 13 dhe nëpërmjet brinjës 7 dhe 8 kur mishi i nënshtrohet ndarjes anatomike. Koka pritët nëpërmjet kockave të qafës dhe të vertebrës së parë të qafës(atlanti) këmbët te kyçet e gjurit, kurse bishti pritët nëpërmjet vertebrës së parë e të dytë të tij. Organet e brendshme, përveç veshkave, veçohen.

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Sipërfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje. Sipërfaqja e mishit menjëherë pas prerjes është e lagët dhe e ndritshme, lëngu del me vështirësi dhe është i tejudkshëm. Tendinat janë të shëndritshme, elastike dhe të forta. Sipërfaqja e artikulacioneve është e shëndritshme. Lëngu është i tejudkshëm.
- *Ngjyra:* Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme jo e ngjitshme. Ngjyra e dhjamt është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.
- *Era:* e këndshme , karakteristikë e llojit.
- *Palca e kockave :* Mbush plotësisht kanalën e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë. Në prerje është e shëndritshme.
- *Konsistenca:* E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejudkshëm.
- *Lëngu i mishit pas zierjes:* i tejudkshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Azot i tretshëm, mg, amoniak (NH₃)/100 gr produkt* jo më shumë se 20.
- *Aciditeti i shprehur në pH:* 5.2 deri 6.4.
- *Reaksioni për hidrogjenin sulfuror (H₂S):* Negativ.
- *Reaksioni Kreis:* Negativ.

Ngarkesa mikrobiale:

- *Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

Treguesit kimikë dhe mikrobikë analizohen në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi.

Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pa të brendshme, këmbë dhe kokë.

Ambalazhimi dhe markimi

Çdo trup, gjysëm trup ose çerek damkoset me vulën e kontrollit veterinar e sanitar dhe me vulën e llojit e të cilësisë së mishit.

Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinarë me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje.

Tregtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes.

Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në çdo pjesë.

Mishi duhet të thërrë në ambiente (thertore të licencuara), të cilat plotësojnë standardet higjieno – sanitare dhe veterinarë.

Qeset e ambalazhit duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, të jenë qese të pa-riciklueshme dhe të shoqëruara me certifikatë konformiteti.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Ambalazhet duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Ruajtja dhe transportimi

Mishi ruhet në kushte frigoriferike.

Në gjendje të ftohur ruhet në temperaturë nga 0 deri në -1 °C, me lagështirë relative 90-95 %, deri në 10 ditë ose në temperaturën 0 deri në +4 °C deri në 5 ditë. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti, e cila përfaqëson sasinë e mishit e të njëjtit lloj i therur në të njëjtën thertore dhe që dorëzohet njëherësh.

Kontrolli veterinar dhe sanitar i mishit bëhet sipas ligjit në fuqi “Mbi shërbimin veterinar”.

Mishi të jetë i cilësisë së parë, i shoqëruar me certifikatë veterinarë sipas ligjeve në fuqi.

Të mos ketë përqindje të madhe dhjami, preferohet kofshë e pasme.

Mishi i viçit të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqëruar me Certifikatë Veterinarë. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë. Certifikata veterinarë duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar. Certifikata veterinarë duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

7. DJATHI I BARDHË

Bazuar në SSH 1492:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Udhëzimit i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Klasifikimi

- Lloji: Lope, dele ose dhie,

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* E pastër dhe pa të meta në sipërfaqe, në prerje duken sytha teknikë. Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe.
- *Era dhe shija:* Të ketë erë dhe shije të këndshme karakteristike e djathit të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse dhe pa shije e aromë të huaj.
- *Forma dhe masa:* Formë sektori, kubi, paralelopipedi. Masa sipas kërkesës së AK.
- *Konsistenca:* Pa shtresa, lehtësisht e ashpër deri në të fortë.
- *Ngjyra:* e bardhë në krem.

Treguesit fiziko-kimik:

- *Lëndët e thata në %* jo më shumë se 48.
- *Yndyra në lëndët e thata në %* jo më shumë se 30.
- *Kripë në %* jo më shumë se 4 ± 1 .

Ngarkesa mikrobiale:

- Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Koha e stazhonimit deri në 45 ditë.

Ambalazhimi dhe marketimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit me masa sipas kërkesave të AK-së. **Të jetë në fuqi 30-40 kg plastike ose në kova plastike 10 kg.**

Mbi çdo ambalazh me djathë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Cilësia
- Pesha neto ose vëllimi i produktit

- Data e prodhimit
- Data e skadencës
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Transporti dhe Ruajtja

Të ruhen në temperaturë 3 – 5°C, lagështia relative e ajrit në dhomë 90-92 %. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

8. GJALP ME KRIPË

Bazuar në SSH 1445:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Klasifikimi:

- Gjalpë me kripë
- Lloji: Lope

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- Pamja: E njëtrajtshme, pa shtresa, në prerje e sipërfaqe të shëndritur pa pika uji dhe mbeturina dhalli.
- Ngjyra: E bardhë deri në të verdhë, karakteristike e kremës nga e cila prodhohet, e njëllojtë në të gjithë masën.
- Era dhe shija: E këndshme, karakteristike e gjalpës, lehtësisht e kripur. Pa erë dhe shije të huaj.
- Konsistenca në temperaturë 10-12 °C: gjysmë e fortë.

Treguesit fiziko-kimik:

- Lagështia në % ,jo më shumë se 17.

- Yndyrë në %, jo me pak se 79.
- Lëndët e thatë pa yndyrë në %, jo më shumë se 2.
- Aciditeti i shprehur në gradë Ketshtofer jo më shumë se 5.
- Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ngarkesa mikrobiale:

- *Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

Ambalazhimi dhe markëtimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Ambalazhimi të bëhet në letër pergamen ose qese polietileni me vëllime sipas kërkesave të AK.

Mbi çdo ambalazh me gjalp vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Cilësia
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës
- Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Paketat e gjalpit vendosen në arka ose kuti kartoni, druri ose plastike dhe mbi secilën prej tyre vihet etiketa në të cilën shënohen të dhënat e mësipërme.

Ruajtja dhe transportimi

Gjalpi ruhet në frigorifer. Nuk lejohet ruajtja e gjalpmit së bashku me produktet që janë burim infeksioni ose që kanë erë specifike.

Afati i ruajtjes për gjalpin e kripur në temperaturën -18°C është 1 vit.

Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organo-leptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analiza nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Ngarkesën Mikrobiale” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

1. PERIMET E FRESKËTA

Te jenë të freskëta dhe perimet të jenë të pa dëmtuara, të lara dhe të pastruara, të jenë të gjitha llojet, përfshirë dhe frigoriferike për perimet jo të stinës.

Bazuar në SSH 1756:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- Lloji : e freskët dhe të pa dëmtuara, perimet të jenë të gjitha llojet, dhe frigoriferike për perimet jo të stinës.

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme:* Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri teknike.
- Të mos kenë prani të barërave të tjera
- Të jenë të plota dhe të pa demtuara jo të vyshkura.
- *Dëmtime (të shtypura, të gërvishtura), %, jo më shumë se: 3.*
- *Shija:* Karakteristike e kultivarit.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit cilësorë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

2. PATATE

Bazuar në SSH 1729:1990 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : e freskët**

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme:* Të plotë, të shëndosha, jo të jeshilosur, të pastër, të pa mbirë, të një ngjyre e forme karakteristike të kultivarit. Zhardhokët të njëjtë në formë e ngjyrë.
 - a) *Zhardhokë të jeshilosur në 1/3 e sipërfaqes, %, të masës, jo më shumë se:* 1.
 - b) *Zhardhokë të vyshkur, %, të masës, jo më shumë se:* 2.
 - c) *Zhardhokë me lëkurë të zhveshur deri 1/3 e sipërfaqes, %, e masës, jo më shumë se:*
 - *Për veroret:* 10.
 - *Për dimëroret:* 15.
- *Lëndë minerale (gurë, etj. %, të peshës, jo më shumë se:* Nuk lejohen.
- *Përmbajtja e nitrateve mg/ kg, jo më shumë se:* 250.
- *Dëmtime, %, e numrit të zhardhokëve, jo më shumë se:*
 - *Të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen:* Nuk lejohen.
 - *Të mbira:*
 - *Për veroret:* Nuk lejohen.
 - *Për dimëroret:* 1.
 - *Nga krymbi tel:* Nuk lejohen.
 - *Nga djegie dielli:* Nuk lejohen.
 - *Nga bryma e ngrirje:* Nuk lejohen.
 - *Nga sëmundje:*
 - *Kroma e njolla ndryshku:* 1.
 - *Këmbëzezë, kalbëzim unazor etj., sëmundje të tultit:* Nuk lejohen.
- *Të kalbura:* Nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit cilësorë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

3. QEPËT E THATA

Bazuar në SSH 1468:1987 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisrorë:

- *Pamja e ngjyra:* Karakteristikë e qepës së bardhë të tharë pa pjesë të karamelizuara. Në formë sektori rrethor me trashësi 2-5 mm. Lejohen copa me përmasa të vogla deri në 5 % e sasisë.
- *Shija dhe era:* Karakteristikë e qepës pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko-kimik:

- *Lagështia* jo më shumë se 8 %.
- Lëndë të huaja nuk lejohen.
- Ngarkesa mikrobiale: brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Të ngrira, te kalbura e të mykura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Qepët vendosen në arka kartoni në sasi sipas kërkesave të AK-së.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Marrja në dorëzim bëhet me parti. Parti konsiderohet sasia e qepës së thatë me karakteristika të njëjta, e prodhuar nga i njëjti prodhues dhe që dorëzohet njëherësh.

Çdo parti shoqërohet me fletë analizë laboratorike.

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

Ruajtja dhe transportimi

Qepa e thatë e ambalazhuar si më sipër ruhet në ambiente të errëta e të thata, të ajrosura mirë, me temperaturë deri në 25°C dhe lagështi relative jo më shumë se 75%.

Thasët ose kutitë vendosen në stiva mbi skelaturë druri deri në largësi rreth 25 cm nga dyshemetë dhe 50 cm larg mureve. Ambientet të dezinfektohen herë pas here.

Transporti i perimeve bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Qepa e prodhuar dhe e ruajtur në kushtet e përcaktuara në këtë standart garantohet nga prodhuesi për 8 muaj nga data e prodhimit.

4. FRUTAT

Duhet të jenë të shëndosha, pa ndryshime cilesore dhe humbje në peshë, pa difekte, të pa vyshkura, të madhësisë dhe formës së rregullt.

Mollët, portokallet, duhet të kenë peshë për çdo kokërr 180-200 gr.

Frutat e tjera sipas kërkesës së tregut.

Nuk lejohen të jenë të ngrira, gërvishje në sipërfaqe dhe pa erëra të huaja.

Nuk duhet të kenë dëmtime mekanike

Ambalazhimi duhet të jetë në arka druri, kartoni, plasmasi të pa dëmtuara.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marri në dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit cilësorë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

4/1. MOLLË

Bazuar në SSH 1752:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : e freskët**

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme, pjekuria, era dhe shija:* Me formë, ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike të njëjtë, të shëndosha, të pastra, të zhvilluara normalisht e me bishtapor lejohen edhe kokrra pa bishta, por pa defekte rreth bishtit. Pa erë e shije të huaj.
- *Madhesia e kokrres (prerë gjërasi, në diametrin me të madh):*
 - o *Kultivaret me kokerr të zgjatur jo me pak se:60 mm.*
 - o *Kultivaret me kokerr të rrumbullaket jo me pak se:70 mm.*
 - o *Kultivaret me kokerr të vogel jo me pak se:50 mm.*
- *Dëmtime të ndryshme:*
 - o *Mekanike:* Lejohen deri 2 njolla jo të zeza, të vogla, të lehta për kokërr.
 - o *Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.*
 - o *Nga krimbi(pa galeri në brendësi) nuk lejohen.*
 - o *Nga fuzikladi (kroma e pikalorja):*Lejohen në formë pikash, jo më tepër se 2 pika për kokërr.
 - o *Të gjitha dëmtimet e sipërme (brenda normave të caktuara për çdo parti), %, jo më shumë se: 10.*
 - o *Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë nuk lejohen.*
 - o *Gunga (kallo) njolla në lëkurë nuk lejohen.*
 - o *Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrës:* Deri në 1/4 e sipërfaqes së frutit.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH ISO 7558:1988 “Udhëzues për para paketimin e frutave dhe perimeve” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

4/2. PORTOKALLE

Bazuar në SSH 1722:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : e freskët**

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme:* Të freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë e me bisht. Para dhe pas 15 janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 %. Me pjekuri teknike të plotë.
- *Ngjyra, shija dhe aroma:* Ngjyrë karakteristike e kultivarit, e verdhë në portokalli, me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athët. Pa shije të hidhur.
- *Madhësia e kokrrës, (diametri më i madh) mm, jo më pak se: 70.*
- *Dëmtime mekanike, të prekura nga sëmundjet dhe insektet, të kalbura, të mykura dhe të fermentuara, gjithashtu lëndë të huaja, gërvishtje në sipërfaqe, por pa prekur tulin:* Nuk lejohen.
- Nuk lejohen as zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH ISO 7558:1988 “Udhëzues për para paketimin e frutave dhe perimeve” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi me artikuj të më sipërm bëhet i përmuajshëm në bazë të kërkesave të institucionit tonë. Për të gjitha artikujt ushqimor duhet të respektohen parametrat teknike, afatet e garancisë e të skadencës.

Malli do merret në dorezim me akt pritje nga mercologia dhe punonjësit e furnizimit.

Shkelja e paramatrave cilësore shoqërohet me kthimin e mallit.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Për ushqimet dhe produktet ushqimore, do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për ushqimin. Për artikujt ushqimor të mësipërm, ku kërkohet raport analizë, operatori ekonomik duhet të paraqes raport analizë origjinale ose kopje e noterizuar, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza përkatëse (fletë analizë për treguesit e sigurisë dhe cilësisë) duhet të jetë sipas llojit të produktit, numrit të lotit dhe jetëgjatësisë së produktit dhe të ketë lidhje me produktin. Në raport analizë duhet të jetë

shënuar: emërtimi i produktit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me produktin.

Produkti kur të lëvrohet duhet të jetë i shoqëruar me certifikatën e origjinës sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

Produktet ushqimore, objekt i vendimit të këshillit të ministrave nr. 1344 datë 10.10.2008 “Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore”, neni 4 dhe neni 13, të jenë të pajisura me etiketat respektive.

Për produktet mishi/ i përpunuar mishi.

Pjesa e karkasës (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar.

Çdo parti/karkasë mishi duhet të shoqërohet me certifikatë veterinare, e cila garanton sigurinë e produktit “mish” dhe me të cilën vërtetohet se, nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.

Për produktet ushqimore të freskëta të fruta-perimeve të pa përpunuara, do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për ushqimin.

Në fletë analizat që do shoqërojnë çdo sasi të mallit të lëvruar, operatori ekonomik të shënojë sasinë e prodhimit që i referohet kjo fletë analizë.

Mbi ambalazhimin e artikujve ushqimor të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Autoriteti Kontraktor, në momentin e lëvrimin të mallit, do të verifikojë jetëgjatësinë e produktit me të cilin do të furnizohet, në përputhje me periudhën e parashikuar të konsumimit nga AK të produktit.

Afati Mareveshjes Kuader do të jetë 365 (treqind e gjashtedhjetë e pese) ditë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Grafiku i lëvrimin;

Lëvrimin të mallit do të bëhet sipas kërkesës dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor pasi lidhet direkt me numrin faktik te nxenesve ne konvikte pra me frekuentimin ditor faktik.

Njësia e Prokurimit